

BIBLIOTEKA
SHTETIT

SH-31
M 36

Xhafer Martini

**FËSHFËRINTE PYLLI
I MËSHTEKNAVE**

tregime

814-32

1/36.

Xhafer Martini

**FËSHFËRINTE
PYLLI
I MËSHTEKNAVE**



Tregime

2682

SHTETIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

LINDJE NË MAL

Col Sejdia, me velenxë hedhur krahëve, rrinte pranë zjarrit. Kishte dhjetë ditë e dhjetë net që balli po i digjej, gryka po i thahej e sytë po i erreshin. Në shpatullën e djathtë cifla e bombës, mbetur nga lufta e fundit, sikur i rëndonte më shumë se kurrë dhe i shkaktonte një bezdi të madhe. Eh, Col Sejdia, Col Sejdia, po të mundin ethet, hej burrë, thoshtë shpesh me vete. Ai që ishte ndeshur në aq luftëra me shovinistët malazezë, ai që u kishte prirë kryengritësve kundër forcave të Maxhar Pashës, tani ndihej i mundur nga ethet. Sikur ato të bëheshin të dukshme, të kapshme, ai do të kacafytej me to dhe do t'i mundte, po kështu si ishin ato, të fshehta, Col Sejdia s'kishte ç't'u bënte dhe e kapte mërzia.

S'kishte njeri tjetër veç Prendës, së shoqes. Gjithë jeta i kishte kaluar nëpër luftëra dhe ishte martuar shumë vonë. Të shoqer e adhuronte, por adhurimin nuk e kishte shprehur kurrë me fjalë. Tani Prenda ishte shtatzënë e qe rënduar shumë. Megjithatë punët e shtëpisë binin mbi të. Ajo i përballonte ato pa u ankuar. Cilit i vinte keq, por ethet e kishin ngujuar. Veç sëmundjes dhe gruas, që mezi lëvizte

edhe ajo, Colin po e mërziste dimri aq i egër i atij viti... Trarët e shtëpisë kërcisnin herë pas here nga bora e shumtë mbi çati dhe atij i vinte plasja, ngaqë nuk kishte kush t'ia hiqte. Çatia ishte e lartë dhe shumë e pjerrët, duheshin burra të fortë për t'u ngjitur në atë ngrehinë akulli...

Një mëngjes, për çudi, Coli vuri re se trarët nuk po kërcisnin më. Prenda rrinte përballë tij e heshtur dhe e menduar.

— Prapë po borëton, — tha me trishtim Coli.

— Ka zanë bora borën, — tha Prenda.

— Po trenët pse nuk po kërcasin ma? A thue ka me na xanë çatia? Thonë se njizet e katër orë para se të shembet çatia, trenët nuk kërcasin ma...

— Jo, Col, jo...

— Po ç'ka pra? Po borëton...

— Unë e hoqa borën, Col. Po ra shumë, prapë do ta heq.

— Ti?!

Për herë të parë ia nguli sytë në barkun e fryrë. E kishte parë edhe më parë, por vjedhurazi, kurse tani po e shikonte drejt.

— Unë, Col, unë... Po ti shmoshu njëherë... mos mendo për punët e shtëpisë e halle të tjera, — i tha Prenda.

— Po nuk po luftoj me kan, moj Prenda. Të kisha dikë para, në shesh, ja e kisha mbyt, ja më kishte mbyt, po kështu s'di çka me ba. U dashka me luftue me vedin...

— Po edhe me vedin duhet me luftue, more Col.

Heshtën të dy. Coli ra në mendime, kurse Prendës iu kujtuan dhitë. Ato kishin ditë që kishin mbetur pa asnjë krand gjeth në grazhde... Mullarët e gje-thit ishin në mal dhe në këtë kohë nuk kishte burrë

që i sillte te kulla. Këtë ia kishte mbajtur fshehur të shoqit, po tani duhej t'ia thoshte patjetër.

— Dhitë janë pa një fill krande gjeth në grazhdë, Col, — i tha ajo. — Ça me ba?

Coli tundi kokën, sikur donte të shkundte mendimet që e kishin kapuluar. Gruaja e kishte pyetur, dhe ai për herë të parë nuk dinte t'i përgjigjej.

— Burri, kur nuk ka forcën, nuk ka as mendjen, moj Prenda...

— Forca të ka lanë, po ka me të ardhë prapë. Mendja as nuk të ka lanë, as nuk ka me të lanë kurrë, — i dha zemër ajo.

— Po ça me ba? Gjethi nuk vjen vetë këtu...

— Gjethi nuk vjen te na, po duhet të shkojmë na te gjethi...

Drita e dobët e atij mëngjesi vinte përmes dritares së vogël të kullës, dhe Coli vuri re profilin e bukur të fytyrës së të shoqes. Prenda kishte një kokë të vogël, fytyrë pak të hequr, qafë të gjatë, dy sy të zinj si nata...

— Ti thue me çue dhitë në mal, a?

— Po, Col.

— Fort po drue, Prenda... Kjo kohë... Dhe ia hodhi prapë sytë në bark së shoqes, por rrëshqitazi. Prenda ia kapi shikimin dhe i buzëqeshi.

— Ma baj mbarë, Col, se nuk më gjen kurrëgjja e keqe...

— E mbara të priftë, — i tha Col Sejdia me zë të mekur.

Pas një ore tufa e dhive po i ngjitej malit. Col Sejdia u ngrit me shumë mundim e, duke iu marrë këmbët, shkoi deri te dritarja e vogël e kullës, në xhamin e së cilës mbështeti ballin që i digjej. Sytë nuk ia ndante së shoqes, që i ngjitej me mun-

dim malit përpjetë. Ajo i zvogëlohej, i zvogëlohej derisa i humbi fare nga sytë...

Dhitë ecnin me kokat lart. Kjo ishte shumë e trishtueshme. Prendës nuk i kujtohej që t'i kishte parë dhitë edhe herë tjetër të ecnin ashtu... Dhia e ka ec e ha, ec e ha... këtu një krande, aty një gjeth, po bora e shumtë nuk kishte lënë asgjë të nxinte mbi tokë. Bardhësia ishte e pafund...

Rrugë nuk dukej... Prenda e dinte, se, po të ngatërrohej, do të shkonte vonë te mullarët. Në sup i rëndonte pushka. Nuk ishte pushka e të shoqit, por e vetja. Ajo kishte luftuar përherë përkrah burrit dhe luftëtarëve të tjerë. Kur merrte rrugë të gjatë, ajo e merrte atë me vete. Dhe tani rruga ishte e gjatë dhe e vështirë. Dëbora është armik i pabesë, gjithmonë i rrezikshëm. Cilin fshik rruge të marr, tha Prenda me vete. Kështu i kishte ndodhur edhe një herë. Po atëherë ishte me të shoqin. Coli kishte thënë se gjithmonë duhet mbajtur rruga e sipërme. Ajo të nxjerr përherë në krye... Dhe Prenda kështu bëri...

Cjapi dhe dhia laroshe i prinin tufës. Cjapi nuk lëvizte fare, ndonëse Prenda e shtynte që të merrte rrugën e sipërme. Ajo kishte qenë qysh fëmijë barireshë dhe e dinte se, kur dhitë nuk ecin, ato parandiejnë rrezik. I shtyu dhitë me duar, por ato nuk bënë përpara. Po i lë ta zgjedhin vetë rrugën, mendoi Prenda. Ajo kishte dëgjuar nga i ati se kafshët e zgjedhin vetë rrugën më të sigurtë, mjafton të kenë shkuar një herë andej. Dhe dhitë morën rrugën e poshtme.

Ecte e lodhur pas dhive. Dëbora i vinte gati gjer në brez. Derisa kapërceu majën, e pati shumë vështirë. Në majë dëbora kishte ngrirë dhe nuk fundosje në të. Tani e kuptoi ç'rrugë kishte marrë. Sa do të kishte gabuar, po të kishte marrë rrugën e sipërme. Do të kishte dalë te shkrepat, ku do të ishte copëtuar me gjithë dhi.

Por mullarët akoma nuk po dukeshin. Veç ajo tani ecte me besim se pas pak do të arrinte. Drurët ishin shenjë e sigurtë. Ajo i njihte ata një për një...

Më në fund arriti. Dhitë e rrethuan mullarin, por ai kishte ngrirë dhe ishte e pamundur të nxirrje goftë edhe një krande. Prenda kullonte në djersë, ndonëse kishte rreth dy orë që udhëtonte në akull dhe në dëborë. U përpoq të ngjitej paksa në mullar, por, sa vinte njërën këmbë në ndonjë gropë, i rrëshqiste tjetra dhe binte prapë aty ku kishte qenë. Mori një dru dhe e theu shtresën e akullit. Futi duart dhe e ngriti atë copa-copa. U zbulua gjethi. Sikur të kishte bërë një zbulim të madh, ajo iu fut punës me forca të reja dhe e shkuli gjithë shtresën e akullit nga mullari. Duart iu gjakosën dhe po i merreshin mendtë. Dhitë rrinin rrotull mullarit të heshtura. Rrinin e prisnin. Prenda me mundim shumë të madh nxori një palë gjeth. Nxori edhe një, edhe një... Ato mezi shkuleshin... Kjo ndodhi derisa akulli nuk u duk më në shtresën e dushkut të prerë dhe të bërë palë... Tani gjethi dukej krejt jeshil, si atë ditë kur e kishin vënë mullar. Dëbora e kishte ruajtur mirë. Prenda i rrëzoi të gjitha palat e gjethit dhe ua shpërndau dhive. Ato filluan të hanin të uritura.

Ja, mbaroi dhe kjo punë, tha Prenda me një zë të shuar, që iu duk sikur nuk doli nga ajo vetë, po nga dikush tjetër. Ndjeu një dhembje të fortë dhe

vuri duart në bark. Iu bë sikur e kishin therur me dhjetë thika njëherësh. Dhembja nuk zgjati veç disa çaste, por ajo filloi prapë, më e fortë dhe më e padurueshme. Prendës po i shkonin djersë të ftohta. E afroi pushkën pranë vetes dhe u ul.

Asaj, si në ëndërr, iu kujtua se ishte shtatzënë dhe u tmerrua kur mendoi se mund të ishin dhembjet e lindjes... Ajo e dinte se ishte e pamundur që fëmija të jetonte qoftë edhe disa minuta në këtë të ftohtë kaq të madh. Kjo e tmërroi edhe më shumë dhe u pendua që kishte dalë nga shtëpia...

Dhembjet iu prenë prapë për dy-tri minuta. Mbase jam ftohur, ose kushedi çfarë..., tha me vete. I erdhi si gjumë... Mbase do ta kishte zënë vërtet gjumi, por përsëri ndjeu sikur një urë zjarri po i kalonte nëpër bark. Tani nuk kishte asnjë pikë dyshimi se ato ishin dhembjet e lindjes.

Ngriti me mundim pushkën dhe qëlloi pesë herë. Dhite u trembën. Ngritën kokat të shqetësuara dhe nuk hanin më. Prenda po përpëlitej. Ajo e dinte se pushkët ishin dëgjuar në fshat, po duhej të paktën një orë ose një orë e gjysëm, që burrat të vinin aty... Dhe u tmerrua kur mendoi se mund ta gjenin duke lindur...

Dhembjet u përsëritën. Atë tani vinin valë-valë. Në fillim ca më të lehta e më të durueshme, pastaj gjithnjë e më të forta, derisa e bënë Prendën t'i humbte ndjenjat. Vinte një qetësi e shkurtër dhe ajo e ndiente veten shumë të lodhur e të dërrmuar. Dhembjet fillonin prapë...

Ishte duke i humbur ndjenjat për të tretën herë, kur ndjeu se ishte bërë nënë. Mblodhi të gjitha forcat dhe e kapi foshnjën. Ishte djalë. Foshja qante dhe Prendës iu duk i shëndetshëm. Tani nuk kishte

hall tjetër, veç të vinin njerëz sa më parë. Sa do ta gëzonte djali Col Sejdinë... do ta ngrinte prapë në këmbë...

E mbështolli foshnjen me rrobat e trupit të vet, por të ftohtët ishte kaq i madh, sa asaj iu duk se vogëlushi po mbulohej me një cipëz të hollë akulli. Ajo vështroi nga dhitë dhe u tmerrua kur vuri re se avulli që u dilte atyre nga goja, u ngrinte menjëherë në turi... Dhe menjëherë i ra ndër mend se atje ku ishte ajo, nuk kishte asgjë të ngrohtë, përveç frymës së dhive...

— Ej, Laroshe, Laroshe, — e ndolli ajo dhinë që mbante këmborën.

Laroshja iu afrua. Prenda nxori një copë misërnike që kishte marrë me vete dhe ia dha. Dhia filloi të hante. Avulli i ngrohtë i saj sikur ia shkriu gruas krahndezën që dukej në qerpikët e flokët si brymë e bardhë... Pastaj ajo ndolli edhe dhitë e tjera. Ato i rrethuan Prendën dhe foshnjen. Dhitë përty-peshin dhe avulli i ngrohtë që lëshonin po e mbante gjallë fëmijën. Atëherë Prenda u gëzua dhe filloi të qeshte përmes lotëve... Foshja qante dhe ajo e kuptoi se ai ishte mirë, se merrte frymë e jetonte. Për çudi, sikur të kuptonin, dhitë afroheshin gjithmonë e më shumë rreth bareshës... Prenda e ndjeu se duart filluan t'i ngroheshin nga fryma e tyre. Nga flokët filluan t'i pikonin sumbulla të vogla krahndeze të shkrirë, si lot... Buzët e foshnjes ishin si të trëndafilta, faqet, që pak më parë, ishin fare të zbehta e si pa jetë, tani filluan të skuqeshin lehtë. Ishte shtrirë së bashku me të në palat e gjethit dhe lart e rrotull nuk shikonte asgjë, veç kokat e dhive, që nuk largoheshin... Ato po shkrinin krahndezën edhe nga turinjte e njëra-tjetrës dhe Prenda pati përshtypjen

se po vesonte shi... Një shi i ngrohtë, si vesa e luleve...

U ngrit pak mbi bërryla dhe nxori kokën më lart se kokat e dhive. Në rrugë pa njerëz...

U përkul mbi të birin dhe e puthi. Asaj iu duk se foshja qeshi...

[Faint, mostly illegible text follows, appearing to be a continuation of the narrative or a list of items.]

SHTEGTIMI I KENGËS

Fshati Binjar, me njëqind shtëpi, shtrihej në një bregore të bukur. Sipër tij ishte pylli, një pyll i dendur ahu dhe mështekne. Edhe pyllin, ashtu si fshatin, e quanin «Binjar». Nuk dihej nëse fshati e kishte marrë emrin nga pylli, apo pylli nga fshati. Po një gjë ishte e sigurtë: jeta e binjariotëve ishte e lidhur ngushtë me pyllin.

Ushtria turke kishte shkuar shumë herë deri afër fshatit, por aty nuk kishte mundur të futej. Kjo ndodhi për shumë vjet. Po një ditë forca të shumta turke e pushtuan edhe këtë fshat.

Pashai turk mbledhi të gjithë burrat të një lëndinë. Pleqtë pinin duhan në heshtje, nën hijen e rrepeve shekullorë. Shumë prej tyre e mallkonin vdekjen, që nuk u erdhi më shpejt, që të mos e shihnin këtë ditë...

— Fshati juaj është bërë çerdhe komitësh. Do t'i djeg shtëpinë dhe do ta degdis në Anadoll atë që strehon, a i jep bukë ndonjë komiti, — tha pashai me të egër.

— Shqiptarit më mirë priti kokën, sesa t'i thuash: mos të pafsha mik në derë, — tha Marin Hasa.

Pashai kërkoi që t'ia përkthenin fjalët e tij. Sa e dëgjoi, pashai u habit me guximin e këtij plaku. Ai e kishte në dorë edhe ta vriste atë, po zgjodhi tjetër rrugë, të paktën kësaj radhe...

— Po kë quan «mik» ti, hajdutët, ata që dalin malit dhe bëjnë zullume, ata që vjedhin e plaçkitin, këta, ë? — e pyeti ai Marin Hasën.

— Azgin Alica e geta e tij nuk vjedhin dhe nuk bëjnë zullume. Të paktën, flas për popullin. Atij nuk i kanë rënë kurrë në qafë. Po të huajit, që na ka shkelë vatrën, i kanë bërë shumë zullume. Po edhe këtij nuk ia kanë bërë me të vjedhur e me të plaçkitur, por i kanë dalë me martina ballë për ballë. Në e quan ti hajdut, ne e kemi mik, se lufton për lirinë e vendit të tij, — tha Marin Hasa.

— Po dëgjuat fjalët e tij, — iu drejtua pashai pastaj burrave të tjerë, — veten më qafë paçi. Do të vareni me gra e me fëmijë. Sa për këtë, qenka kaq shumë plak dhe kaq shumë i rrëgjuar, sa nuk e vlen të matem me të...

Me gjithë kërcënimet e tij, komiteti, si gjithmonë, hanin e pinin në Binjar. Askush nuk u tremb nga fjalët e pashait. Ai u bë si i tërbuar kur i thanë se binjaritët akoma i mbanin komitetin. Atëherë ai tha që në pyll të ngriheshin njëqind leqe litari... Pastaj dha urdhër që të gjithë burrat të mbledheshin te Lëndina e Krojeve. Dhe u mbledhën burrat e prisnin ç'do t'u thoshte kësaj here pashai. Po ai nuk foli asnjë fjalë, veç u tha që të ngriheshin, dhe vetë, i prirë nga njerëzit e tij më të afërt, i shoqëruar edhe nga ushtarët, u nis drejt pyllit... Ishte pranverë dhe pylli ishte mbushur me luleshtrydhe. Përhapej një erë e mirë. Fshatarët u habitën kur panë gjithë ato leqe litarësh... Pashai rrinte i zymtë, më i zymtë se asnjëherë tjetër.

— Ç'është kjo, Marin Hasa? — e pyeti dikush nga burrat plakun.

— Ky e bën për të na trembur ne, por vetë është zverdhur krejt, — tha Marini.

Pashai po bisedonte kokë më kokë me disa nga oficerët e tij. Te çdo lak i ngritur rrinte një ushtar. Litarët ishin të trashë sikur me ta do të varnin njëqind burra njëherësh.

Pashai u dha urdhër ushtarëve të dilnin mënjanë. Tani dukej sikur ishin varur drurët e pyllit.

— E shikoni, — nisi t'u fliste ai fshatarëve, — janë njëqind leqe, nga një për çdo shtëpi. Gjithë burrat e fshatit do t'i vë në litar, po mbajtët me bukë dhe po strehuat prapë pas kësaj dite çetën e hajdutit Azgin Alica... Tjetër fjalë nuk kam. Leqet do të rrinë këtu...

*

* * *

Ceta e Azgin Alicës i kishte parë litarët. I pari i kishte vënë re Mafruku, më i moshuari i çetës. Ai u nis për të marrë bukë në Binjar, por, kur kishte parë njëqind leqet e ngritura, nuk i kishin bërë këmbët përpara... Ktheu rrugë dhe u nis përsëri për në thellësi të pyllit, atje ku e priste kapedan Azgini me shokë.

— Ç'të ka ndodhur, Mafruk? Ti sikur je zverdhur, — i tha Azgini.

— Po, kapedan, jam zverdhur, por jo nga frika për kokën time...

— Në kokën time nuk ka njerëz frikacakë, — tha kapedani.

Mafrruku nuk e kuptoi nëse këto fjalë u thanë si qortim, apo si një e vërtetë e thjeshtë.

— Turku ka ngritur njëqind leqe në pyll, kapedan. Këto nuk i ka ngritur për ne, se ne nuk jemi njëqind; por, edhe sikur të jemi, nuk na kanë në dorë... Leqet janë ngritur për fshatin...

Kapedani kruajti pak mjekrën e rritur dhe nuk foli menjëherë.

— Ti mendon se nuk do të na ndihmojnë më binjariotët, — tha ai.

— Unë nuk them ashtu, kapedan, por mendova se ishte më mirë të kthehesha dhe ta bisedonim këtë punë...

— Po ne për popullin luftojmë, — tha Maksuti, më i riu në çetë.

Azgini qeshi. Ai e donte fort këtë djalosh guximtar, që shumë herë i ishte lutur t'i shkonte pashait turk mu në çadër, përmes rojave e t'ia vinte martinën mu në ballë.

— Binjariotët nuk i tremb litari, por ti mirë ke bërë, — tha kapedan Azgini. Pastaj u hodhi një sy shokëve sikur donte të dinte se ç'mendonin ata.

— Binjariotët e dinë se ku jemi... Po të duan, na sjellin vetë bukë...

Ndenjën një copë herë pa folur, secili në mendimet e veta.

— Ngrihuni, — urdhëroi pastaj kapedani.

Ata panë Azgin Alicën që priu i pari në një rrugë të ngushtë, që dredhonte midis drurëve të dendur të pyllit. I ranë pas pa e pyetur se ku do të shkonin. Në të dalë të pyllit kapedani qëndroi.

— Shikoji, kapedan, ja tek janë, — i tha Mafrruku, duke ia bërë me kokë nga leqet.

— Na ka përdhosur pyllin, qeni, — tha Maksuti.

Kapedani nuk foli fare. Ai nxori thikën dhe të gjithë bënë si ai, se ia kuptuan mendimin. Me një duf të papërmbajtur iu ngjitën rrepeve, i prenë tërë litarët dhe i grumbulluan në një vend... Mafrruku nxori eshkën dhe urorin t'u vinte zjarrin.

— Kapedan, këta duan diçka tjetër, — tha Maksuti për copat e litarëve.

Kapedani e pa në sy.

— Ikni ju, ikni, se e di unë ç'duan këta leqet e turkut, — tha Maksuti, duke zberthyer kopsat e pantallonave...

Azgin Alica dhe shokët qeshën e bënë pak nga e majta.

— Dang, dang, — oshëtinte pylli.

Po oshëtima ishte aq e dobët, sa mezi u shkonte në vesh luftëtarëve.

— Dikush po pret dru, — tha Mafrruku.

— Duket sikur godet në kungull dhe jo në dru, — tha Maksuti.

— Është larg, — tha kapedani. — Ta shohim kush është...

Ata ia mbajtën pyllit nga e djathta e dolën në një lirishte të vogël... Ishin tërbuar nga inati e urrejtja dhe nuk po ruheshin fare nga ndonjë sulm i papritur i turkut. Dolën te Gurra e Madhe dhe u ulën. Pushuan një copë herë. Flladitën sytë me ujët e ftohtë e të kulluar dhe u ngjitën prapë në mal. Tashmë ecnin në pyllin me mështekna. Mështeknat bardhoshë, në atë muzg mbrëmjeje, dukeshin sikur ishin lyer me vernik...

— Dang, dang, — u dëgjua përsëri kërcitja e sëpatës.

Midis drurëve të dendur ata panë një njeri.

— Kush qenka! — tha kapedani që e njohu i pari.

— Kush?

— Marin Hasa... Ky e quan vdekjen babë e nënë,
qeshi kapedani.

— Ata iu afruan plakut pa u ndier. I drejtuan tytat e martinave dhe i thanë që të ngrinte duart lart. Plaku drejtoi trupin por duart nuk i ngriti. Ai i njohu dhe qeshi...

— Si je Azgin Alica? — e pyeti ai kapedanin dhe sakaq u hodhën në krahë të njëri-tjetrit.

— Mirë, Marin Hasa, po jemi ca keq me bukë, tha kapedani. — Turku paska ngritur shumë leqe në pyll...

— Laku i litarit dhe burrëria e shqiptarit janë dy gjëra, — tha Marin Hasa.

— S'po të marr vesh, Marin, — i tha kapedani.

— Frika nuk e ka penguar kurrë shqiptarin për të ndihmuar trimat. Fshati juaji është...

— S'kemi frikë për kokat tona, Marin, por për fshatin. Nuk vijmë dot...

— Nëse nuk vini ju te buka, vjen buka te ju, — tha Marin Hasa dhe hodhi xhaketën arna-arna kraheve...

Pas dy orësh plaku u kthye në pyll me thesin plot me bukë.

— Merrëni, ju qoftë hallall, — u tha.

Azgin Alica e shikoi me mirënjohje.

— Qafën po më shikon, kapedan? Mos u bëj merak, se litarët e turkut nuk e mbajnë qafën time...

— Edhe mund ta mbajnë, Marin, por për kokën tënde ne do të kërkojmë vetëm të pashait... — tha Maksuti.

*

*

*

Por, kur po kthehej, Marin Hasa ra në duar të rojave turke. Ata e çuan te pashai dhe i thanë se e kishin kapur duke u çuar bukë hajdutëve... Treguan thesin.

— Ah, qenke ti... — tha pashai, sa e njohu plakun. — Këtë radhë jam i detyruar të merrem edhe me ty...

Ai e shikoi me urrejtje këtë plak dhe i erdhi keq që nuk kishte kapur në vend të tij një tjetër njeri, të ishte, të paktën, më i ri. Pashai vendosi t'i bënte disa pyetje. E merrte me mend që plaku do të përpiquej ta lehtësonte veten, dhe kjo do ta zbaviste shumë. Do të luante si macja me miun me këtë plak...

— I kujt është ky thes? — e pyeti plakun.

— Imi, — pohoi ai.

— Me bukë e kishe?

— Po.

— Ku e çove?

— Çetës së Azgin Alicës.

Pashai u zhgënjye. Plaku nuk përpiquej të dredhonte.

— I ke parë leqet në pyll — i tha plakut dhe parashikoi që kjo pyetje do ta bënte efektin e vet.

— I kam parë, — tha fare i qetë Marini.

— Nuk ke frikë?

— Frikë? Unë nuk e kuptoj përse duhet të kem frikë?

— Po ja, do ta provosh lakun e litarit. Nuk është vdekje e bukur, besoj!

— Një herë do të vdesim, pasha. Dhe, kur vdekja të vjen me nder, ne, shqiptarët, themi që ajo është kapak floriri, — tha Marin Hasa.



Pashai u tërbua nga inati dhe urdhëroi që ta rrihnin tërë natën.

— Të shohim sa trim do të jesh nesër, — i tha tërë mllef plakut.

Të nesërmen pashai nxori me forcë tërë popullin e Binjarit për të parë varjen e Marin Hasës. Ata i çuan atje, ku një ditë më parë ishin ngritur leqet e litarit. Pashai u tërbua nga zemërimi, kur i pa leqet ashtu grumbull dhe... Ai urdhëroi që të ngrihej shpejt e shpejt vetëm një lak, sa për plakun...

Turma e njerëzve u drodh, kur ushtarët sollën Marin Hasën. Brenda një nate ishte ndryshuar aq shumë, sa mezi njëhej. Ecte me kokë lart, pa i bërë tërr syri. U ndal për një çast përpara bashkëfshatarëve e u përpoq të buzëqeshte.

Gratë filluan të qanin, por burrat i shikuan me qortim dhe ato e prenë vajin...

Marinit i vunë lakun në fyt dhe e vunë mbi një tring të prerë. Pashai i hodhi sytë nga turma e njerëzve, për të parë se ç'përshtypje po bënte varja e Marin Hasës. Përveç urrejtjes, nuk shihte asgjë tjetër te këta njerëz, as lot nuk po shikonte... Pastaj i hodhi sytë Marinit dhe iu duk se plaku që ligështuar... Ai buzëqeshi paksa dhe, si çau përmes oficerëve, iu afrua pranë atij që do të varej...

— E ke ndier ndonjëherë veten më ngushtë se tani? — e pyeti ai Marinin.

— Po, u përgjigj plaku me lakun në fyt.

Në turmën e njerëzve u ndie një murmurimë admirimi. Pashai nuk e priste këtë përgjigje.

— Kur e ke ndier veten më ngushtë, sesa me lak në fyt? — e pyeti ai plakun.

— Kur më kanë ardhur miq në shtëpi dhe nuk kam pasur t'u jepja bukë. Tani që u çova bukë tri-

mave, mua nuk më tremb laku i litarit, — tha plaku fare i qetë.

— Racë e mallkuar, — thirri pashai dhe i ra me tërë forcën me shkelm trungut, ku rrinte i dënuari. Trupi i Marin Hasës u lëkund.



Çeta e Azgin Alicës ia mori hakun shpejt Marin Hasës. Thonë se një natë Maksuti, i veshur si oficer turk, shkoi gjer në çadrën e pashait dhe ia preu atij fytin me thikë. Që atëherë kanë kaluar shumë vjet, por një këngë këndohet edhe sot e kësaj dite. Ajo lindi atë ditë që Marini vdiq. Marini vdiq, po kënga jo. Ajo shtegtoi në vite. Kaloi gojë më gojë, derisa erdhi në ditët tona.

*Marin Hasa, i Has Butës,
Hiç s'po të tutka gryka e pushkës.
Marin Hasa, burrë Binjarit,
Hiç s'po të tutka laku i litarit...*

NË XHADE, BUZË LUMIT.

Edhe pas mbarimit të luftës vazhdova të shërbeja në ushtri. Po, një ditë më thirrën dhe më thanë se isha emëruar komandant sektori në një rrugë automobilistike që do të hapej. U nisa menjëherë dhe shkova në sektor me rrobat ushtarake në trup dhe pushkën në sup.

Në fillim e pata ca vështirë, por shpejt ia mora dorën dhe kësaj pune të re. Sektori ishte vendosur buzë lumit, atje ku kodra zbriste ëmbël, duke sajuar një shesh të vogël, ku ishin ngritur mensa, fjetoret, infermiera dhe zyrat. Poshtë sektorit, rreth dyzet metra mbi lumë, do të kalonte xhadeja. Ajo kishte ardhur rreth dyqind metra afër sektorit dhe vullnetarët punonin për ta çuar atë më tej, drejt Veriut. Së shpejti do të fillonim punën për ndërtimin e një vepre arti. Xhezoja, tekniku i sektorit, më vjen një ditë në zyrë e më thotë:

— Binok, duhet të marrësh në telefon qarkun, që të na sjellë materialet për fillimin e veprës së artit. Duhet një makinë...

— Po ku ta gjejë makinën qarku, o Xhexo?

— Pa makinë nuk vijnë materialet, Binok.

— E di ti që ka makinë, se mos kërkojmë ndonjë gjë që nuk është, — i thashë unë për t'u siguruar, se sapo kishim dalë nga lufta dhe nuk kishte kuptim të kërkoje gjëra që akoma nuk i kishim.

— E di, e di. Janë trofe të luftës.

Kapa në çast dorezën e telefonit dhe kërkova qarkun. Zëri i centralistes vinte i dobët dhe unë nuk kuptova asgjë.

— Dreq o punë, pa merre ti, Xhezo, se mos merrsh vesh më mirë, — i thashë atij.

Xhezoja bisedoi me qarkun.

— Hë, ç'thonë?

— Do të na sjellin makinën, — tha ai i gëzuar.

— Të lumtë, Xhezo, — i thashë dhe e përqafova, sikur makinën të na e kishte dhënë ai.

Makina erdhi pas dy ditësh. Ajo e sillte materialin deri atje ku ishte bërë xhadeja, pastaj e merrnin vullnetarët në krahë dhe e çonin atje ku do të ndërtohej vepra e artit.

Një natë ngjau diçka që na vuri në mendime. Ceno Xhepi, shoferi, kur solli materialet e fundit të asaj dite, hyri në zyrën time i mërzhitur.

— Përse i ke varur turinjtë, Ceno? e pyeta me shaka.

— Sonte mbeta këtu, Binok.

— Përse? — u thartova dhe unë në fytyrë, se e dija ç'do të thoshte të mos punonte makina një ditë.

— Shiu, Binok... Nuk mund të bëj as edhe një hap, se rrëshqas në humnerë. Rruga është e re dhe dheu nuk mban.

— Na duheshin shumë dërrasat, o Ceno, — thashë.

— Na duheshin, — tha edhe Cenoja.

Dola jashtë. Cenoja më ndoqi pas Shtatori sapo kishte hyrë dhe gjethet e dushkut kishin filluar të

zverdheshin. Shiu binte shtruar-shtruar, një shi kokërrmadh që të hynte në palcë menjëherë. Poshtë lumi rridhte i turbulluar. I ramë makinës rrotull, sikur ta kishte fajin ajo.

— Rri sonte këtu, mbase hapet moti nesër, — i thashë Cenos.

— U pa puna, — tha ai, dhe vuri dy gurë të mëdhenj te rrotat e makinës që të mos rrëshqiste.

— Nuk rrëshqet?

— Jo, është siguruar, — tha Cenoja.

U kthyem përsëri në sektor. Mbrëmja donte akoma kohë që të vinte, por, ngaqë ishte vrenjtur, dukej sikur kishte rënë nata. Në rrugë takuam Ibish Bedon me pushkë në sup.

— Për ku kështu Ibish? e pyeta.

— Kam rojën sonte, shoku Binok.

— Hajde, shërbim të mbarë. — e urova.

— E mbara të priftë, o Binok, — tha ai dhe u largua për në pyll.

Bandat e armatosura silleshin akoma maleve dhe ne bënim rojë me pushkë.

Qielli sikur ishte çarë atë natë dhe shiu nuk pushoi fare. Mua nuk më flihej nga merakun që kisha për rrugën, për vonesën e materialeve... Cenoja u shtri në krevatin e Javerit që ishte shtruar në shtal, kurse unë po endesha kot nëpër dhomë, se s'kisha gjumë. Aty nga mesi i natës u shtriva në krevat, siç isha i veshur. Më kishte zënë gjumi. U zgjova nga një krismë pushke dhe zërat e vullnetarëve...

— C'është? — pyeti Cenoja i përgjumur.

— Pushkë, — thashë unë dhe brofa në këmbë.

Kur dolëm në jashtë, vullnetarët kishin rrethuar sektorin. Shiu vazhdonte të binte...

Disa vullnetarë po sillnin në krahë një njeri.

— Kush është? — pyeta i tronditur.

— Kanë vrrarë Ibishin, — tha dikush.

— Kush e vrau? — pyeti Cenoja.

— Bandat, kush tjetër, — tha një vullnetar.

E çuam Ibishin në infermieri...

— Është gjallë, — tha infermieri me një ton të sigurtë, pasi e kishte vizituar me kujdes.

E kontrollloi në trup dhe pa se nuk kishte asnjë plagë plumbi. E kontrollloi edhe në kokë dhe pa që kishte një plagë, por jo nga plumbi.

— E kanë goditur me ndonjë gjë të fortë e të rëndë, — tha pastaj ai.

— Po kush qëlloi? — pyeta unë.

— Duhet të ketë qëlluar Ibishi, — foli Cenoja.

— E përse nuk e vranë Ibishin? — pyeti Xhezoja.

— Ata kanë kujtuar se e vranë, — tha Cenoja.

— Dreq o punë, nuk merret vesh, — tha infermieri.

— Duhet të lajmërojmë urgjent qarkun, — thashë unë, sikur doja të kërkoja mendimin e të gjithëve.

Hapa derën e zyrës dhe, sapo kapa dorezën e telefonit, hynë dy vullnetarë.

— Makina ka rënë në lumë... — më thanë ata me një frymë.

— Si?! — klithi Cenoja.

— Ka rënë në lumë, — tha prapë njëri nga vullnetarët.

— Paska rrëshqitur. Të thashë, Ceno, — foli unë.

Cenoja ishte zbehur.

— Nuk ka rrëshqitur. Jam i sigurtë që nuk ka rrëshqitur, por e kanë hedhur, — tha ai.

U lidha shpejt me qarkun dhe u tregova ç'kishte ndodhur. Pastaj, së bashku me ata që ishin në infer-

mieri, shkuam te vendi ku kishte qenë makina. Ajo, sikur të ishte drejtuar nga shoferi, kishte bërë një kthesë nga e majta dhe kishte rënë në lumë. Ishte rrokullisur rreth dyzet metra poshtë, nëpër shkëmbinj të thepisur dhe, sigurisht, që ishte dëmtuar fare. Një qosh i kabinës dukej mbi ujërat e lumit.

— Ka rrëshqitur, — tha Xhezoja.

Cenoja hapi sytë i egërsuar.

— Nuk ka rrëshqitur. Jam i sigurtë që nuk ka rrëshqitur.

— Po si? — pyeti Xhezoja.

— Këtë e kanë hedhur njerëz, — tha Cenoja, i sigurtë.

— Ta shohim, Ceno, — i thashë, sado që më dukej se makina nuk kishte rrëshqitur vetë, por e kishin hedhur.

— Ta shohim, o Binok, — ma ktheu ai.

Cenoja, i bërë tym, u drejtua me hapa të rëndë për nga sektori. Shkuam edhe ne pas tij. Ecnim të heshtur dhe kokulur, sikur po ktheheshim nga një varrim. Në të mbërritur të sektorit Sali Virani m'u afrua dhe më tha:

— Se ç'ndiente një gëzim të fshehtë, Xhezoja, komandant.

Për Xhezon nuk kisha asnjë dyshim, por Saliut nuk i thashë as mirë, as keq.

— Eh, ç'po na vete ters, — tha Xhezoja, kur mbetëm në zyrë veç unë dhe ai.

M'u kujtuan fjalët që më tha Saliu dhe u përpoqa të hetoja në fytyrën e Xhezos atë gëzimin e fshehtë, por, në vend të tij, pashë hidhërim.

Pasdite erdhën nga qarku dhe Ibishin, si e mbajtëm rreth dy orë në vig, se makina nuk kalonte, e çuam në spital. Ai ishte pa ndjenja dhe ne kishim

frikë mos vdiste. Po të shërohej dhe të fliste, atëherë gjithçka do të sqarohej.

U bënë hetime, por shumë gjëra mbetën të errëta. Mos vallë Ibishin e kishte qëlluar dhe kishte dashur ta vdiste po ai që kishte hedhur edhe makinën në lumë? Mos ishin dy a më shumë njerëz? Mos vallë makina kishte rrëshqitur vetë? Kë qëlloi Ibishi? Dhe, më në fund, a kishte qëlluar Ibishi?

Cdo ditë merrja në telefon spitalin dhe më thoshin se Ibishi ishte në gjendje të rëndë, pa ndjenja. Për veprën e artit na sollën një makinë tjetër. Edhe këtë e drejtonte Cenoja. Puna shkonte mirë, por mua nuk më hiqej nga mendja plagosja e Ibishit dhe rrokullisja e makinës në humnerë.

Pas disa ditësh doli nga spitali zëvendëskomandanti i sektorit, Javeri. Ai më tha se kishte shpresa që Ibishi të shpëtonte, megjithëse akoma nuk mund të flitej me siguri për këtë, se ai ishte përmendur vetëm disa sekonda dhe kishte thënë ca fjalë përçart; kishte zënë në gojë dhe emrin e Xhezos...

— Të jetë ngatërruar Xhezoja në këtë punë? — e pyeta Javerin.

— A e njohim mirë këtë Xhezon? — më pyeti ai, në vend që të më përgjigjej.

Dhamë e morëm njëri me tjetrin dhe dilte se shumë pak gjëra dinim për të. Para Çlirimit kishte qenë shofer dhe nuk dihej përse e kishte lënë zatinin.

— Ke dëgjuar ndonjëherë nga Xhezoja se ka qenë shofer? — më pyeti Javeri gjithë interesim.

— Nuk më ka thënë gjë, — i thashë.

Javeri ra në mendime. Ai ishte i ri, rreth të njëzet e pesave, i gjallë e i zgjuar. Fill pas Çlirimit kishte punuar në forcat e ndjekjes, por, ngaqë kishte

marrë një plevit të rëndë, kishte ardhur në sektor...

— Përse interesohesh për profesionin e Xhezos?
— e pyeta.

— Sepse ai që ka hedhur makinën në lumë, duhet të ketë qenë shofer, ma thotë mendja. Ka hapur derën, ka manovruar dhe e ka rrokullisur. Ndryshe do të duheshin dhjetë burra për ta lëvizur nga vendi...

— Po vetëm fakti që ai ka qenë shofer nuk bëjnë fajtor, apo jo? — pyeta unë.

— Natyrisht që jo. Po përse ta ketë mbajtur të fshehtë se ka qenë shofer? Kjo nuk të bën përshtypje?

— Mbase nuk i ka rënë rasti ta thotë...

— Të shohim. Po i krijojmë një rast, — tha Javeri.

Pas dy ditësh Cenoja ra i «sëmure» në infermeri. Xhezoja hyri në zyrën time kur isha së bashku me Javerin.

— Na u sëmur Cenoja. Shofer nuk gjen kollaj, — tha me keqardhje Javeri.

Xhezoja u turbullua paksa nga fjalët e tij, por e zotëroi veten shpejt.

— Nuk gjen, — tha ai.

— Mos merr ndopak vesh nga zanati i shoferit?
— e pyeta Xhezon.

— Jo, Binok. Ku tekniku i ndërtimeve dhe ku shoferi, — tha ai, duke lënë të nënkuptohej se unë e kisha bërë këtë pyetje, ngaqë nuk shikoja ndonjë ndryshim të madh midis këtyre dy profesioneve.

— Ashtu është, — tha Javeri për të mos ngjallur dyshime. — Po nuk duhet të ketë kushedi se çfarë Cenoja. Pak temperaturë ka. Nesër do të ngrihet, me siguri, — shtoi ai.

Të nesërmen në mëngjes Cenoja «u shërua» dhe filloi punën.

Ibishi pas një jave vdiq dhe kjo na hidhëroi shumë të gjithëve. Vëreja me kujdes Xhezon dhe, në pamjen e jashtme, dukej se edhe ai vuante si ne të tjerët. Po thellë-thellë shikoja atë gëzimin e brendshëm për të cilin më kishte folur edhe Saliu... Apo mos më dukej edhe mua kështu?! Vdekja e Ibishit e vështirësonte shumë punën...

Në Valiras, në një vend në pyll, rreth dy kilometra nga sektori, ishin vënë piketat nga do të kalonte xhadeja. Por përroi i vogël i Senkës, i fryrë nga shirat e vjeshtës, po e hapte gjithnjë e më shumë shtratin, duke gërryer dheun e kuq në të dyja anët.

Xhezoja më kishte propozuar dy herë të shkonim për të parë vendin dhe të merrnim masa duke ngritur ndonjë pritë, që ta kishim më lehtë për veprën e artit që do të ngrinim në atë vend.

E kisha shtyrë me sot me nesër propozimin e tij dhe prisja të vinte Javeri nga qyteti e të këshillohesha me të. Kur ai u kthye, e biseduam një copë herë të gjatë se përse Xhezos i dhimbte më shumë se ne të dyve ajo puna e përroit... Vendosëm që, sa ta zinte edhe një herë në gojë çështjen e përroit, të tregohesha i gatshëm dhe të shikoja, natyrisht pasi të vija në dijeni Javerin.

— Nuk na u bë mbarë për në Valiras, — më tha prapë një pasdite Xhezoja.

— Vërtet! A je i lirë të shkojmë tani? — e pyeta.

— I lirë jam. Tjetër kohë nuk kemi, — tha ai shumë i gatshëm.

— Vemi. Bëhu gati, — i thashë.

— Gati jam. Ja, sa të marr pak peliçen se kam ftohtë, — tha ai dhe nxitoi për në dhomën e tij.

Javeri po pinte duhan me një vullnetar pranë

zyrës sime. Hapa dritaren dhe ia bëra me shenjë të vinte.

— Po nisem me Xhezon për në Valiras, — i pëshpërita.

— Mirë, mos ki merak. Mua me shokë më ke pas në çdo hap, — tha ai dhe më ra në sup me dashuri.

— Të marr armë?

— Merr vetëm revolverin, por fshihe, — më porositi dhe u ndamë.

Javeri mori tatëpjetë. Nxora revolverin dhe i futa një krehër me fishekë. E fsheha në gji, nën këmishë. Xhezoja po vonohej pak dhe unë ndihesha i shqetësuar...

— Kështu do të vish? — më pyeti ai, kur hyri në zyrën time dhe më pa vetëm me një triko lesi.

— Po marr edhe xhaketën, — i thashë dhe, si e shkunda, sikur kishte pluhur, e vështa.

Bëmë rreth pesëdhjetë metra jashtë sektorit.

— Të kisha marrë revolen, — i thashë si me keqardhje atij. — Më doli fare nga mendja.

— Nuk na gjen gjë, jo, — foli ai dhe qeshi.

Nuk di nëse e besoi gënjeshtren time.

E hetoja me kujdes dhe nuk i vëreja asgjë të dyshimtë. Por, kur u futën thellë në pyll, ai sikur e humbi qetësinë dhe në sy i pashë t'i vetëtinte agresiviteti... Ecnim përmes një pylli të dendur me dru ahu dhe dushku. Rruga ishte e ngushtë dhe ne ecnim pranë njëri-tjetrit. Dielli sapo kishte perënduar dhe në pyll ishte pak errët. Nganjëherë më mbushej mendja që të nxirrja revolen, t'ia vija mu në ballë dhe t'i thosha të mos lëvizte as edhe një hap më tej... Po kjo nuk do t'i shërbente çështjes dhe ne nuk kishim fakte kundër tij, prandaj e përmbaja veten.

— Duart lart, Binok Dima, — bërtiti papritmas

Xhezoja duke më drejtuar grykën e revolverit. Ishte një nagant krejt i ri.

Bëra sikur u habita dhe buzëqesha.

— Lëri shakatë, Xhezo, — i thashë. — Paske pasur dhe revole dhe nuk më paske thënë, — vazhdova unë i qetë.

— Nuk po bëj shaka, — tha ai, duke më ndjekur çdo lëvizje, i gatshëm për të qëlluar. Vështrimi i tij ishte i egër, shumë i egër.

— Ç'do nga unë? — e pyeta.

— Do të të çoj peshqesh te Safë Losha. Nuk është edhe shumë larg që këndeje. Ia kam dhënë fjalën të të çoj dhe fjala duhet mbajtur. Gjynah që nuk e mora edhe atë, Javerin, po do t'i vijë radha edhe atij.

Safë Losha ishte kryebandit dhe kriminel me damkë, që endej maleve së bashku me bandën e tij.

— Ti qenke armik, ë? — e pyeta.

— Armik gjer në vdekje i këtij pushteti dhe i të gjithë atyre që punojnë për të.

Në fytyrën e tij shkrepëtiu terrori dhe një buzëqeshje djallëzore.

— Ti e vrave Ibishin? — e pyeta.

— Unë e vrava. Edhe makinën në lumë unë e hodha. Desh më qëllloi ai budallai, por e lashë thes me manivel...

Vetëtimthi mendja më shkoi te Javeri. «Po sikur... Ai duhet të...» mendova dhe po bëja planin si ta nxirrja në çast revolverin. Ballin ma mbuluan djersë të ftohta.

— Mos lëviz, se t'i hodha trutë në erë, — m'u hakërrye ai.

— Ti e di se nuk kam armë. Më mirë më vra me dorën tënde, sesa të më çosh te Safë Lōsha, — i thashë.

— Një peshk i tillë do ta gëzojë shumë Safën. Përpara! — më urdhëroi ai duke më kërcënuar me gishtin në këmbëz të revoles.

Sakaq u dëgjua një krismë dhe dora e Xhezos, që mbante revolverin, u këput si e prerë. U hodha mbi të me tërë peshën e urrejtjes. Pranë nesh erdhi menjëherë Javeri me dhjetë vullnetarë të armatosur, që na kishin ndjekur të fshehur pas ledheve dhe pas drurëve. Xhezon e lidhëm dhe e ngritëm në këmbë.

— Kujtove se do të më çoje te Safë Losha, o qen, ë? — i thashë.

— Ne ngrejmë kurthe më të bukura se ti, — i tha Javeri dhe e urdhëroi të ecte përpara.

DORA QË ZHDUKU VARFËRINË

Në çetën tonë një ditë erdhi një i ri rreth njëzet vjeç. Kishte një pamje të ndryshme nga partizanët e tjerë që vinin për herë të parë në çetë. Nuk e përcaktoje dot në ishte fshatar, apo qytetar. Flokët i kishte dredha-dredha e i binin gjer poshtë në qafë dhe mjekrën nuk e kishte rruar prej kohësh. Komandanti na tha se ishte partizan i ri dhe këndej e tutje do të luftonte në radhët tona. Më e çuditshmja ishte se ai vinte në çetë me një martinë të re, me patllake dhe me një thikë të gjatë, si ato gërshërët që përdoren për qethjen e shelegëve. Rrinte pak i druajtur dhe, në përgjithësi, nuk i pëlqente të fliste shumë dhe të shoqërohej.

— Ky sikur është rritur në mal, — tha për të një partizan.

— Tamam kaçak duket, — shtoi një tjetër.

— Ç'po flisni kot! Ku ka kaçakë tani! Pse, në kohën e Turqisë jemi?! Tani, o me Partinë, o me Ballin, — tha «shkollari» i çetës sonë, Serveti.

— Mbase është nga kaçakët e fundit, — tha diskut.

Më vonë mësuam se Moisi Merveti kishte qenë

vërtet kaçak. Ai këtë e pohonte vetë dhe sikur ndi-
hej krenar. Tregonte shumë histori për çetën e sho-
këve të tij. Me dashuri të madhe fliste për ish-kape-
danin e tij Qenanin, i cili, ashtu si edhe Moisiu, ishte
bashkuar me partizanët. Qenani kishte shkuar në një
çetë tjetër.

Mbas një beteje ku Moisiu tregoi trimëri të rra-
llë, ne iu lutëm atij të tregonte një nga ato «histori-
të» e kaçakëve dhe ai nuk na e prishi qejfin...

«...Kishte ardhur pranvera dhe mbi Malin e Tu-
neshit shikonim fytyrën e saj të blertë. Ishim tetë
kaçakë me tetë nagante në brez e tetë martina në
krahë. Të lodhur nga bredhjet, pritrat, atë mëngjes
u ulëm në një lëndinë të vogël të rrethuar me pisha
të larta dhe qëndronim paksa larg njëri-tjetrit. Në
mal kishim dalë për arsye të ndryshme, por ajo që
na bashkonte, ishte urrejtja për të pasurit dhe ishim
betuar që t'i zhduknim një nga një me martinat to-
na. Thashë se kishte ardhur pranvera, por ne gjer
atëherë nuk e kishim vënë re. Unë, të paktën, kështu
mendoja, tek isha mbështetur pas atij trangu të pi-
shës së re. Edhe kapedani ynë, Qenani, siç dukej, një
gjë të tillë mendonte. Ai ia kishte qepur sytë pyllit
të bleruar dhe nuk ngopej së shikuari. Në mes të
pyllit dredhonte një rrugë e ngushtë këmbësore, ku
kalonin fshatarët për në pazar. Pak më poshtë saj
ishte një rrugë ca më e gjerë për kuajt që kalonin në
urën e vogël të përroit të Disakës dhe hidheshin ma-
tanë, në qytet. Midis rrugës së ngushtë këmbësore
dhe rrugës së kuajve shtrihej një pyll i vogël me pi-
sha, me një lëndinë të vogël në mes, ku buronte një
ujë i ftohtë. Qenani na pati thënë që të zinim vend

aty dhe edhe të pushonim, edhe të shikonim nga rru-
ga e kuajve, se mos kalonte ndonjë tregtar sidomos
ata Agathinët, që i kishim aq «qejf»... Po ne atë
ditë sikur e harruam detyrën dhe rrinim si të lo-
dhur e të trishtuar; na kishte mahnitur blerimi, lulet,
këngët e zogjve...

Qenani, ashtu si dhe unë, ishte mbështetur pas
një pishe dhe këndonte me zë të ulët një këngë të
lashtë. Më kishte kthyer shpinën dhe nuk e shikoja
dot në fytyrë. Atë ditë ne sikur e kishim bërë me
fjalë që t'i kthenim shpinat njëri-tjetrit dhe të
mbeteshim vetëm me mendimet tona.

— Kapedan, ke uror? — e pyeta Qenanin.

Ai u kthye nga unë, dhe, pa thënë asnjë fjalë,
më hodhi urorin. Sytë e tij në ato çaste nuk ishin
më ata të zakonshmit, me vështrim të mprehtë dhe
depërtues, tani vështrimi i tyre ishte i butë dhe i
ëmbël. Kurrë nuk kisha vënë re në sytë e tij një
shprehje të tillë butësie dhe ëmbëlsie si atë ditë...
Ndeza eshkën. Era e mirë e saj u përhap në pyll
dhe ngacmoi edhe kapedanin. Iu afrova afër.

— Ç'ke, kapedan? — e pyeta.

M'i hodhi sytë bojë qielli, që i ishin lëngëzuar
dhe tha:

— Pylli, Moisi, pylli. Qenka fort i bukur sot...

Qesha fort dhe ai më shikoi përsëri po ashtu, me
ëmbëlsi.

— Po ne ka kohë që jetojmë në pyll, kapedan.
Ç'të ka hipur sot që më flet kështu për të, sikur
nuk e ke parë kurrë?!

— Nuk e kisha vënë re se pylli është kaq i bukur,
— tha ai dhe heshti.

Nuk qesha më dhe as e ngacmova me fjalë, se
m'u duk që kishte të drejtë. Ai nuk e kishte vënë

re se pylli ishte kaq i bukur. Mbase edhe të tjerët në ato çaste po zbulonin bukuri të reja, që nuk i kishin vënë re më parë. Jeta e kaçakut ka lidhje të ngushtë me pyllin. Në pyll zinin pritat, strehoheshim, mbroheshim, sulmonim... Po gjer atëherë ne e kishim parë pyllin vetëm nga kjo anë dhe nuk e kishim vrarë mendjen e nuk na kishte rënë në sy se ai ishte edhe i bukur, shumë i bukur... Përroi i Disakës, me ujë shumë të kulluar, gremisej tatëpjetë nëpër ca gurë të mëdhenj dhe të bardhë, që në një rën anë ishin të veshur me myshk. Në një vend, pak më poshtë urës së drunjte, shtrati i përroit pritej si me thikë, duke formuar një katarakt të vogël, reflekset e të cilit shkriheshin dhe përflakeshin me lulet shumëngjyrëshe dhe gjelbërimin e pyllit. Njëherë ne deshëm ta gërryem bregun dhe të vinim aty prita për të kapur peshq, por Qenani na tha të mos e prishnim atë breg aq të bukur. Bukurinë e atij katarakti dhe të atij breg përroi e kishim vënë re, por tani po vinim re edhe bukurinë e pyllit.

— Ç'të bëjmë sot, kapedan? — e pyeta.

— Lërmë rehat, Moisi. Dua të mos mendoj asgjë...

Nuk i fola më, po hodha sytë te rruga e ngushtë këmbësore që dredhonte përmes pyllit. Nga rruga po vinte drejt nesh një fshatar me një lopë. E kishte lidhur nga brirët me litar dhe mezi e tërhiqte se, çast pas çasti, lopa ngulte kokën në barin e njomë. Fshatari kishte veshur një palë pantallona të arnuara, një këmishë të bardhë, edhe ajo e arnuar...

— Na erdhi një lopë te turiri, kapedan, — i thashë Qenanit. Këtë e thashë më tepër nga dëshira për t'i tërhequr vëmendjen. Qenani hodhi sytë nga rruga dhe mua m'u duk se atij i erdhi keq që po trazo-

hej në ato çaste. Në sytë e tij vazhdonte po ai lëngëzim i parë, si lëngu i drurit të ri të arrës, nga i cili, në kohën e fëmijërisë, bënim pipëza në pranverë. Befas ky lëngëzim u zhduk dhe në sytë e tij pashë një dritë të re. Ai u ngrit dhe me hapa të ngadaltë doli në rrugë të priste fshatarin. U ngritëm edhe ne e vajtëm pas tij. Fshatari na vuri re vetëm kur ishte dhjetë-pesëmbëdhjetë hapa larg. Në sytë e tij kishte ankth. Ai i vuri lopës dorën në shpinë. Na njo-hu që ishim kaçakë dhe frika i hyri në palcë. Kapedani ynë, Qenani, nuk kishte grabitur ndonjëherë kalimtarë të rastit dhe ne u çuditëm se si atë ditë ai priste me padurim aty në rrugë.

— Ec, ec, — i foli ai fshatarit.

Fshatari u përpoq ta tërhiqte lopën, por i ishin prerë fuqitë.

— Moisi, — më foli Qenani, — shko dhe ndihmoji.

E kapa litarin dhe e tërhoqa lopën me forcë.

— Mos ma merrni lopën, se e kam për bukën e fëmijëve, — m'u lut fshatari mua.

— Këtë e di kapedani. Ne bëjmë ç'thotë ai. Po e pate për bukën e fëmijëve, ai nuk ta merr.

Arrita pranë shokëve së bashku me fshatarin dhe lopën.

— Ku e shpie lopën? — e pyeti Qenani.

— Në pazar. Dua ta shes, — Fshatari qe zverdhur.

Vështrova Qenanin për t'i lexuar mendimet. Fytyra i kishte marrë një shprehje mirësie. Po e shikonte fshatarin me dhembshuri. Fshatari na shikonte me radhë të gjithëve. Pastaj e uli kokën përdhe dhe nuk e ngriti më gjer kur i foli kapedani ynë.

— Ngrije kokën. Burrat nuk e ulin kokën as para litarit.

Fshatari ngriti kokën. Në sytë e tij tani nuk lexohej kurrfarë frike. Bile në ata sy kishte guxim.

— Po të keni burrëri, nuk ma merrni lopën, — tha ai dhe e vështroi kapedanin në sy.

— Domethënë ne nuk jemi burra, ë? — tha Toma i egërsuar.

Fshatari nuk foli dhe Qenani e vështroi Tomën në sy. Vështrimi i tij ishte i egër.

— Ti mos fut hundët para meje, — i tha ai Tomës.

Toma nuk u ndie më dhe u tërhoq disi mënjane.

— Nuk më njeh? — e pyeti kapedani fshatarin.

Tjetri vështroi më me vëmendje. Pastaj picërroi sytë dhe iu afrua paksa kapedanit, që ta shihte nga afër. Kapedani buzëqeshi.

— Qenan?! Ti?! As kisha për të të njohur, po të mos kishe qeshur. — Fshatari tani ishte i gëzuar, kurse ne të habitur. Kapedani e mbështolli plakun me krahët e tij të fuqishëm dhe e rrsi në gjoksin e gjerë. Fshatari po dihaste si një fëmijë i lumtur.

— Kujtova se më iku lopa, — tha ai i prekur.

— Nuk u kemi marrë kurrë gjënë fukarasë, — i tha kapedani atij.

— Ah, Qenan, Qenan, u bënë kaq vjet. Qenke bërë si plep...

— Jemi nga një fshat, — na tha Qenani neve.

— Qenani, edhe kur ishte i vogël, nuk linte dy gurë bashkë, — tha fshatari dhe qeshi.

— Përse e shet lopën, Nexhip? — e pyeti kapedani.

— Të thashë një herë. Kemi mbetur pa bukë. Pa qumësht rrihet, por pa bukë jo.

Fshatari u vrenjt. Edhe Qenani ra në mendime.

— Mos e shit lopën, — i tha ai më në fund.

— Ç'të bëj?

— Do të të jap unë një copë letër dhe me të do të shkosh e do të marrësh grurë të Agathinët.

Fshatari u habit. Ai nuk mund ta merrte me mend se si mund t'u merrje Agathinëve grurin me një copë letër. Ai lagu buzët e thara me gjuhë dhe u bë gati të thoshte diçka. Sytë e tij sikur thoshin: «A është në rregull ky Qenan, apo jo?»

— Kur je bërë mik me Agathinët ti? — e pyeti ai kapedanin.

— Nuk do të ta japin grurin nga dëshira, por nga frika. E dinë se u rrjep lëkurën, po i kapa, — tha kapedani.

Po fshatarit, siç dukej, prapë nuk i mbushej mendja. Fjalët e Qenanit as nuk e ngrohën, as nuk e ftohën.

— Më ler të shes lopën, o Qenan. Të kisha mundësi, ua kisha marrë me kohë grurin Agathinëve dhe gjithë të pasurve. Lërmë të shes lopën dhe të shoh hallin që kam. Fëmijët nuk presin...

Qenanit nuk i pëlqeu që bashkëfshatari i tij po fliste kështu. Ai, ose nuk kishte besim te fjalët e tij, ose ishte njeri zemërpulë, që dridhej para Agathinëve dhe nuk guxonte t'u shkonte as në shtëpi...

— Mos fol kështu, Nexhip. Të kam ditur më burrë, — i tha atij Qenan dhe për herë të parë në fytyrë, që nga çasti i takimit me fshatarin, i pamë ftohtësi.

— Ti e di se fisi im nuk është fis frikacakësh, o Qenan. Të parët e mi kanë luftuar kundër të gjithë atyre që kanë ardhur për të na pushtuar. Ti lufton, por nuk e di se kundër kujt lufton... Unë i urrej Agathinët, por grushti patllake nuk bëhet.

Me një copë letër nuk u shkohet në derë atyre...

— foli me rrëmbim fshatari, i prekur në sedër.

— Patllaken e kam unë, o Nexhip, edhe martinën e kam unë. Ty nuk kanë ç'të duhen. Ti merr grurin dhe çoje në shtëpi. Po nuk ta dhanë, hajde se ua rregulloj unë qejfin. Të më përmjerësh mu në armë, po nuk i rropa të gjallë.

Qenani fliste me një zemërim të përmbajtur.

— Kaçakë ka pasur sa është krijuar bota, o Qenan, po edhe varfëri ka pasur dhe ka ca më shumë... Kaçaku nuk e ka zhdukur varfërinë dhe as ka për ta zhdukur kurrë. Ti ke vrarë një bej, o Qenan, po bejlerët e tjerë po bëjnë ç'u do qejfi në kurrizin tonë. Përse nuk kanë frikë ata nga martina dhe patllakja jote? Më lër të shes lopën dhe të shoh hallin që kam...

— Si thua ti, Nexhip, të mos ua marrim të pasurve atë që e kanë fituar pa djersë?

— Kështu, siç bën ti, nuk ua merr dot, — tha fshatari.

— Po si u merret?

— Me pushkë!

— Po kjo a nuk është pushkë, — tha Qenani dhe goditi me pëllëmbë qytën e martinës.

— Pushkë është, o Qenan, po nuk po futet në punë ashtu si duhet... Ti ke kohë që nuk ke ardhur në fshat. Ka mjaft djem nga fshati ynë që kanë rrokur pushkën. Pushkët e tyre qëllojnë për liri. Agathinët e tërë armiqtë po dridhen nga pushkët partizane e jo nga pushkët tuaja, o Qenan, — tha fshatari, duke na përfshirë të gjithëve me një shikim.

— Paskë mësuar shumë gjëra, Nexhip, — i tha fshatarit Qenani.

— Këto nuk i di vetëm unë. Ti je trim, bashkë me këta shokët e tu, po trimëria vete dëm, kur nuk di ta përdorësh...

Kapedani mbeti i habitur. Edhe ne rrinim si të shushatur.

— Mirë o Nexhip, shite lopën, shite.

Qenani i dha dorën dhe u largua i pari. Ishte i mërzitur. U përshëndetëm dhe ne me fshatarin dhe e ndoqëm me sy gjersa humbi matanë pyllit. Iu afroam Qenanit.

— Trim ishte, kapedan, — tha Toma për fshatarin.

— Ishte edhe i gojës, — thashë unë.

— Tha ca fjalë të bukura, — foli përsëri Toma.

— Kam kujtuar se ne bëjmë mirë... — thashë unë.

— Po tani si mendon? — më pyeti Qenani.

— Tani? Nuk di ç'të të them. Fjalët e tij m'u dukën të drejta. Ne mendojmë se kushedi ç'po bëjmë, por ai na e tha hapur, se nuk po bëjmë asgjë.

Qenani sikur u zbut, këtë nuk e tregoi me fjalë, por unë ia hetoja në tiparet.

— Kaçaku nuk e zhduk varfërinë, ë? Kështu tha Nexhipi? — na pyeti ne Qenani.

— Kështu tha, — foli Toma.

— Dhe e kishte shumë drejt, — tha dhe Kristoja.

— Mbase, mbase... — tha Qenani dhe u nis drejt asaj lëndinës së vogël, ku ishim ulur para se të vinte fshatari. Shkuam edhe ne pas tij dhe u ulëm. Rrinim të heshtur dhe të vrenjtur.

Kaluan disa ditë. Rasti e solli që të shkonim përsëri te ajo lëndinë. Diçka po shembej brenda nesh dhe po ia linte vendin diçkaje të re. Kjo kishte filluar kohë më parë. Kapedani nuk ishte më

ai i pari, nuk ishte më ai Qenani i gëzuar dhe kokë-
krisur, i shpejtë si rrufeja dhe i egër si tufani... Ai
kishte ndryshuar, të gjithë ne kishim ndryshuar...
— Ç'mendon, kapedan? — e pyeta kur e pashë
të mbështetur pas trungut të pishës së re, si atë-
herë. Në sy kishte po atë dritë.

— Kapedan, ë?— tha ai me tallje për veten.

— Po, kapedan je, — i thashë.

— S'të kujtohet Nexhipi? — më pyeti ai.

— Po, më kujtohet...

— Mua s'më hiqet nga mendja... Drejt e kish-
te Nexhipi, Moisi. Edhe ti e kupton se e kishte drejt,
por se si të vjen ta thuash. Edhe Toma, edhe Kris-
toja, Salih, të gjithë e kuptojnë. Po unë e kam
kuptuar edhe vetë, o Moisi. Vërtet, pushka jonë nuk
qëllon ku duhet dhe dora jonë nuk e zhduk var-
fërinë...

Më foli gjatë, më foli i frymëzuar. Si pa vënë
re, u afruan edhe të tjerët pranë nesh. Dëgjonim
Qenanin dhe zemra ma thoshte se ai nuk do të
ishte më kapedani ynë.

Nuk kaloi shumë kohë dhe u ndamë. U përqa-
fuam dhe u puthëm shumë herë... Hymë të gjithë
në radhët partizane...

KOPI

Ishin vitet e para pas Çlirimit. Mbarova shkollën fillore dhe kisha shumë dëshirë të vazhdoja shtatëvjeçaren, por në fshatin tonë asokohe nuk kishte. Më thanë të bëja dokumentet e të shkoja me bursë të shtetit në qytet. Mbëta në pritje për një muaj, kur një ditë babai më tha se do të shkoja në shkollë...

Ndjeva një lumturi kaq të madhe, sa rrallëherë e kisha provuar në jetë.

Edhe pak ditë dhe do të fillonte viti shkollor. Babai se nga gjeti ca dërrasa e thirri një usta, që më sajoi me to një sënduk që unë e quaja vali-xhe. Sënduku ishte i rëndë, sa mezi e ngrija bosh... Po s'kisha ç'bëja, valixhe të vërtetë nuk kisha.

Erdhi dhe dita e nisjes. Babai vuri sëndukun tim në sup dhe priu përpara. Brenda në të nëna më kishte futur ndërresa, ca kuleçë, petulla dhe pak arra të qëruara. Ajo më përcolli gjer te Kodra e Mullirit. Iu hodha në qafë dhe nuk doja të shqitesha prej saj. Ishte ndarja jonë e parë... Por shpejt e kuptova që ajo do të mërzitej shumë, po të tregohesha qaraman. Fundja, po shkoja për të

mësuar... U ndava me lehtësi dhe eca pas babait, pa e kthyer kokën fare...

Babai, në vend që të merrte rrugën për në qytet, u kthye andej nga pylli, tek ajo lëndina e vogel, ku punëtorët rrokullisnin trupat e ahut.

— Përse këndej, baba? — e pyeta.

— Do të shkosh me makinë. Kam biseduar me një shofer, — tha ai.

Nuk më erdhi mirë që babai do të më linte vetëm. U ngrysa në fytyrë dhe ai e vuri re këtë.

— Do të shkosh me Kopin. Është njeri i mirë.

Këto fjalë ma larguan disi shqetësimin, si ajo era që përzë nga qielli retë.

Te sektori po ngarkonin trupa tri makina.

— Është ajo atje, — tha babai, duke më treguar një makinë me kabinë jeshile.

U ulëm në ca trupa të mëdhenj ahu e po prisnim. Pas pak Kopi erdhi drejt nesh. Ishte një burrë rreth të pesëdhjetave, trupmadh, e shpatullgjerë, me ca sy të vegjël, që i lëvrinin tërë gjallëri, me një hundë të madhe dhe pak të kërrusur.

— Ky është shkollari? — e pyeti ai babanë dhe më hodhi mua një shikim të ngrohtë. Pastaj më zgjati dorën, sikur të ishim miq të vjetër. Kishte një dorë të madhe e të ashpër.

— Si të quajnë? — më pyeti.

— Javer.

— Ç'do të bëhesh ti, Javer?

Ngrita supet, pa ditur ç'të thosha.

— Mbaro shkollën një herë, pastaj kollaj është, — tha ai, si i penduar për pyetjen që më bëri.

Pastaj i tha babait që të shkonte në shtëpi, se makina donte shumë kohë për t'u ngarkuar. U ndava me babanë. Prita për një kohë të gjatë aty, nën

hijen e aheve. Më mori uria. Hapa sëndukun dhe nxora që andej një petull. Kopi më pa dhe buzëqeshi. I dhashë një dhe ai nuk ma ktheu. Më falënderoi dhe e hëngri me dy-tri kafshata. Mendova se kishte uri dhe doja t'i jepja edhe ndonjë gjë nga ato që kisha në sënduk.

— Unë kam mjaft. Mos do? — e pyeta.

— Mirë, më jep, — tha ai.

I dhashë edhe një petull dhe i tregova kuleçët. Ai mori dhe një kulaç e filloi ta hante me oreks të madh.

— Kulaç nëne, — tha dhe më vështroi në sy.

Mua m'u kujtua nëna dhe m'u duk sikur kisha disa ditë që isha ndarë prej saj.

— Do t'i ndërrojmë, — tha Kopi dhe u ngjit në kabinë.

Nuk e kuptova se çfarë do të ndërronim. Ai u kthye me një pako të vogël në dorë, mbështjellë me gazetë. Më vuri përpara një copë të madhe bukë gruri dhe mish konserve.

— Ha, se unë nga të tuat dua, — më tha.

Po më hynte në zemër ky njeri. Ai ishte vërtet i mirë, siç më kishte thënë babai. Pasi hëngrëm drekë, ai vuri sëndukun tim në kabinë dhe më tha edhe mua që të ngjitesha lart. Zura vend në ndenjësën e butë, pranë tij. Kurrë në jetën time nuk kisha udhëtuar me makinë. As shokët e mi nuk kishin udhëtuar. Veç djali i Din Halilit, që ishte i pasur, dhe mburrej për këtë. Po tani ishim ne djemtë e fukarenjve që merrnim rrugët e jetës...

Motori uturiu dhe makina bëri përpara. Ishte mrekulli të udhëtoje me makinë në atë rrugë që dredhonte përmes pyllit të dendur me ah e pisha. Gjer atëherë, pyllin e kisha parë vetëm nga larg

dhe nuk ma merrte mendja të ishte kaq i bukur. Drurët e ahut ishin të drejtë dhe me lëkurë lara-lara, si ato vezët e laraskave që i gjenim aq shpesh... Pishat ishin akoma më të drejta dhe më të larta, kurorat e tyre ngriheshin mbi të gjithë drurët e tjerë. Kishte dhe pisha të thara, krejtësisht të thara, që qëndronin në këmbë si skelete, kishte dhe pisha që kishin një të çarë të thellë nga maja gjer në fund. Doja ta pyesja për këtë Kopin, por më vinte turp. Vonë e mora vesh se ato pisha ishin djegur nga rrufeja.

Si dolëm nga pylli, rruga gjarpëronte mu sipër fshatit tim, që nga ajo lartësi dukej si në pëllëmbë të dorës. Në zemër ndjeva një mall të patreguar, kur pashë shtëpinë time, nënën dhe babanë, që kishin dalë për të mbledhur barin, pashë shokët që luanin rrasash në Cekë, pashë lumin që dukej si shirit i artë. Sytë m'u njomën dhe bëra përpjekje të madhe të mos qaja.

— Fshati, — më tha Kopi.

— Po, — mezi thashë unë.

— Eh, eh, — ia bëri ai dhe unë nuk e kuptova se ç'deshi të thoshte.

Rrotulloi timonin pak nga e majta dhe tashmë makina vraponte pas qafës së malit. Në një vend rruga ishte me shumë baltë. Ujësonte pylli nga kalonte xhadeja. Kopi ndërroi marshet dhe deshi ta kapërcente me shpejtësi atë copë vend. Po makina, sa arriti aty, shtërzoj dhe mbeti. Forcat e kishin lënë, si të ishte njeri...

— Dreq o punë, — tha Kopi dhe e nisi makinën pas.

Doli nga kabina. Desha të dilja edhe unë, por ai ma bëri me dorë që të mos luaja nga vendi. U

fut në pyll dhe filloi të thyente degë të njoma ahu. Bëri një krah të madh dhe i vuri në vendin që ujësonte. U fut në kabinë dhe nisi makinën.

— Kaluam, — tha i gëzuar, ndonëse rrotat e pasme akoma nuk kishin dalë nga baltovina.

Në qytet arritëm vonë.

— E di shkollën? — më pyeti Kopi.

— Jo.

— Po edhe në mos shkofshim sonte, nuk priset punë, — më qetësoi.

Makina u shkarkua vonë dhe Kopi e la afër fushës së druve.

— Nisemi, — tha ai dhe kapi sëndukun tim.

— E mbaj vetë, — i thashë dhe doja t'ia merrja nga dora.

Ai buzëqeshi, por sëndukun nuk e lëshoi. Vëshetroi orën. Kishte një orë të madhe që më dukej se ishte bërë me porosi për krahun e tij të trashë.

— Është vonë, — tha.

— Për çfarë?

— Për në konvikt. Tani fëmijët kanë rënë të flenë dhe nuk bën t'i zgjosh, — tha ai dhe qeshi.

Nuk fola. Fillova të mërzhitesha pak.

— Hajde! — Edhe këtë herë nuk më tha se ku do të shkoim.

Ëcja pas tij në atë mbrëmje gushti, duke seditur shtëpitë, rrugët, sheshet. Qyteti, sado që ishte shumë i vogël, mua më dukej i madh, plot zhurmë e gjallëri.

Më në fund mbërritëm para një barake, ndërtuar me dërrasa, që ishte në të dalë të qytetit. Kopi tundi derën, por ajo nuk hapej. Atëherë futi dorën në xhep dhe nxori një çelës. Brava kërciti dhe

dera u hap duke kërkëllirë. Pastaj ndezi dritën dhe qëndruam në mes të barakës.

— Kjo është shtëpia ime, — tha thjesht ai.

Ishte një dhomë e vogël me dy shtretër prej dërrase.

— Ti do të flesh këtu, — më tha, duke më treguar njërin krevat, që ishte i rregulluar mirë dhe me çarçafë të bardhë.

U ula në shtratin ku do të flija. Rruga më kishte troshitur dhe ndihesha i lodhur. Më kishte marrë edhe uria.

— Tani do të hamë darkë, — tha Kopi dhe bëri të dilte nga dhoma.

— Unë kam këtu, — i thashë dhe i tregova sëndukun. — Bile kemi për të dy, — shtova pas pak.

— Ato ruaji për më vonë. Diçka do t'u japësh edhe shokëve, apo jo.

Dolëm të dy dhe, pasi ecëm paksa, u futëm në një restorant. Aty nuk kishte shumë njerëz. Në një tryezë ishin ulur nja katër burra, të cilët, siç dukej, ishin shoferë. U përshëndetën me Kopin dhe në sjelljen e në sytë e tyre vura re një respekt të thellë për të. Mua më hidhnin ca shikime që nuk dija si t'i merrja...

— Është djali i një shoku, — u tha Kopi atyre. — Ka ardhur për të bërë shkollë në qytet.

Erdhi kamerieri dhe Kopi porositi për të dy. Për vete mori edhe një gotë raki.

Shoferët u ngritën dhe ikën.

I thashë Kopit se nuk mund t'i haja të gjitha ato, që kishte sjellë kamerieri.

— Të bëfshin mirë, Javer. Një burrë që nuk ha, nuk është burrë, — tha ai dhe qeshi si fëmijë.

Të nesërmen u ngrita i ngopur me gjumë dhe

tërë qejf. Nga dritarja kishin hyrë në barakë rrezet e diellit. Dukej që dita do të ishte e nxehtë. E ndjeva veten të gëzuar, por u habita kur vura re se Kopi nuk ishte në krevat. Krevati ishte rregulluar. Më kapi një farë shqetësimi. Mu sipër krevatit, në mur, tek koka, ishte vënë një fotografi, të cilën nuk e kisha vënë re më parë. Ishte fotografia e një fëmije rreth trembëdhjetë vjeç. Ai më vështronte që nga fotografia me ca sy të vegjël, që ngjanin me ata të Kopit.

Dera e barakës u hap dhe hyri Kopi. Ishte i qeshur dhe i gëzuar.

— Mirëmëngjes!

— Mirëmëngjes!

Pas gjysmë ore, si hëngrëm dhe mëngjesin po në atë restorant ku kishim ngrënë një natë më parë, u nisëm për në konvikt. Përpara ecte Kopi me sëndukun tim në sup. Mua më kishte kapur për dore, sikur të isha fëmijë i vogël. Më vinte turp nga kjo gjë, por akoma më turp më vinte t'ia thosha këtë Kopit.

— Javer, — më tha, kur u ndamë, — do të vij të të shoh prapë.

Nuk fola, por iu hodha në qafë, ashtu si nënës dhe babait.

Për disa muaj nuk e pashë më dhe më mori malli shumë për të.

Për Kopin mësova disa gjëra që nuk i dija më parë. Kishte qenë partizan së bashku me të birin katërbëdhjetëvjeçar, Agimin. Agimi ishte korrier i batalionit. Një ditë ai kishte për të çuar një lajm tepër të rëndësishëm në shtab. Gjermanët e diktuan dhe e rrethuan, po ai nuk u ra në dorë i gjallë...

Ja pra, kush ishte ai djali që më shikonte me atë buzagaz të lehtë që nga fotografia.

Një pasdite më lajmëruan se dikush më kërkonte te porta. Zemra më rrahu fort dhe mendja më shkoi menjëherë te Kopi. Vërtet ai më kërkonte. Iu hodha në qafë dhe sytë m'u mbushën me lot.

— Qenke bërë burrë, Javer, — më tha.

Unë nuk flisja veç i fërkoja duart.

— Ku ishte kaq kohë? — më doli gati pa dashje kjo pyetje.

— Kam shërbyer larg. Mbrëmë erdha. Më kanë dhënë shtëpi. Kam sjellë edhe gruan, — tha ai.

U habita dhe u gëzova. Po brenda gëzimit tim kishte dhe ca hutim.

— Na pret të dyve, — tha ai dhe ndjenji duke më shikuar sikur donte të pikaste se ç'përshtypje do të më bënin ato fjalë.

— Sonte? — e pyeta.

— Sonte, nesër dhe pasnesër... — tha ai dhe buzëqeshi në mënyrë kuptimplote.

Nuk kuptova še ku e kishte fjalën Kopi.

— Tani ti duhet të rrish te ne. Bursën le ta marrë ndonjë tjetër, — tha ai dhe më pushtoi në krahë.

Isha i turbulluar nga lumturia dhe dashuria që ndieja për këtë njeri. Nuk dija si t'i përgjigjesha.

— Të pyes një herë babanë, — i thashë dhe m'u duk se po e lëndoja me ato fjalë.

— Po, po. Pyete, por për sonte nuk ke pse ta pyesësh, — më tha dhe u nis për në drejtori të më merrte leje.

DY RAPSODËT

Autobusi rrëshqiste me shpejtësi drejt një gryke të thellë paralel me lumin, që zbriste dallgëfryrë nga shirat e vjeshtës. Peisazhi ishte i murrëtyer. Gjethet e dushkut kishin rënë dhe pylli kishte mbetur i zhveshur e të dukej sikur po vajtonte. Kishte një javë që binte vazhdimisht shi. Përrrenjtë zbrisnin tatëpjetë maleve dhe kodrave me uturimë gjëmimtare, duke e turbulluar lumin, që e kishte zgjeruar shtratin më shumë se asnjëherë. Mjegulla e bardhë, si leshi i një deleje rude, qëndronte e palëvizur mbi lumë, mbi zhurin me zaje të bardhë dhe vetëm në lartësinë e kodrave sikur davaritej.

Udhëtarët rrinin disi të heshtur dhe shikonin me ëndje këtë peisazh, i cili, edhe në këtë ditë të vrenjtur, kishte diçka tërheqëse dhe të bënte ta admiroje. Një plak, ulur nga fundi i autobusit, bisedonte me një djalosh të ri dhe seç tregonte me dorë matanë lumit, ku shtrihej një fushë e gjerë e sapokorrur nga misri. Dy kolltuqe më larg plakut që ulur një malësor që mbante në dorë një çifteli të punuar me kujdes. Atë e quanin Pjetër. Pranë tij ishte ulur një vajzë e re.

— Po vene, he burrë, lart, se të lodhi, — i tna piaku Pjetrit per çiteline.

— Nuk me lodn, jo, — tha Pjetri dhe buzëqeshi.

— Nuk thynet eane lart, — i tna perseri piaku, duke treguar me kokë rartin e autobusit.

— Nuk tmem se thynet, por e moaj edhe në dorë, — tha perseri Pjetri po me ate buzëqeshje.

Pjetri ishte nje burre rreth të dyzetave. floket i kishte të thinjur dhe kokën e kishte disi të vogel për atë trup të madh. Krahët i kishte të gjatë dhe gishtërinjtë të hollë, shumë të hollë. Kishte një vështrim të ëmbël dhe ca ëndërrimtar. Vajza ishte rreth të tetëmbëdhjetave. Ajo kishte flokë të zinj, vetulla të zeza dhe sy të bukur, që të shikonin me druajtje përmes qepallave të bukura. Kur fliste vajza, Pjetri buzëqeshte dhe miratonte me kokë. Ajo tundje e lehtë koke i kishte shumë hije dhe e bënte të dukej ca më i ri sesa ishte. Kur fliste Pjetri, vajza përplaste qepallat në heshtje. Ajo anonte pak kokën nga Pjetri dhe dëgjonte me vëmendje.

Dikush atje nga kreu i autobusit ia mori këngës. Këndonte një burrë shpatullgjerë, që kishte një zë të fortë, por aspak të ëmbël. Fjalët sikur i dilnin me rrëmbim nga gryka dhe lëshonin diçka si gurgullimë... Sa filloi kënga, Pjetri dhe vajza e ndërprejnë bisedën dhe filluan të dëgjojnë në heshtje të plotë, ndonëse burri nuk këndonte bukur. Nuk mund ta kuptoje nëse u pëlqente ajo këngë, por dukej qartë se kënga në përgjithësi ishte e dashur për ta... «Të lumtë goja», i thanë ata pas-taj burrit. Ai u ngrit sakaq dhe u kthye pas. U hodhi një vështrim udhëtarëve të tjerë sikur donte të dinte nëse i kënaqi me këngën apo jo. Papritur

vështrimi iu mbërthye mbi Pjetrin dhe vajzën. Ai u gjallërua dhe në tiparet e fytyrës iu shpreh një kënaqësi e madhe.

— Po këtu paske qenë, o Pjetër Zemani? — e pyeti Pjetrin dhe e përqafoi.

— Po, — tha Pjetri.

— Po kësaj i thonë «hajde, babë, të të tregoj arat». Po a duhet të këndoju unë para teje?

— Ani, ani — tha Pjetri shumë i kënaqur dhe buzëqeshi me përzemërsi.

— Hajde tani dhe këndo, o Pjetër. Dil andej nga radhët e para, — i tha burri dhe i vuri dorën në shpatull, që ta ngrinte.

— Jo, or ti. Po qe se ky shoku këndon mirë, le të këndoju këtu ku është, — kundërshtoi plaku.

Pjetri vazhdonte të buzëqeshte dhe tha se do të këndonte aty ku ishte. Udhëtarët u gjallëruan. Pjetri vështroi vajzën.

— A këndojmë, Marie? — e pyeti atë.

Vajza nuk foli. Vetëm buzëqeshi ëmbël.

Pjetri ngriti çiftelinë dhe u bë gati t'i binte. Ai u mëshoi lehtë telave: ata nxorën ca tinguj të ëmbël, pak si të zgjatur. Shoferi ngadalësoi shpejtësinë. Të gjithë orisnin.

— Kë të marrim, Marie? — e pyeti Pjetri përsëri vajzën.

— C'të duash, — tha ajo dhe buzëqeshi si pak caste më parë.

— Do të këndoju edhe cika, a?! — u habit plaku.

— Edhe cika do të këndoju. Ajo këndon shumë bukur, — tha dikush.

— Marrim atë të Jovanit, — i tha vajza Pjetrit.

— Mirë, — tha Pjetri.

Ai Dora e djathtë e Pjetrit qëndroi disa çaste si e ngrirë mbi tela, pastaj një dridhje e fortë dhe melodia na pushtoi të gjithëve. Maria u afrua paksa nga Pjetri, që ia nisi i pari:

«U lëshua zëri në tërë vendin

Jovan Neri mblodhi kuvendin.

Mblodhi kuvendin e fjalën nis

«Pushka ashpër, — tha, — duhet të krisë...»

Pas Pjetrit filloi të këndonte edhe Maria.

Pjetri kishte një zë të ëmbël, fort të ëmbël, por si të shqimët. Zëri i tij ngjante me atë gurgullimën e ëmbël të krojeve, që rrjedhin pa u ndier përmes barit të bleruar. Zëri i Maries ishte më i fortë, më i tingëllueshëm. Ai ishte i fortë, aq sa nuk mund ta besojë se ishte zëri i një vajze të brishtë si Maria. Edhe ai, ashtu si edhe zëri i Pjetrit, ishte i ëmbël dhe të hynte thellë në zemër, por nuk ishte në gjendje ta kuptojë se nga vinte kjo ëmbëlsi. Pa mbaruar Pjetri njërin varg, ia fillonte Maria vargut tjetër. Zërat e tyre takoheshin dhe ndaheshin, ndaheshin dhe takoheshin. Të kujtonin ata zëra zilkat dhe këmborët që formojnë një akord të mrekullueshëm; diçka si melodi brenda melodisë, që përsëritet, po kurrë në të njëjtën mënyrë...

Melodia nuk i mbyste fjalët. Kënga pothuaj nuk kishte refren, por ai kombinim dhe harmonizim i bukur i zërave, ajo pritje dhe përcjellje e këngës së njëri-tjetrit zhduknin monotoninë dhe krijonin përshtypjen se çdo varg këndohej në mënyrë të re, të papërsëritshme...

Pjetri kishte anuar pak kokën nga Maria, kurse ajo gati e kishte mbështetur të xhami i dritares...

Ky statizëm në pamjen e jashtme sulmohej dhe shpërbëhej nga ai vrull i brendshëm, nga ai pasion i vrullshëm dhe i papërmbajtshëm, që buronte nga secili këngëtar sipas mënyrës së vet.

Kur dëgjoje këtë këngë, të dukej sikur në të ishin shkrirë bukur zhaurima e lehtë e valëve të lumit, zhurma e erërave, shushurima e gjetheve, oshëtima e malit, shkurt gjithçka... Veçse këta tinguj dhe zëra të natyrës sikur ishin përpunuar në zemrat e këngëtarëve dhe dilnin që andej, duke u përzier me afsh zemre, me dhembje, dashuri dhe pasion njerëzor.

Kënga fliste për heroizmin e malësorëve. Jovan Neri, që ishte prijësi i tyre, u përmend në fillim të këngës, pastaj doli populli. Në këngë, përveç emrit të Jovanit, rreshtoheshin edhe mjaft emra të tjerë nga populli.

Shoferi kishte qëlluar qejfli kënge dhe e ndali fare autobusin. Po askush nuk e vuri re këtë, as shoferin që erdhi e u ul në fund të autobusit, pranë atyre që këndonin... Të gjithë dëgjonin të shtangur. Kënga, siç dukej, ishte nga fundi. Prapë u përmend Jovani, u tha diçka rreth vdekjes së tij dhe një varri me gurë të gdhendur, që kishte ngritur populli për kujtimin e tij...

Ashtu si tërë rapsoditë, kënga ishte e gjatë, por këngëtarët nuk ndiheshin aspak të lodhur. Tani këngës sikur iu ndryshua ritmi. Tonet iu bënë më të larta. Pjetri sikur u shkund nga ëndërrimet e u gjallërua më tepër. Maria e ngriti zërin edhe më. Për një çast u duk sikur të dyve, Pjetrit dhe Mariës, do t'u këputej zëri dhe kënga do të mbetej pa mbaruar. Po ato nota të larta paskëshin qenë fundi

i këngës. Zërat pushuan, kurse Pjetri luajti me çifteli edhe për disa sekonda të tjera...

Pjetri ishte zbehur, ai ishte i emocionuar dhe disi i lodhur. Anoi kokën paksa nga dritarja dhe treti shikimin përjashta. Maria qëndroi në atë pozë, si pak çaste më parë. Një grimëherë në autobus ra një heshtje e thellë.

— Eh, eh, — tha shoferi dhe u ngrit e shkoi në timon.

— Kësaj i thonë këngë, — tha burri që kishte kënduar i pari.

— Ju këndoftë zemra. Na kënaqët, — u tha plaku Maries dhe Pjetrit.

«NUSJA» E NURI PETRINOS

Ishte fillimi i majit, por plaku Osman Petrino, para se të ngrihej nga shtroja, donte në dhomë një mangall me prush. Mëngjesi ishte i freskët dhe plaku kishte qejf të rrinte një copë herë mbi mangall, duke pirë kafënë që i sillte i biri, Nuriu. Edhe atë ditë, si gjithmonë, po pinte kafënë e mëngjesit, kur në derë u dëgjuan dy të trokitura.

I porsaardhuri, pasi mbylli derën, nuk bëri as edhe një hap përpara.

— Ulu, — e ftoi atë Osmani.

— Jam lajmëtar, nuk kam ardhur për të ndernjur, — tha Sitki Fariu.

— Më gjete duke pirë kafe. Kam dëshirë ta pijmë së bashku, — i tha atij plaku.

Atëherë Sitkiu u ul në lëkurën e leshtë, pranë tij. Plaku mori një filxhan dhe e mbushi me kafe.

— Për të mirë ta pifshim gjithmonë!

— E mira të gjettë!

Ata rufitnin në heshtje. Plaku priste që të fliste i pari Sitkiu.

— Ç'lajm po na sjell? — nuk iu durua plakut.

— Luftë, Osman, luftë. Na sulmuan serbët. Do t'i biem...

— Kur?

— Tani, sa të mblidhen...

Ata biseduan edhe ca kokë më kokë. Pastaj plaku Osman u ngrit dhe e përcolli gjer te dera e dhomës. Më tej ai kishte vite që nuk dilte për të përcjellë njeri. Këtë punë tashmë e bënin djemtë.

— U kthefshi me fitore, — i tha atij plaku.

— Mirë të gjeçim, — ia ktheu Sitkiu.

Osmani u ul pranë oxhakut, mbushi llullën dhe filloi të thithte në heshtje. Prej kohe e kishte bërë zakon që gjatë verës, kur binte dielli, të dilte në oborr e të rrinte një copë herë nën hijen e qershisë. Dhe rrallë qëllonte ta prishte këtë rregull. Por atë ditë koha po kalonte, dielli nisi të digjte e plaku ende s'kishte dalë. Djemtë u shqetësuan. Djali i dytë, Nuriu, trokiti lehtë në derë dhe hyri.

— Mos je i sëmurë, baba? — e pyeti ai.

— Nuk kam gjë...

— Nuk dole te qershia, prandaj...

— Do të dal, do të dal...

Nuriu u bë gati të hapte derën, kur i ati e pyeti:

— Jeni të gjithë këtu?

— Vetëm Gori ka vajtur për dru. Ne të tjerët jemi.

Gori ishte më i vogli. Ai akoma nuk i kishte mbushur të shtatëmbëdhjetat dhe plaku nuk kishte punë me të kësaj radhe.

— Ju të tjerët, hajdeni në dhomën time që tani.

Pas pak djemtë hynë njëri pas tjetrit.

— Uluni, — u tha plaku.

Ata u ulën sipas moshës: i pari Safeti, i dyti Nuriu, i tretë Seferi, i katërti Tafili, kurse i vogli Gori, mungonte.

— Do të kemi luftë. Kush nga ju do të shkojë kësaj radhe?

— Unë... — folën të katër njëherësh.

Plaku buzëqeshi i kënaqur.

— Më lini mua ta caktoj?

— Po, baba, — tha Safeti.

— Caktoje, caktoje, — thanë edhe të tjerët. Veç Nuriu heshte i menduar.

— Nuri, përse hesht ti? — e pyeti.

Nuriu e vështroi të atin në sy, por aty për aty nuk i foli.

— Unë kurrë nuk ta kam prishur, baba, por kësaj radhe nuk jam në një mendje... — tha pastaj.

— Përse?

— Sepse ai që do të marrë pjesë në luftë, është i caktuar.

— Po kush qenka ky që ne nuk e ditkemi? —

— pyeti plaku i habitur.

— Në luftën që u bë para katër vjetësh mori pjesë Safeti. Kjo është lufta e dytë që kur ne u bëmë zot të pushkës. Djali i dytë, pas Safetit, jam unë. A mund të shkojnë para meje Tafili, Seferi, Gori?

Plaku heshti. Thellë në shpirt ndiente një kënaqësi të madhe, që rrallëherë e kishte provuar në jetë. Po ai u përpoq ta fshihte këtë ndjenjë.

— Po unë për ty kam menduar. Ti do të shkosh. — e qetësoi atë plaku.

Nuriut i shkëlqeu fytyra nga gëzimi.

— Falemnderit baba, — tha ai i emocionuar.

Plaku e përkëdheli të birin veç me një shikim.

— Tani dilni jashtë. Ti, Nuri, bëhu gati. Do të niseni nesër.

Djemtë ishin duke kapërcyer pragun, kur i ati u thë:

— Më sillni edhe një kafe.

Pas pak ai po pinte kafënë i menduar. Atë ditë për herë të parë në jetë po e mbushte ibrikun dy herë radhazi. Duke pirë kafënë duke u ngrohur mbi mangall, mendja i shkoi larg, atëherë kur Nuriu...

Safeti, si djali më i madh, u martua i pari. Po nusja i vdiq pa mbushur motin në derën e Petrino-ve. Plaku Osman mendonte se njëri nga djemtë duhej të martohej shpejt që të bëhej shtëpia me një nuse e të shpëtonte plaka nga ato punët e rënda që ia kishin ngrënë shpirtin tërë jetën. Sipas moshës, radhën e kishte Nuriu, po plaku vendosi t'i thërriste të pestë e t'u kërkonte mendim...

— Njëri nga ju duhet të martohet. Për dasmën do të shesim mushkën dhe do të therim ato dy-tri dele që na kanë mbetur. Kjo është pjesa e atij që do të martohet. Si mendoni?

Djemtë heshtnin, disi të turpëruar.

— Flisni, — i nxiti plaku.

— Mua kot më ke thirrur, baba, — tha Safeti. Unë u martova një herë... Ky qe fati im... Unë e mora pjesën time.

— Ju thirra që ta pleqërojmë...

— Radhën e ka Nuriu, Nuriu le të martohet, — foli Tafili.

— Kështu është, — tha edhe Seferi.

Të gjithë ia ngulën sytë Nuriut. Ai rrinte i heshtur me sytë përdhe.

— Fol, Nuri, — i tha atij plaku. — Dëgjove ç'thanë vëllezërit?

— Tani që i vdiq gruaja, pa martuar do të rri-

jë Safeti? — pyeti Nuriu plakun.

— Pa martuar nuk do të rrijë, por do të mar-
tohet i fundit, kur të jeni martuar të gjithë ju, —
tha plaku.

U bë përsëri heshtje. Heshtjen duhej ta thy-
ente Nuriu, se për atë ishte fjala.

— Pjesën time e dua, por radhën për t'u mar-
tuar jo, — tha ai.

— Përse e do pjesën, kur nuk do të martohesh.
Pjesa është për martesë, — sqaroi plaku.

— E dua për pushkë. Me paratë e mushkës dua
të blej një martinë të re. Ajo do të jetë «nusja»
ime, — tha Nuriu dhe buzëqeshi lehtë. — Për t'u
martuar, le të martohet për së dyti Safeti, a cilido.

Plaku u habit nga kërkesa e Nuriut. Edhe vë-
llezërit u habitën dhe prisnin ç'do të thoshte plaku.

— Le të bëhet si do Nuriu, — tha më në fund ai,
pasi u mendua një copë herë.

Pas dy javësh Nuriu bleu martinën e re, kurse
Safeti u martua për së dyti. Fshatarët u habitën
kur morën vesh se Nuriu Petrinoja në vend të nu-
ses mori një martinë...

Plaku u shkund nga kujtimet, brofi në këmbë
e doli përjashta. U ul nën hijen e qershisë. Nuriu
po bënte përgatitjet për luftë. E ëma i rrinte pranë.
Ajo, sa e pa të shoqin, u largua e kërrusur dhe
e trembur, si gjithmonë. Po Osmani sot nuk ishte
më ai i zakonshmi. Sot ai edhe për të shoqen ndjeu
një farë dhembshurie dhe diçka si lëmsh i vogël
iu mblodh në grykë. «Ç'po ndodh kështu?! Mbase
e kam nga pleqëria. Eh, pleqëri, pleqëri... s'të
punon këmba e dora e të mbushen sytë me lot». I

hodhi një shikim së shoqes: ajo iu duk tepër e vogël dhe e mjerë.

— Rri, moj, dhe shikoje djalin, rri, — i tha ai së shoqes.

Ajo u çudit dhe e vështroi Osmanin me përmallim. Ai ishte nisur shpesh në luftë kundër armiqve. Asaj i kujtoheshin të gjitha ikjet e tij dhe zemra i pikonte gjak. Ishte e re dhe e bukur atëherë, po i shoqi nuk i kishte folur kurrë një fjalë të mirë. Sa herë ajo e kishte qortuar atë për vrazhdësinë e tij, por, kur ai nisej për në luftë, ajo ia falte të gjitha, ngashërehej dhe zemra i rrihte me rrëmbim. Atëherë ndodhte pajtimi i tyre i vërtetë, ajo lumturi e vogël që zgjaste aq pak... Ajo i varej në krahë deri te thana e vogël dhe ia qullte rrobat me lot. Më tej nuk shkonte dot, se e shikonte fshati... «Të më kthehesh, Osman», i thoshte e qante e qante... «Do të kthehem», i thoshte ai pa e parë në sy, nga frika mos e tradhtonte ndonjë lot.

* * *

Të nesërmen ushtria fshatare, që komandohej nga Elmaz Ismeti, u mbledh te Livadhi i Madh, poshtë të cilit shtriheshin ca bregore të bukura dhe më tej, deri buzë lumit, shtrihej fusha e gjerë. Fushën matanë lumit e kishte pushtuar armiku. Ai kishte zënë vend në grykat e përrenjve dhe pas ledheve, pas çdo gjëje ku mund të mbrohej sado pak nga pushkët e ushtrisë fshatare, por mbrojtjen më të fortë ai e kishte te Kodra e Shkretë, tek ai masiv dheu në formën e kurrizit të peshkut.

Elmaz Ismeti kishte të dhëna të sigurta për qëndresën e ushtrisë armike, qoftë buzë lumit, qoftë te Kodra e Shkretë, ku ishte vendosur edhe një mitraloz i rëndë. Ai ishte i bindur se vullnetarët e tij, që e njihnin çdo pëllëmbë të kësaj toke, do të depërtonin me shumë lehtësi në radhët e ushtrisë armike dhe, brenda pak orëve, do ta shpartallonin atë. Po kjo do të ndodhte në fushë të hapur, në përrenj dhe në gëmusha, kurse te Kodra e Shkretë e dinte se do ta kishte shumë të vështirë se, ngado që t'i dilje, armiku të kishte si në pëllëmbë të dorës.

Komandanti i ushtrisë fshatare, së bashku me këshilltarin më të afërt, Ismailin, ia kishin ngulur sytë atë mëngjes Kodrës së Shkretë dhe mendoheshin...

— Nuk mund t'u marrim krahët nga ndonjë anë tjetër? — pyeti Ismaili.

— Jo, asaj duhet t'i shkojmë drejt, — tha Elmazi.

— Do të na vriten shumë...

— Luftë është...

Ismaili e kuptoi që Elmazin e mërziste shumë sulmi mbi Kodrën e Shkretë. Ajo kodër ishte një fortifikatë natyrore dhe duhej marrë si çdo fortifikatë me sulm.

Duke vështruar burrat e armatosur, që vinin radhë-radhë me kollanët plot fishekë dhe me pushkët në sup, komandantit i mbetën sytë te një djalë fare i ri, të cilit sapo i kishte dirsur mustaqja. Ishte truplartë e i drejtë si një plep, me flokë të verdhë e sy të shkruar. Kishte veshur tirq borë të bardhë me gajtanë të zinj, një xhamadan bojë kafe prej shajaku të mirë, që nuk kishte fare dallim nga co-

ha, kurse në kokë, gati mbi syrin e majtë, kishte vënë një qeleshe të bardhë, të re. Mbi brezin e punuar me mjeshtëri shkëlqenin dy radhë kollanësh plot fishekë. Martinën, që shkëlqente edhe ajo nga rrezet e atij dielli mëngjesor, e kishte hedhur tejetetej supeve, duke i vënë krahët e fuqishëm njërin te tyta e tjetrin te qyta. Kishte një hap të lentë dhe vështrim krenar, që të dukej sikur përpinte hapësirat. «Lulja e djemve», tha me vete Elmazi.

— Si quhesh, o djalë? — e pyeti ai pas pak.

— Nuri Petrino.

— Petrino?!

— Po.

— Mos vallë... ç'e ke Osmanin ti, o bir?

— Jam i biri...

— Ka qenë trim i madh Osmani, por tani u plak. Eh, jetë, jetë! — tha Elmazi.

— Do të përpiqem t'i ngjaj, — tha djali dhe, i buzëqeshur, u nis të arrinte shokët, që sapo kishin kapërcyer bregoren.

Pas një ore nisi sulmi dhe Elmazi pa që nuk ishte gabuar aspak në parashikimet e tij: poshtë, në luginën e lumit, armiku u shpartallua shpejt dhe nisi vrapin për t'u mbrojtur te Kodra e Shkretë. Malësorët, të prirë nga Elmazi dhe Ismaili, luftuan me kaq tërbim, sa nuk kishte forcë t'i përmbante. Thirrja «besa-besë» që dilte nga gjoksi i çdo luftëtari, u kthye në një gjëmim tronditës. Me gjithë breshëritë e pandërprera të plumbave, lumi u mbush plot me luftëtarë, të cilët herë me not e herë në va, nxitonin përmes dallgëve në ndjekje të armikut. Që lart, nga kodrat, dukeshin vetëm kësulata e bardha të luftëtarëve dhe shamitë e kuqe të lidhura në tytat e armëve.

Po Kodra e Shkretë, me gjithë sulmin e furi-
shëm, ishte shumë e vështirë për t'u marrë. Një
mitraloz i rëndë, në pikën më të lartë të atij ma-
sivi shkëmbor, vllte vazhdimisht zjarr. «Këtu nuk
ka vend për guxim... duhet menduar diçka... ah,
Kodra e Shkretë...» fliste me vete Elmazi.

— E kisha parashikuar, — tha si me dhembje
dhe dha urdhër të pushohej zjarri.

— Mos e pusho zjarrin, komandant. Hekuri në
të nxehtë rrihet, — i tha atij Ismaili.

— Po na vriten njerëzit kot, o Ismail. Pastaj
këta nuk janë hekur, që të rrihen në farkë, por
janë strall që merr flakë... — i tha si me qortim
Elmazi atij.

— Unë them t'i marrim krahët armikut, ca të
hidhemi nga Murrëtina, ca nga Kullajt. E vëmë
kështu midis dy zjarreve, — shfaqti mendimin një
luftëtar.

— Duhet marrë drejtpërsëdrejti. Nuk kemi aq
forca për ta rrethuar armikun, — tha Ismaili.

Rreth komandantit dhe Ismailit ishin mbled-
dhur shumë fshatarë, që shfaqnin shqetësimin e
tyre për ndërprerjen e zjarrit. Të gjithë jepnin
mendime e secili e ndiente veten edhe komandant,
edhe luftëtar të thjeshtë.

— Përsë u ndalëm kështu? — pyeti dikush me
zë të lartë.

Ky zë Elmazit iu duk i njohur dhe ktheu ko-
kën andej nga i erdhi. Ai që foli, po vinte me
hapa të ngadaltë dhe shumë i qetë e i sigurtë në
vete. Ishte Nuri Petrinoja.

— Na ndali mitralozi, o Nuri, — i tha Elmazi,
duke treguar me dorë Kodrën e Shkretë.

— Mos u mërzi për një punë që mund ta

bëjnë njerëzit, o komandant. Ja, po të na thuash «zëreni diellin», nuk e zëmë dot, po ama mitralozit ia zëmë grykën kur të duash, — tha Nuriu i vendosur.

Të tjerët u habitën.

— Nuk po ia zëmë, Nuri... — tha Elmazi.

— Ia marr shpirtin unë atij mitralozi, veç më jep leje të nisem, — tha i vendosur Nuriu.

— Po nga do të nisesh? Nga njëra anë, andej nga ku mund të mos diktohesh, ngjitja është shumë e vështirë, kurse nga të gjitha anët e tjera dukesh si në pëllëmbë të dorës, — i tha Elmazi atij.

— Më jep leje, komandant, pa shohim e bëjmë. Pas dhjetë minutash aty nuk ke më mitraloz, — shprehu edhe një herë vendosmërinë Nuriu.

Elmazi e vështroi me dashuri dhe e afroi pranë vetes. E përqafoi. Edhe të tjerët, gjithë sa ishin aty e përqaftuan.

— Nisu, bir, — i tha Elmazi me dhembshuri.

Ai hodhi martinën krahëqafë dhe mori vrapin drejt Kodrës së Shkretë, nga ajo faqe që binte thikë në përrua. Nuk kishte ku të kapej, ku të kacavirej dhe njerëzit e quajtën kot mundimin e Nuriut. Ata të gjithë ishin të shqetësuar se, me të bërë dy-tre hapa, ai mund të rrokullisej e të binte në përrua. Po nuk ndodhi kështu. Ata po shikonin një mrekulli. Nuriu ngjitej gati me lehtësi, sikur kishte nën këmbë jo dhë të lëmuar si sapun, por ca shkallë të forta guri... Po i afrohej mitralozit pa u vënë re. Andej nga u vajti Nuriu armiku nuk priste asnjë sulm. Ngjitja mbaroi, por tani filloi një vështirësi më e madhe: tani Nuriu mund të zbulohet. Ai filloi të zvarrisej me shumë mjeshtëri, duke e shkurrtuar gjithnjë e më shumë largësinë nga mitralozi

armik. E dinte se së shpejti do të vinte çasti kur mitralieri do ta diktonte, por po bënte përpjekje që ky çast të vinte sa më vonë. Nuk kishin mbetur as pesë-gjashtë hapa, kur mitralieri armik e vuri re dhe shtiu mbi të me breshëri. Nuriu tashmë u ngrit në këmbë me martinën gati për zjarr. Shokët e tij panë të tmerruar se si ai, pak i kërrusur, me njërën dorë në bark u hodh mbi mitralozin armik. Qe një përleshje e shkurtër që zgjati vetëm disa sekonda. Pastaj gjithçka heshti, heshti edhe mitralozi...

Atëherë thirrja «besa-besë» u kthye përsëri në një gjëmim tronditës, sa të dukej se po tundej toka. Fshatarët rendën përmes breshërit të plumbave, pa e përfillur fare rrezikun. Kur shkuan te mitralieri armik, panë Nuriun, që, krejt i gjakosur, kishte rënë mbi grykën e tij. Gjoksi i ishte bërë shoshë nga plumbat. Në këmbët e tij, me një plagë të thellë në ballë, dergjej mitralieri armik. Në njërën dorë të luftëtarit të ri Nuri Petrino shkëlqente martina e re. «Nusja» e Nuriut, — tha dikush nga fshatarët për armën që shkëlqente. Ata u përkulën, e puthën në ballë dhe pastaj ndoqën këmba-këmbës armikun...

NË PRANVERË, BUZË LUMIT

Pranvera erdhi. Togjet e dëborës, të mbetura që nga dimri në guva dhe gëmusha, u shkrinë. Bari mugulloi. Murrëtyra e natyrës u zhduk, kur filloi të shpërthente dushku. Korija përballë fshatit gjelbëronte dhe të çlodhte sytë. Poshtë kodrinës rridhte lumi dhe matanë tij shtrihej një pyll i dendur verrinjsh e shelgjesh. Më tej, në një kënd të fushës, ishin stallat e kooperativës.

Drandja, baresha e kooperativës, po kulloste dhentë në pyllin e vogël. Ndanë lumit, pas brezit të verrinjve, zgjatej një brez i gjatë shqopesh, ku rritej një lloj tërfili që nxirrte ca lule të bardha.

Dita ishte e bukur. Dielli filloi të digjte dhe Drandja e hoqi trikon e leshtë. Ia kishte ngulur sytë urës prej teli që lidhte dy brigjet e lumit. Ajo ishte e shqetësuar se njëra nga delet, Bejka, nuk hante. Ishte e sëmurë. Çdo ditë andej kalonte veterineri i kooperativës, Demiri. Drandja do ta ndalte dhe do t'i thoshte...

Drandja në fillim pa urën që filloi të lëkundej. Kur u ngrit, vuri re që mbi të po kalonte Demiri.

— Drande, — i foli ai.

— Ku shkon? — e pyeti Drandja.

— Më duhet ca jonxhë e butë për qetë. Po shkoj në sektor të parë, — tha ai.

— Kam një dele të sëmurë.

— Ç'ka? — e pyeti Demiri.

— Nuk ha, rri si e mërdhizur.

— Ka kohë kështu?

— Në mëngjes hante pak. Tani ka më se një orë që nuk ha fare, — tha ajo e merakosur.

Ajo i tha këto fjalë me një dhemshuri që të prekte. Demiri e kuptoi dhembjen e saj.

— Po ta shohim një herë. Mbase nuk ka ndonjë gjë serioze, — tha ai.

Vajzës i shkuan sytë te çanta që Demiri e mban-te pothuaj gjithmonë në dorë.

Dhentë kishin marrë poshtë, në brezin e shqopës. Drandja dhe Demiri takuan në rrugë Veli Laksin që po shkonte nga ura.

— E, more, Demir, si po ju shkojnë dhentë? — pyeti Veliu.

— Mirë, — tha Demiri.

Atij sepse nuk i pëlqente ky Veliu. Si shumë grinte llafe dhe, mbi të gjitha, ishte njeri që i bënte bisht punës. Ai e kishte dëgjuar një ditë që të fliste për Bedriun, kryeagronomin, dhe Verën, brigadieren. Demirit i erdhi shumë inat, ngaqë nuk iu dha t'i përvishej mirë atë ditë... Në pyetjen e Veliut Demiri sot dalloj njëfarë qesëndie dhe e dinte se atij veç për keq i punonte mendja.

— Çobanësja është e mirë. Si të jetë çobanësja, është edhe tufa, — tha me nënkuptim Veliu dhe iku.

— Po, po, — tha Demiri dhe ndjeu që gjaku i hipi në kokë.

— Merr rrugën ti. Nuk të duhet hiç si jam unë, — ia ktheu vajza.

Veliu kaloi urën dhe u nis për në sektorin tjetër. Sa kapërceu kodrën me dushk, pa Ujkan Zefin duke mbledhur jonxhë.

— Puna mbarë! — i tha.

— Mbarë paç, — u përgjigj Ujkani.

— Ty veç e mbara po të prin, o Ujkan. Alamet dhëndri ke zgjedhur. Nuk shahet ai Demiri, po se si më vjen.. që tani bashkë... Si nuk presin xhanëm këta të rinjtë...

Ujkan Zefit i ra sfurku nga duart. U zbeh në fytyrë, sa thoshe se nuk i kishte mbetur pikë gjaku.

— Ç'thua kështu?! — iu drejtua Veliut dhe e vështroi egër.

— Po ja... derisa u futën vetëm në pyll... unë kujtova se e keni ndarë llafin...

— Po më gënjeve, të mos më dalësh më përpara, — iu hakërrua Ujkani.

— Ja, zbrit te lumi, se do t'i shohësh vetë, — tha Veliu.

Ujkani u nis gati me vrap tatëpjetë.

— Dale, dale, nuk bën kështu, — sikur u merakos Veliu.

— Tani shiko punën tënde, — e kërcënoi atë Ujkani.

Në këto çaste Demiri dhe Drandja kishin arritur te tufa e dhenve. Drandja kapi Bejkën. Demiri iu afrua deles që ishte enjtur në fytyrë dhe menjëherë e kuptoi ç'kishte...

— I ka rënë gjaku. Duhet një thikë për t'i prerë pak veshin, — tha Demiri.

— Thikë nuk kam, — tha si e trembur Drandja.

Gjatë atyre pak minutave Ujkan Zefi kishte vrapuar në pyllin me verrinj. Ai pa Demirin dhe vajzën që ishin merakosur dhe delen e sëmurë.

«Qafiri... më gënjeu... Nuk e kam nga ato vajza unë Dranden... Po edhe ky Demiri nuk duket djalë i keq...» tha me vete Ujkani dhe iu lehtësua zemra. U afrua drejt tyre, por pa u vënë re.

— Si t'ia bëjmë? — tha vajza, e shqetësuar.

— Ti rri këtu. Unë po marr një vrap deri te stallat. Atje do të ketë dikush thikë. Ja, po të lë edhe çantën, — i tha ai.

«Këta kanë hallin e deles, kurse unë... Ah, more Veli, e di unë ç'do ti, e di...»

Ai bëri lart, doli nga pylli me verrinj dhe hyri në pyllin me shqope. Që andej doli në rrugën këmbësore, sikur gjoja po kthehej nga puna. Dhe u gjetën të dy në rrugën që të çonte te stallat.

— Përse kështu me vrap? — e pyeti ai djaloshin.

Demiri i tregoi shkurt ç'kishte ndodhur.

— Kam unë thikë. Përse të mundohesh deri atje, — i tha ai dhe të dy kthyen rrugë.

Pas pak u ndodhën pranë deles së sëmurë.

— Ç'ka Bejka, Drande? — e pyeti Ujkani vajzën.

— Demiri thotë që i ka rënë gjaku, — tha ajo.

— Gjaku i ka rënë. Kaq gjë duhet ta dish edhe ti. Në pranverë, kur bien së pari në barin e njomë, ka rrezik gjaku, — tha Ujkani.

Ai pastaj nxori thikën dhe preu një thupër të hollë shelgu.

Demiri kapi delen për ta mbajtur. Ujkani i preu majën e veshit dhe filloi t'ia rrihte atë me thupër. Nga veshi i prerë i deles dolën dy currila gjaku të trashë...

— Tani kaq e pat. Ngrehu, Bejkë, — i tha.

Delja u ngrit, u shkund dhe vrapoi pas tufës.

Ujkani mori xhadenë për të shkuar përsëri te jonxha. Ishte duke u futur në pyllin e vogël të dushkut, kur pa makinën e kryetarit që ecte me shpejtësi, duke lënë pas një re të hollë pluhuri. Makina u ndal mu te këmbët e tij.

— Hip, — i tha ai Ujkanit.

— Ku do të më çosh, o kryetar? Unë jam nisur për punë.

— Për punë do vemi edhe ne, — i tha kryetari me buzën në gaz.

Ujkani zuri vend në ndenjësën pas shoferit. Edhe kryetari e la vendin e parë dhe u ul pranë tij.

— Për te Livadhëzat, — i tha ai shoferit.

Makina u nis dhe Ujkani nuk po i binte më të, përse e donte kryetari.

— Dëgjo, Ujkan, — filloi të fliste kryetari. — Ti je bujk i mirë dhe e do tokën. E kam fjalën për Livadhëzat. E shtruam në kryesi, po karar nuk i dhamë. U nda më dysh mendimi. E lamë për ta parë edhe një herë, për t'ju pyetur edhe ju pleqtë... Kemi menduar për ta prerë pyllin e vërrinjve dhe ta bëjmë tokë buke. Duam një mendim edhe nga ty, o Ujkan...

Tani kishin dalë në një qafë, ku Livadhëza dukej si në pëllëmbë të dorës. Ishte një vend rreth tetë hektarë, buzë lumit, plot vërrinj. Ishte një pyll i bukur sa thoshe se e kishte mbjellë dora e njeriut me kujdesin më të madh. Toka aty ishte ranore. Lu-

mi nuk kishte shtrat të qëndrueshëm dhe herë i kalonte Livadhëzës nga e majta, herë nga e djathta. Në pranverë, kur shkrihej dëborë, lumi e fuste pyllin midis dy degëve të tij. Po kurrë nuk i kishte kaluar përmes...

— Me cilin mendim je ti, o kryetar? — e pyeti Ujkan Zefi.

— Unë them ta bëjmë tokë buke. Hapet gjithë ajo tokë. Ne hapim në male dhe e lëmë këtu... Nuk na shohin sytë nganjëherë...

— Hëm... — ia bëri Ujkani.

— Si mendon?

— Unë them se nuk duhet prishur pylli, o kryetar. Ai që pret qoftë edhe një verri në atë vend, ia ka falur tokën lumit, — i mëshoi zërit Ujkan Zefi.

Kryetari e pa në sy. Atij i pëlqente fort ky burrë i ndershëm dhe punëtor.

Makinën e ndalën mu sipër pyllit, zbritën dhe qëndruan në xhade.

— Hidhi sytë poshtë pyllit, o kryetar, ja atje, te rremat e lumit, — i tha Ujkani kryetarit.

Tjetri vuri dorën si strehë mbi ballë sikur t'i vriste sytë dielli. Atje ku mbaronte pylli me verrinj, lumi ishte ndarë në rrema të vegjël dhe e kishte shtratin të gjerë rreth një kilometër. Rremat bashkoheshin vetëm kur lumi futej midis dy kodrave shkëmbore, si në një tunel.

— Edhe atje ka pasur verrinj, o kryetar. Sa pati verrinj, lumi mbante nga e majta, rrëzë kodrës, sa u prenë ata, shihe si e ka marrë gjithë tokën. Edhe këtu kështu ka për të ndodhur. Ai që pret pyllin, ia ka falur tokën lumit, — tha Ujkani i vendosur.

— Ke të drejtë, — i tha kryetari, si u mendua një copë herë.

Pastaj hipën përsëri në makinë dhe u kthyen për në qendër të kooperativës. Në rrugë u doli para Veli Leksi. Ngaqë nuk pa njeri në vendin e parë, ai kujtoi se shoferi ishte vetëm dhe i nxori dorën përpara. Shoferi ktheu kokën pas për të pyetur kryetarin.

— Merre, — i tha ai.

Ujkan Zefi u mat dy herë t'i thoshte kryetarit se donte të zbriste, kaq inat i erdhi që po hipte në makinë një maskara si ai.

— Ho, ho... — qeshi Veliu, sa u ndal makina. — Do të kapardisem edhe unë një herë si kryetari...

Shoferi qeshi.

— Edhe ti bën për kryetar, — i tha Veliut.

— Pse, nuk e bëj? Për nder, e bëj. Po flet karrigia, o budalla...

Po, kur pa se kryetari ishte prapa, u bë si pulë e lagur dhe mezi e rregulloi llafin...

— Na fal, o kryetar, thashë se mos ishte bosh. Iki edhe në këmbë unë...

— Vendin e ke bosh, hip, — i tha kryetari.

— Sikur të dal prapa. Unë në vendin tënd?! — tha Veliu.

— Hë, se mirë je. Bën për kryetar edhe ti, — i tha kryetari, duke qeshur.

— Hi, hi... — qeshi Veliu dhe, deshi s'deshi, zuri vend pranë shoferit.

Si u rregullua mirë, nxori një paketë cigaresh me filtër dhe ia zgjati kryetarit.

— Merre një me pambuk, o kryetar.

— Nuk pi nga ato, — tha kryetari.

As Ujkan Zefi nuk ia mori cigaren.

Poshtë, në luginë, panë kryeagronomin e kooperativës te parcela e foragjereve.

— Djalë i mirë, — tha për të Ujkani.

Kryetari tundi kokën.

— Edhe kali i mirë e ka një huq, o kryetar, — tha Veliu.

— Ç'huq ka kryeagronomi? — pyeti kryetari, duke e parë me bisht të syrit.

— Nuk ka njeri pa të meta, — tha Veliu.

— Mor, bjeri shkurt, — i tha kryetari.

— Më fal, o kryetar, se nuk i duhen hequr petët lakrorit... Janë ca gjëra që, pa t'i parë syri, nuk duhet të t'i flasë as goja. Po edhe syri, po t'i pa... Secili duhet të shikojë tymin e oxhakut të vet. Po i shkoi drejt tymi i vet, mirë...

— Mos m'u përdridh si ngjalë, — ia preu fjalën kryetari.

— Epo, ç'të të them, o kryetar?!

— Kur i nxore bishtin, nxirri edhe kokën, — tha kryetari.

— Po si të të them... — u përtyp Veliu. — Me Verën, me atë brigadieren e foragjeres, sikur i janë hapur ca fjalë...

Ujkan Zefi deri atëherë e kishte përmbajtur veten, por tani nuk po e mbante më vendi...

— Ti, këlysh bushtre, mos merr nëpër gojë njerëzit. Bedriu është xhevahir djalë...

— Me të dëgjuar e kam, o Ujkan. Pse merr zjarr kot ti? Nuk bëra ndonjë gabim pse ia thashë kryetarit. Figura e kuadrove duhet e pastër... Unë nuk e thashë në pazar, kryetarit ia thashë...

Kryetari nuk po fliste. Ai shikonte qafën e hollë të Veliut, mbushur me ca çibanë të verdhë...

— Mos u merr me llafe, — i tha ashpër.

Pastaj rrugën deri në kryesi e bënë pa folur fare.

— Të pimë nga një kafe, o kryetar, se klubi qenka hapur, — i tha atij Veliu, sapo zbritën nga makina.

Kryetari nuk i foli. Ai bashkë me Ujkanin u ngjitën shkallëve për në zyrat e kryesisë. Veliu mbeti në vend, si i ngrirë.

— Ke parë ti, — iu drejtua ai shoferit, — të mos pijë kryetari një kafe me një kooperativist të thjeshtë?!

— Të mori kryetari, se unë nuk të vija kurrë në makinë. Gojë çorap je, — i tha shoferi atij...

ALMA

Babai kishte më se një vit që kishte dalë partizan. Në shtëpi kishim mbetur unë, nëna, vëllai i madh, Zoi, dhe Alma pesëvjeçare, më e vogla ndër ne. Ajo u rrit me shumë mundime. Nëna u sëmur dhe s'pati me se ta ushqente, dhe Alma, në vend të qumështit të saj, i lagu buzët me qumështin e dhisë së vetme të teto Ninës, një grua shumë e dhembshur, që nuk kursente asgjë për të tjerët. Qysh atëherë Alma mori një ves të keq, mbante gishtin e madh të dorës në gojë dhe e thithte, e thithte...

Ne ishim munduar që t'ia hiqnim këtë ves, por të gjitha përpjekjet na kishin shkuar kot. Shumë herë e qortonim, e merrnim me të mirë, i dhuronim ndonjë gjë, ndonjëherë edhe e kishim rrahur, por prapë hiç... Ajo rrinte nja dy-tri orë pa e futur gishtin në gojë, pastaj prapë po ajo gjë...

— Ka për ta futur gishtin edhe kur të rritet; tha njëherë nëna me hidhërim për Almën.

— Tani do t'ia rregulloj unë. Po deshi, le ta fusë prapë, — tha Zoi.

— Ç'do t'i bësh? — e pyeta unë.

— Keni për të parë, — u mburr ai.

Këtë bisedë e bëmë kur Alma flinte. Zoi mori specë djegës, i griu me thikë dhe i njomi pak me ujë. Ia nxori Almës gishtin nga goja. Ajo u zgjua vetëm për një minutë, pastaj prapë fjeti.

— Është gjynah, — i tha nëna Zoit.

— E moj dhe ti, nënë... Duke thënë kështu, i janë bërë dhëmbët si dhëmbë çakalli. Kur të rritet, ajo do të na mallkojë, — tha i nxehur ai.

— Bën ç'të duash, — i tha nëna Zoit. — Po s'ka për të të dalë gjë...

Mora pak nga ai spec djegës. Sa e vura në buzë, m'u duk sikur vura prush nga ai i dushkut, aq më dogji goja.

— Ka për të fluturuar në tavan, — thashë unë i sigurtë.

Rrinim të tre duke parë Almën. Pas pak ajo e futi gishtin në gojë. Në fillim, kur sapo i takoi gishti në buzë, u drodh, sikur t'i kishte lëshuar dikush ujë të ftohtë, pastaj u zgjua duke qarë. Ne kujtuam se pas kësaj ajo do ta harronte këtë ves, por sa e zuri gjumi përsëri, e harroi specin e filloi të thithe gishtin, si gjithmonë...

Një ditë, kur i kishim humbur krejt shpresat, atë që nuk mundëm ta bënim me shumë prova e mundime. e bëri Zoi veç me ca fjalë...

Ishte dimër, dimër i egër. Gjermanët kishin ardhur në fshat. Isa Troka, kryeballisti me damkë i krahinës sonë, vegël e gjermanëve, s'la gjë të zezë pa bërë.

Një ditë, sapo kishte zbardhur dita, në portën tonë u dëgjuan të trokitura të forta. Nëna dhe Zoi ishin ngritur, kurse unë dhe Alma ishim në gjumë. Nga zhurma u ngrita dhe unë i alarmuar. Të tro-

kiturat bëheshin gjithnjë e më të forta. Ata po shkallmonin derën. Nëna shkoi dhe e hapi. Brenda, si të çmendur, u futën Isa Troka së bashku me tre-katër gjermanë e ballistë.

— Ku e ke tët shoq? — e pyeti me zë të egër Isai nënën.

— Ti e di, në mal është, — i tha nëna pa iu trembur syri fare.

— Në mal, ë? Po këtu nuk ka qenë?

— Jo, — tha nëna.

Një gjerman i gjatë, që mbante ca syze me rreth floriri, diç i foli në gjuhën e tij Isait dhe ky i fundit iu drejtua nënës:

— Do të flasësh, apo të fillojmë nga tonat?

Tani nga gjumi ishte ngritur edhe Alma. Ajo rrinte si e ngrirë, gati për të qarë.

— Nuk kam ç'të them më, — tha nëna.

Atëherë Isai e goditi me qytën e pushkës dhe ajo ra pa ndjenja përtokë. Alma filloi të qante.

Pastaj Isai dhe ballistët rrahën edhe Zoin. E rrahën aq shumë, sa ai u shemb përdhé. Tashmë edhe unë nuk i mbajta dot lotët.

Më pyetën edhe mua në kishte qenë babai në shtëpi apo jo. U thashë se nuk e kisha parë që ditën kur kishte dalë në mal. Njëri nga gjermanët më qëllloi me grusht e me shkelma gjersa më bëri tërë gjak. Pastaj filluan kontrollin në shtëpi. Përmbysën çdo gjë dhe ikën.

Unë dhe Alma filluam të qajmë me zë të lartë se kujtuam se nëna dhe Zoi kishin vdekur. Po Zoi u ngrit i gjakosur dhe na tha të mos qanim. Fshiu fytyrën e gjakosur dhe shkoi pranë nënës. U ngrit edhe nëna.

— Mos i harroni kurrë gjermanët, ballistët e spiunët e tyre, se ata janë të poshtër e të pabesë, — na tha mua dhe Almës Zoi.

Aty nga dreka u qetësuam dhe po rrinim pranë vatrës të gjithë.

— Alma, mos e fut më gishtin në gojë. Ti u rrite tani, — i tha Zoi asaj.

— Nuk kam për ta futur më, — tha ajo si përherë.

— A ma jep besën? — i tha Zoi dhe i zgjati dorën.

— Po, — tha Alma, duke zgjatur edhe ajo dorën.

— Preje, — i tha Zoi asaj.

Alma ngriti dorën e majtë lart, e mbajti një çast ashtu, pastaj e uli me forcë e ndau duart e tyre të tokura.

M'u duk se iu përlotën sytë.

— Po e theve besën, je spiune, gjermane, balliste, je si Isa Troka, se ata janë të pabesë. Besë kanë vetëm partizanët. Hë, kujt do t'i ngjash ti, Alma? — e pyeti Zoi.

— Unë do t'u ngjaj partizanëve. Nuk kam për ta thyer besën. Nuk kam për t'u bërë as si gjermanët, as si Isai e ballistët, — tha me një vendosmëri që të çudiste Alma.

Sytë iu mbushën me lot. Neve na erdhi shumë keq për të, por nuk i ramë në sy.

Gjatë tërë asaj dite e vrejtëm me kujdes.

— A thua do ta mbajë besën? — e pyeta Zoin dhe më erdhi për të qeshur.

— Do ta mbajë. Mos qesh kot, — më qortoi ai. Në darkë Alma u shtri në mutaf. Filloi të kotej. E afroi gishtin te goja. Ne e vumë re të gjithë,

por nuk i thamë gjë. Ajo e largoi pastaj menjëherë, u drodh dhe filloi të qante me kaq ngashërim, sa ta këpuste zemrën. U përpoqëm ta qetësonim, por ajo nuk pushonte. I dridheshin supet e vogla dhe kaçurrelat e verdha i tundeshin nën ritmin e ngashërimeve. Lotët i pikonin sumbulla-sumbulla.

— Nuk jam gjermane, as balliste, nuk jam spiune... Nuk jam... — qante Alma.

— Nuk të thamë që je. Ti harrove, — u përpoq ta qetësonte Zoi.

Veç kur nëna e mori në prehër e filloi t'i tregonte një përrallë, ajo pushoi.

Para se të binim për të fjetur, ajo i tha Zoit:

— Natën të m'i lidhësh duart!

— Përse?! — e pyeti i habitur Zoi.

— Kam frikë se fut gishtin, në gjumë, dhe prish besën... — tha Alma e tronditur.

Zoi e rroku në qafë dhe e mbuloi me të puthura. Edhe unë iu sula dhe fillova t'i puthja sytë, flokët...

— Ti nuk ke për ta prishur besën. Ti je partizane, — i tha Zoi me seriozitet. — Unë nuk do të t'i lidh duart, por do të të jap një palë doreza. Do të flesh disa net me to, derisa të harrosh. Kjo është sa për natën, se për ditën jam i sigurtë që nuk do ta futësh gishtin kurrë.

— Mirë, — tha Alma. — Për natën kam frikë, se harroj...

Atë natë dhe disa net të tjera ajo fjeti me doreza në duar. Ndërsa ditën nuk e futi më gishtin në gojë që nga çasti kur dha besën...

— Ti je partizane, se ke besë, — i tha pas shumë ditësh Zoi Almës.

Asaj iu bë qejfi shumë.

— I kam ngjarë babait, — tha ajo.

— E kanë humbur davanë armiqhtë, — na tha Zoi mua dhe nënës.

Atëherë nuk e rroka mirë kuptimin e atyre fjalëve...

PAS VIJËS SË UJIT...

Atë pasdite gushti bënte shumë vapë. Erë nuk frynte fare dhe ajri dukej i rëndë. Gjethet e plepave të mbjellë në të dyja anët e rrugës që të çonte në qendrën e kooperativës, vetëm për disa çaste tundeshin paksa, pastaj nuk lëviznin për një kohë të gjatë.

Llambi kishte nxjerrë tryezat e klubit jashtë, nën hijen e plepave. Ishte ulur në një karrige dhe sodiste parcelën me misër, që e kishte përpara... Njerëz nuk kishte në klub; gjithë kooperativistët dhe nëpunësit ishin në fushë, në ara...

Pas pak te tryeza e qoshes, pranë trungut të një plepi, erdhi dhe u ul kryetari i kooperativës. Ishte djersitur dhe dukej i lodhur. Në këpucë dhe pantallona kishte pluhurin e arave dhe të rrugëve të fshatit, kurse në çorape rrodhet e hamulloreve. Që nga mëngjesi kishte bredhur në të nëntë sektorët e kooperativës. Hoqi xhaketën e dokut, e vuri në karrige dhe filloi të fshinte djersët.

— U lodhe? — e pyeti Llambi.

— Ku lodhet rinia, o Llambi, — tha kryetari buzëgaz.

Kryetari i kishte mbushur të pesëdhjetat, por e quante veten me shaka rini. Vërtet, po të mos merrje parasysht flokët e thinjur, rrudhat e thella në fytyrë, si ato plasaritjet e tokës në verë, kur mbetet shumë kohë pa ujitur, e tërë qenia e tij shprehte energji të mëdha. Kishte trup të gjatë, të lidhur, gjithë muskuj dhe të drejtë si plep, duar të mëdha dhe eshtake. Sytë bojëkafe pak të vegjël për atë ballë të gjerë, i vështronin gjithnjë me butësi. Vetëm rrallë ata sy shkrepëtinin, dhe kjo ndodhte kur puna nuk shkonte mirë, ose kur zemërohej me dikë...

Ai nxori qesen me duhan dhe filloi të dridhte një cigare. Gishtërinjtë e trashë tërë kallo duke-shin sikur nuk do ta dridhnin kurrë atë cigare, por, bënë si bënë dhe cigarja doli e bukur.

— Do një kafe, kryetar? — e pyeti Llambi.

— Dua bukë. Nuk kam ngrënë as mëngjes, as drekë.

Llambi u zu ngushtë.

— Nuk ka mbetur asgjë..., u mbaruan të gjitha...

— Bukë ka?

— Ka.

— Po djathë?

— Edhe djathë...

— Po hë, të shkretën, se nuk dua bakllava...

Llambi hyri në kuzhinë dhe doli që andej me një racion bukë, vezë të ziera, një qepë e pak djathë... Kryetari filloi të hante me oreks të madh, pa ia ndarë sytë fushës me misër që jeshilonte. Parcela ishte e madhe dhe misri ishte shumë i shëndetshëm. Por vende-vende kishin filluar t'i fishkeshin gjethet, ngaqë nuk ishte ujitur në kohë. Kryetarit i pikonte në zemër. «Të kesh ujë boll

dhe të mos ujitësh misrin në kohë...» tha me vete dhe i erdhi të shfrynte, po s'dinte se kundër kujt.

— Më duket se do ujë misri, — sikur ia lexoi mendimet Llambi.

— Do, do...

— Po ujë ka boll, apo jo?

— Ujë ka, o Llambi, po ai nuk hyn vetë në arë. Pastaj, sado të ketë ujë, ai duhet përdorur me nikoqirllëk, se ja, po piqet toka nga të nxehtit...

Nga kryesia e kooperativës u pa të kalonte traktorist Nebiu.

Kryetari ia qepi sytë dhe Llambi e kuptoi se duhej ta kishte shkëlur diku ai Nebiu, që kryetari e vështronte në atë mënyrë.

— Ma thirr atë Nebiun, ma thirr, — i tha Llambit.

Llambi vrapoi pa e hequr bluzën e bardhë. Traktoristi erdhi dhe qëndroi para tij si fajtor... Sytë e vegjël të kryetarit nuk e kishin më atë butësinë dhe ëmbëlsinë e zakonshme, por as atë shkrepëtimën e egër nuk e kishin...

— Ti e ke pluguar atë hamulloren në sektorin e dytë?

— Unë.

— Po ç'e kishe lënë gjithë atë tokë pa pluguar anash... Ne hapim tokë të re në male dhe ti na e lë në fushë...

— Nuk e kapin plugjet, kryetar. Po mos ki merak, se do ta provoj edhe një herë.

— Jo ta provosh, por ta punosh, o Nebi. Nuk mund të futim qetë për dy hapa vend, pastaj, ku punohet me qe në këtë thatësi.

— Drejt... Po nisem që tani, — tha Nebiu.

— Nisu!

Vështrimi i kryetarit u bë përsëri i ëmbël. Mbaroi së ngrëni dhe ndezi cigaren. Nga parcela me misër doli një kooperativist e u drejtua nga klubi. Ishte Subi Seferi, një burrë rreth dyzet vjeç me sy vëngarashë dhe dinakë. Kishte përveshur pantallonat gjer mbi gju dhe në këmbë kishte baltën e arave. Ai qëndroi në këmbë para kryetarit.

— Ç'thotë puna? — e pyeti.

Subiu u përtyp.

— Puna mirë, por nuk po na lënë të punojmë.

— Kush nuk të lë të punosh?! — u habit kryetari.

— Brigadieri... Më nxori nga puna.

— Përse?

— Ku ta di unë.

— Pa ulu një herë, ulu...

Subiu u ul në tryezën ku rrinte kryetari dhe Llambi.

— Kjo qenka interesante. Ai të paska nxjerrë nga puna dhe nuk ta paska thënë përse... — foli kryetari, i mërzitur, duke u përpjekur të ndeshte vështrimin vëngarash të Subiut.

— Sikur gjoja paskam shpërdoruar ujin...

— Gjë e vogël të duket ty kjo?!

— E vogël jo, po ta kisha bërë. Po kështu e ka kapur me mua ai. Do që t'i shkojë e tij kurdoherë... Po t'u vu, s'të ndahet.

Ai pushoi dhe i hodhi sytë kryetarit, për të hetuar se ç'përshtypje i kishin bërë fjalët e tij... Fytyra e kryetarit që vrenjtur, prandaj preferoi të heshte.

— Ti thua që të ka rënë në qafë brigadieri, ë?

— Po, — tha Subiu me një ton të pasigurtë.

— Po Sefa sikur nuk i bie njeriu më qafë...

- Kështu është, po mua...
- Ç'ka me ty Sefa?
- Është ajo puna e mbesës, kryetar.
- Ç'hyn këtu mbesa?

Tani ai nuk ishte i qetë dhe Subiu e vuri re, por ajo që u fillua, duhej çuar gjer në fund. Në sytë e kryetarit sikur ishin mbledhur retë dhe së shpejti mund të shpërthente shtrëngata.

— Vjet më kërkoi mbesën për djalin, kryetar, dhe unë nuk ia dhashë. Më mirë të themi se nuk ia dha i ati i vajzës, po nejtë, Sefa e filloi mërinë me mua. Dhe ja tani ku përpiqet ta nxjerrë. Interesi personal në plan të parë, kryetar...

Shikimi i kryetarit sikur u zbut. Fytyra i mori atë shprehjen e mirësisë, që ishte e zakonshme për të. «Vërtet ta ketë bërë Sefa këtë?», mendoi ai. Subiu sikur mori zemër nga kjo mëdyshje e tij.

— Llambi, na bjer dy kafe dhe dy konjakë. Tre me tre bëji, merre dhe ti një, — iu drejtua ai Llambit.

Po Llambi nuk lëvizi nga vendi. Ai vështroi kryetarin.

— Ti pi, unë nuk dua, — i tha kryetari atij dhe u thartua në fytyrë. Subiu e kuptoi se shkeli në dërrasë të kalbur.

— Meqë erdhi rasti, kryetar...

— Rast i bukur. Më ke lënë ujin të shkojë dëm dhe më fton të pi konjak, — i tha ai gjithë zemërim.

Subiu u turbullua dhe shtangu në vend, pa ditur ç'të bënte.

— Hajde të shkojmë në parcelë, të shohim ç'ke bërë... — i tha pastaj, atij dhe, si pagoi. u ngrit dhe u nis.

Subiut nuk ia kishte marrë mendja që ai do të futej në baltën e arave për kaq gjë. Kishte menduar se ai do t'i thoshte pak a shumë kështu: «Nisu për në punë, se e bisedoj unë me brigadierin...». «Ta kisha ditur se më ndodhte kështu nuk kisha ardhur fare. Erdha për brirë dhe po lë edhe veshët...» mendoj Subiu me vete.

— S'është nevoja të vish, kryetar, — përdori dhe kartën e fundit ai.

— Do të vij, do të vij.

— Po ujë është, edhe të ikën nganjëherë...

— Kush e mban ujin tani? Apo vete kot?

— Brigadieri. Po ujit ai...

Kryetari nuk foli më. Ecte me hapa të mëdhenj pas vijës kryesore. Misri ishte i lartë një bojë njeriu dhe kishte lidhur dy kallinj, nganjëherë edhe tre. Vështrimi i kryetarit sikur po përkëdhelte misrin e shëndetshëm...

Arritën atje ku po ujitte brigadieri. Ndihej zhurma e shatit dhe pllaquritja e këmbëve të tij nëpër ujë.

Kryetari hoqi xhakëtën dhe e la në trapin e ngritur, pastaj, në një vend ku nuk kishte mbërritur uji, filloi të zbathte këpucët e çorapet dhe përveshi pantallonat. Hyri në vijën e ujit dhe shikonte majtas e djathtas arën. Vende — vende uji, ngaqë kishte qenë shumë, e kishte gërryer dheun dhe e kishte zbuluar misrave rrënjët, vende-vende nuk ishte ngjitur fare dhe gjethet e misrave kishin filluar të vyshkeshin.

— Kësaj i thua ujitje ti? — iu drejtua kryetari Subiut.

— Nuk është e rrafshët parcela. Në disa vende nuk vete uji...

— Nuk e ka fajin parcela, po ti... Turp të kesh!

Brigadieri gërryente lehtë-lehtë me shat dhe i hapte rrugë ujit që të ngjitej edhe në ato vende, ku dhe ishte pak më i ngritur.

— Puna mbarë, — e përshëndeti kryetari.

— Mbarë paç, kryetar, — ia ktheu tjetri.

— Ja, si e ka çuar brigadieri ujin ku ka dashur, rrënjë për rrënjë, — tha kryetari duke vështruar atë copë vend ku kishte ujitur për merak brigadieri.

Subiu nuk foli.

— Ky e ka lëshuar ujin në krye të parcelës dhe ka kujtuar se ujitet vetë, — tha brigadieri.

— Di ky, di si ujitet, por nuk i do qejfi, — tha kryetari.

— Mos e thuaj atë fjalë, kryetar, — sikur u prek Subiu.

— Po ç'të të them. Të të them «të lumtë!» Këtë të them?

— Ishte ujë shumë dhe nuk e mbaja dot, — u përpoq të justifikoj Subiu.

— Po brigadieri përse e mban?

Subiu nuk diti ç'të thoshte.

— Parcelën tjetër e ka ujitur më keq, — tha brigadieri.

Midis dy parcelave kalonte rruga. Kryetari u zemërua shumë, kur pa se rruga ishte mbytur në ujë.

— Ka shpërdoruar edhe ujin, ka mbytur edhe rrugën. Këndej nuk kalohet as për dy-tri ditë, — tha ai.

Subiu rrinte i heshtur, duke vështruar herë brigadierin dhe herë kryetarin.

— Ik, ik... Në mbrëmje do të mbledhim brigadën... — iu çor kryetari atij.

Subiu u ktheu shpinën dhe filloi të dilte nga parcela. Ai tashmë e dinte se kryetarit nuk mund t'i rrinte përpara...

Kryetari mori shatin dhe, së bashku me brigadierin, i hapën rrugë ujit që të kullonte nga rruga e të binte në vijën kryesore. Krahët e tij të fuqishëm, të mësuar me punë, rrëmonin dheun dhe bënin sfrate për t'i prerë rrugën ujit.

Po vinte mbrëmja. Zagushia e ditës kishte ikur së bashku me diellin. Një erë e lehtë filloi të frynte nga bregu i lumit dhe ua thau djersët.

Drejt tyre po vinte skuadra e të rinjve që do të ujitte natën.

Subiu në këtë kohë shkoi në klub dhe porositi një konjak.

— Ta bëri mirë kryetari.. Deshe ta gënjeje, — i tha Llambi atij, kur i çoi konjakun.

— Dihej se anën e brigadierit do të mbante ai...

— Ai mban të drejtën, për kryetarin nuk flet njeri keq...

— Nuk flet, or jo, edhe unë kështu si ti them, por me Sefën nuk vë njeri, se...

— ... Se edhe Sefa punon shumë mirë dhe është njeri i ndershëm, — ia preu fjalën Llambi.

Subiu uli kokën i menduar...

ALLAMAN HODOJA

Sefedin pasha rrinte në dhomën e shtruar me shilte, duke numëruar tespiket. Mërzia, si një krimb, po e brende nga brenda. Rrahu tri herë shuplakat. Në dhomë hyri Muharedini. Ai bëri një përkulje të thellë dhe mbeti në pritje.

— Dru në oxhak dhe prush në mangall, — tha pashai.

Muharedini u përpoq të fshihte habinë; oxhaku ishte mbushur me dru dhe zjarri bubullonte.

Sefedin pasha e treti shikimin matanë dritares. Fjollat e borës binin shtruar-shtruar. Kishte shumë ditë që vazhdonte të binte borë. Ishte dimri i parë që po kalonte këtyre maleve. Për pashanë këtu gjithçka ishte e mallëkuar: malet, fushat, rrugët dhe, mbi të gjitha, njerëzit. «Jo njerëz, por xhindë janë! Të mallëkuarit! Eh, Allaman Hodo...» pëshpëriste shpesh pashai dhe duart i dridheshin mbi tespiket.

Gjashtë muaj më parë e kishte thirrur sulltani dhe i kishte dhënë urdhër t'i çonte në Stamboll kokën e Allaman Hodos, që ishte bërë tmerri i turqve. Pashai kishte zgjedhur pesëqind djem dhe qe nisur.

Qysh nga ajo ditë kishin kaluar plot gjashtë muaj. Dhe muaji i gjashtë ishte i fundit. Kaq ishte afati. Dhe Allaman Hodoja ishte ende i gjallë...

Pashai nuk kishte ndenjor kot këta muaj, por kishte vepruar si një ushtar i mirë, që do ta kryejë në kohë detyrën. Shpejt kishte rënë në gjurmët e Allamanit. I kishte ngritur shumë kurthe, i kishte bërë shumë rrethime, por ai tok me trimat e tij kishte shpëtuar.

Muharedini hyri ngadalë në dhomë. Hodhi një krah dru të trasha dushku në oxhak dhe një kovë me prush në mangall.

— Sill sherbet, — urdhëroi përsëri pashai.

Muharedini pas pak solli një ibrik Stambolli plot me sherbet dhe e vuri mbi mangall. Bëri gati filxhanët.

Pashai filloi të pinte ngadalë pa ia ndarë sytë borës që po binte. Kishte caktuar shumë çmime për kokën e Allamanit. Dhe ky çmim vinte gjithnjë duke u rritur. Po askush nga arnautët nuk po vinte ta merrte floririn. Muajin e katërt pashai kishte premtuar se, ai që do t'i sillte kokën e Allamanit, do të merrte flori sa të donte. Prapë askush nuk kishte ardhur. Muajin e pestë kishte caktuar një shumë të madhe vetëm për gjurmët e Allamanit, sepse kishte kohë që nuk dihej ku fshihej ai. Priste e priste Sefedin pashai, por askush nuk po dukej.

Dera u hap ngadalë dhe hyri prapë Muharedini.

— Rojat kanë kapur një njeri, — tha ai.

— Silleni, — urdhëroi pashai.

Në dhomë u fut një burrë rreth të pesëdhjetave, gjoksshkopsitur, mustaqethinjur dhe me një sy.

— Ç'do? — e pyeti pashai të sapoardhurin.

— Unë e di ku ndodhet Allamani, — tha qorri, duke u dridhur. Pashai nuk tregoi asnjë interesim të veçantë. Ai e hiqte veten sikur Allamanin e kishte në dorë. Ai e bënte këtë për ta ulur çmimin për gjurmët e tij. Njeriu që kishte përpara, i dukej i padenjë për aq para sa kishte premtuar.

— Dikush duhet ta merrte floririn. Ti u tregove më i zgjuar, — i tha pashai atij.

— Këta nuk pyesin për flori, pasha.

— Përse thua «këta?» Nuk je arnaut ti?

— Jo. Unë kam mbetur kënde, është histori më vete, pasha.

— Mirë, mirë. Nuk na duhen historitë tani. Fol, ku ndodhet Allamani.

— Në malin e Pizgës. E mora vesh rastësisht nga një çoban.

— Sa njerëz ka me vete?

— Vetë i pesëmbëdhjeti. Si gjithmonë...

— Po gënjeve, do të të pres gjuhën dhe do të të nxjerr edhe syrin tjetër. Po doli fjala jote, do të marrësh paratë.

— Nuk gënjej, pashai im.

— Mirë, mirë... diçka do të marrësh që tani...

Ai e pa qorrin me një neveri të dukshme. Vendosi që këtij njeriu jo gjysmën, por as çerekun e shumës së premtuar të mos i jepte.

— Sill dy qese me flori, — i tha ai Muharedinit.

Muharedini u kthye shpejt me qeset në duar. Sefedin pashai mori njërën prej tyre në dorë dhe

e tundi. Florinjhtë tringëllinë dhe në syrin e vetëm të qorrit shkëndijoi lakmia.

Dy qeset u zbrazën në shilte. Monedhat shkëlqenin. Qorri filloi të dridhej.... Edhe pse nuk kish-te aspak kohë, pashai vendosi ta zgjaste pak lodrën...

— Merri, — i tha pashai qorrit, duke i treguar floringhtë.

Qorri hapi thonjtë kërcënueshëm dhe i rrëmbeu. Pastaj pashai urdhëroi të vinin dy ushtarë. Ata hynë brenda dhe prisnin urdhër.

— Lidheni, — u tha ai atyre.

— Po kjo, pasha?! — tha qorri i habitur dhe i frikësuar.

— Sa të kapim Allamanin, pastaj do të të lirojmë. Flori do të të jap sa të duash, — i tha pashai me një buzëqeshje tinzare atij që po dridhej me qeset me flori në duar.

*

* *

Allamani së bashku me trimat e tij, kishin ndezur zjarr në një shpellë të vogël, në malin e Pizgës. Të gjithë kishin rrethuar zjarrin dhe po ngroheshin, me përjashtim të atyre që po bënin rojë.

— Erdhi koha për të ndërruar rojat. Kush e ka radhën deri në mesnatë? — pyeti Allamani.

Mevlani, Shabani dhe Sofoja u ngritën në këmbë.

— Ne e kemi, kapedan, — tha Sofoja.

— Mirë, Sofo, zini vendet dhe hapni sytë, i porositi Allamani.

Ata që do të bënin rojë dolën përjashta dhe shpella ra prapë në qetësi. Allamani rrinte i menduar. Edhe të tjerët po ashtu: si të kalonin matanë malit të Grabovës, pa u rënë në sy forcave të Sefedin pashait?

— Sikur të iknim që këtej, kapedan, — tha Haxhiu pas pak.

— Kështu mendoj edhe unë, — tha edhe Isufi.

— Këtu jemi si peshku në të thatë, — tha prapë Haxhiu.

— Po hë, pra, të ikim, ç'presim? — pyeti Isufi.

— Presim të bjerë nata. Sefedin pasha ne na ruan dhe jo lopët e fshatit, — tha disi i mërzhitur Allamani.

— Më mirë luftojmë me një pritë, kapedan, sesa me pesëqind vetë, — tha Kristoja, më i moshuari i tyre.

Të tjerët tundën kokat në shenjë miratimi. Po kapedan Allamani kësaj radhe nuk ishte në një mendje me ta.

— Më mirë luftohet me një ushtri, sesa kundër dhjetë vetëve në pusi, — tha Allamani dhe e vështroi Kriston në sy.

Shokët prapë tundën kokat në shenjë miratimi. Edhe fjalët e kapedanit iu dukën me vend.

— A mund të na sulmojnë këtu ku jemi? — pyeti Haxhiu.

Kjo pyetje iu drejtua të gjithëve, por shokët prisnin ç'do të thoshte Allamani.

— Ç'pyetje bën edhe ti, Haxhi! — tha i pakënaqur Allamani.

Haxhiu mbeti i çuditur nga pakënaqësia e kapedanit.

— Edhe sikur të bëheshim zogj e të fluturonim ai do të na vinte pas. Po nuk çoi në Stamboll kokat tona, i shkon e vetja, — i shpjegoi kapedani.

— Po sikur të na sulmojë? — pyeti Bedoja duke e quajtur plotësisht të mundshme një gjë të tillë.

— Akoma nuk na ka sulmuar, — deshi ta mbyllte këtë bisedë Allamani.

— Po sikur... — nguli këmbë Bedoja.

Allamani i hodhi një vështrim disi të rreptë. Bedoja e ndjeu peshën e këtij vështrimi; kapedani rrallëherë shikonte në atë mënyrë. «Në fund të fundit, Bedoja ka të drejtë. Të gjithë kanë të drejtë, tjetër punë se unë nuk po i jap dot udhë», mendoi me trishtim Allamani.

— Do ta çajmë rrethimin, Bedo, — tha si i çelur në fytyrë kësaj radhe.

— Pizgu vetëm nga Svellushi shkelet. Po na sulmuan, ata do të vijnë që andej, — tha Haxhiu.

— Kalohet edhe nga Gurët e Mushkave, — tha Allamani.

— Mund të na sulmojnë njëherësh nga të dyja shtigjet. Forca kanë, — tha Faslliu, që gjer atëherë nuk e kishte hapur gojën.

— Do t'i tërheqim nga njëra anë, — foli Allamani.

— Si do t'i tërheqim? — pyeti Haxhiu. Ai po tregohej shumë këmbëngulës, si rrallëherë.

Allamani nuk iu përgjigj. Pyetja e tij u tret si ato fjollat e borës, që sa hynin në shpellë, shkri- nin nga ngrohtësia e zjarrit.

— Shohim e bëjmë, — tha Allamani pas pak, sikur donte t'u jepte përgjigje të gjitha pyetjeve që iu bënë dhe atyre që mund t'i bëheshin.

Në kushtë të zakonshme, Allaman Hodoja nuk jepte ndonjë mendim për rrezikun që mund t'i vinte. Ai duhej ta shihte rrezikun në sy, pa të vepronte. Në çastet më të vështira, pa u menduar aspak, ai vendoste për fatin e tij dhe të shokëve. Ata njëmbëdhjetë burra që rrinin tani pranë tij, e kishin provuar këtë gjë shumë herë. Ata e kishin parë Allamanin si fluturonte mbi rrezikun dhe, në vrap e sipër, ndërronte planin e betejës dhe sulmonte andej nga nuk kishte menduar kurrë për të sulmuar. Kishte rreth pesëmbëdhjetë vjet që jetonte maleve, pesëmbëdhjetë vjet që sulmonte, tërhiqej, ngrinte pusi, binte në prita, dilte prej tyre... Pesëmbëdhjetë vjet gjithmonë pranë rrezikut. Ai ishte mësuar kaq shumë me rrezikun, sa që jashtë tij e ndiente veten disi të lodhur e të shushatur. Mendja e tij punonte shumë mirë në alarme. Të gjitha këto shokët i dinin fort mirë, por gjithashtu e dinin se kurrë në jetën e tyre nuk ishin ndodhur në një vend kaq të papërshtatshëm, pa mundësi shpëtimi. Këtu nuk do të hynte në punë as mendjemprehtësia e komandantit të tyre, mendonin ata.

— Ta dredhim, o Kristo, — i tha Allamani shokut të tij dhe i zgjati kutinë e fakfanit plot me duhan të grirë, që lëshonte një erë të mirë. Si bëri Kristoja cigaren, Allamani ua dha kutinë edhe të tjerëve. Në këto çaste në hyrje të shpellës u duk Sofoja, i mbuluar i tëri me borë.

— Turqit, kapedan! Na sulmuan turqit.

Të tjerët lëvizën nga vendet dhe lëshuan ci-

garet përdhe. Kapedan Allamani i përfshiu të gjithë me një shikim disi qortues.

— Më javash se na trembe, o Sofo. Sikur po sulmohemi për herë të parë, — tha me një buzëqeshje të lehtë në fytyrë. Për çudinë e të gjithëve, kapedani sikur të mos kishte ndodhur asgjë, nxori urorin dhe eshkën. E goditi strallin disa herë dhe në shpellë u ndie era e mirë e eshkës.

— Sofoja tha se po vijnë turqit, kapedan, dhe nuk erdhi për të na thënë se po bie borë, — tha Haxhiu, duke e shfaqur haptazi pakënaqësinë e tij.

— Nuk po flet keq Haxhiu, — tha edhe Kristoja.

Allamani buzëqeshi dhe tundi kokën. Për herë të parë shokët mbase menduan se mendja e kapedanit nuk punonte siç duhej. Sofoja kishte mbetur si i ngrirë, pa ditur ç'të thoshte.

— Nga po sulmojnë, Sofo? — e pyeti kapedani.

— Nga Svellushi dhe nga Gurët e Mushkave.

— Sa duhet të jenë?

— Rreth pesëqind.

— Thashë, do të na sulmojnë nga të dyja anët, — tha Faslliu.

Për disa çaste askush nuk foli. Heshtja u bë e thellë dhe tronditëse. Sytë e të gjithëve ishin gozduar te Allamani. Mendja e tij, siç dukej, po vihej në lëvizje. Po Allamani nuk foli. Ai brofi në këmbë dhe doli përjashta. Pas tij dolën dhe të tjerët.

— Gunat, — u tha ai shokëve, — Hiqni gunat.

Gunën e vet e kishte hequr i pari. Të tjerët po tregoheshin pak të ngathët. Allamani e dinte se shokët i kishte të shpejtë si vetëtima, por ajo ngathësi kishte lidhje me urdhrin e çuditshëm. Armiku po vinte, kurse ata po zhvisheshin...

— Mbushini gunat me gjeth dushku, lidhini

me kujdes me rripa, që të duken tamam si njerëz. Shpejt, shpejt. Tani nuk ka më kohë për t'u menduar, — urdhëroi shokët kapedani. Ai po rrëmbente me shpejtësi të habitshme gjethet dhe po i mbështillte me gunën e leshtë. Kështu po vepronin edhe të tjerët, ndonëse nuk e dinin ç'do të bënin më tej. Tashmë turqit ishin afruar shumë. Nuk mbeteshin as pesëqind metra dhe ata do t'u vinin drejt e në shpellë. Në fillim ata nxitonin, kurse tani ecnin ngadalë, me kujdes. Ata e dinin se duhej ruajtur nga kurthet e Allamanit.

— Vrap, pas meje, — thirri Allamani dhe rrëmbeu gunën e vet të mbushur. Edhe shokët morën gunat dhe shkuan me vrap pas tij. Ai u ndal në buzë të Bregut të Keq, nga ku, po të hidheshe, bëheshe copë-copë.

— Ç'po na kurdis, kapedan? — pyeti Haxhiu.

— Do të shpëtojmë, o Haxhi. Ja, këtë po kurdis.

— Këndeje nuk shpëtohet gjallë. Më mirë i presim me pushkë.

— Dredhia nganjëherë vret më shumë se pushka, Haxhi.

— Vret, vret, po këtë radhë...

— Do t'i hedhim gunat e mbushura këndeje... Turqit, që po ngjiten nga Gurët e Mushkave, do t'i shikojnë dhe do të kujtojnë se u hodhëm ne. Ata me vrap kësaj ane për të pritur gunat, ne me vrap në shtegun që do të mbetet i hapur. Ja, kështu ka për të ndodhur. Jua thotë Allamani ju...

— Ah, kapedan, kapedan, ç'të pjell mendja, — tha Kristoja, si të ishte fajtor.

Allamani hodhi i pari gunën e vet. Pas tij edhe të tjerët bënë po ashtu. Ata shikonin me zemër të ngrirë rrëshqitjen e gunave dhe përgjonin lëvizjet

e turqve te Gurët e Mushkave. Në radhët e armiqve filloi rrëmuja dhe pështjellimi. Vrapuan si të çmendur andej nga u lëshuan gunat, duke lënë të hapur shtegun te Gurët e Mushkave.

— E hëngrën, — tha i gëzuar si fëmijë Allamani.

— Mos vdeksh kurrë, kapedan, — tha Kristoja.

— Të nxitojmë, kapedan, — tha Haxhiu.

— U pa puna, tani, o Haxhi. Ja, edhe ata që sulmuan nga Svellushi, u lajmëruan që të ndërrojnë drejtim... Ata janë të bindur se ne jemi hedhur. Edhe të vdekur, ne jemi të nevojshëm për ta, — shpjegoi Allamani.

— Tani nxitoni pas kapedanit, — u tha të gjithëve Sofoja.

Pas dhjetë minutash ata ishin jashtë rrezikut. U dëgjua lebetitja e turqve kur panë në vend të njerëzve gunat e tyre.

— Mbetëm pa guna në këtë të ftohtë, — tha Kristoja me të qeshur.

Edhe të tjerët qeshën.

DRIDHJET E MËNGËS SË XHAKETËS

Kur isha në klasën e katërt, aty nga mesi i vitit shkollor, na erdhi një mësues rreth të dyzeta-ve.

— E, fillojmë? — na pyeti ai, sa hyri në klasë për orën e parë të mësimit.

— Fillojmë, — i thamë ne.

Kishim histori. Ai na bëri ca pyetje për ato që kishim mësuar më parë. Dëgjonte përgjigjet me një buzagaz të lehtë. Nga mënyra se si dëgjonte, ishte e vështirë ta kuptoje nëse i pëlqente përgjigjja apo jo. Asnjërit nuk i bëri vërejtje. Pyeti edhe të birin e Azem Bregasit, kriminelit famëkeq, që kishte lyer duart me gjakun e popullit dhe strukej maleve me bandën e vet.

Ishin vitet e para të pasçlirimit. Herë pas here dëgjonim të zhdukeshin bandat nga forcat e ndjekjes së popullit. Veç për Azem Bregasin dhe bandën e tij akoma nuk kishim dëgjuar gjë. Tefik Bregasi na dukej sikur mburrej. «E, nuk e kapin dot babanë tim, atë nuk e zë plumbi», sikur thoshte shikimi i tij.

Edhe kur u përgjigj Tefiku, mësuesi tundte

pakëz kokën. Buzëqeshja e lehtë nuk iu largua nga rytyra. «Dreq o punë,— thashë me vete. — Edhe këtij i buzëqeshi...»

Pastaj ai filloi të na shpjegonte mësimin e ri. Fliste ngadalë. Kishte një zë të trashë e të ngrohtë. Shpjegonte bukur, sa ta kishte ënda ta dëgjoje, por unë nuk e pata mendjen te mësimi... Mbase nuk e kishin edhe shumë të tjerë. Mësuesi ynë ishte me një dorë. Mënga e majtë e xhakëtës tundej shumë lehtë. Nga ato tundje disi të ngathëta të dukej sikur në të ishte një krah i dobët, i pafuqishëm, i tharë, që nuk e ka forcën e krahut tjetër. Por, kur e shikoje mëngën në fund, bindeshe se mësuesi ynë ishte pa njërin krah.

Ai kishte ardhur në fshat një ditë më parë. Unë qeshë njeriu i parë që foli me të, por në mësim ai nuk më njohu dhe kjo gjë sikur më lëndoi ca. Atë ditë s'e pata kuptuar që ai ishte me një krah. Binte shi. Përroi i Belishit ishte egërsuar si rrallëherë. Ujërat e tij të turbullta rrokullisnin tatëpjetë gurë, kërcunj, çdo gjë që gjenin përpara... Mësuesi po kalonte përroin. Njëherë vala e rrëmbeu tatëpjetë dhe unë, i tmerruar, kujtova se ndonjë gur i madh a kërcu do ta shembte atë dhe vala e tërbuar do ta merrte me vete. Po ai u mbajt fort. Kur doli në breg, ishte lagur i tëri dhe ndihej shumë i lodhur.

— Ku është shtëpia e Qazimit? — më pyeti mua që po kullosja lopën.

— E kryetarit të këshillit? — i thashë.

— Po.

— Ja, ajo tek ai plepi i gjatë, — dhe ia bëra me dorë.

Ai u nis me hap të ngadaltë e të rëndë.

Tani shikoja mëngën bosh të xhaketës dhe më vinte çudi që nuk e kisha vënë re më parë. Flokët sa kishin filluar t'i thinjeshin te tëmthtat. Ballin ia përshkonin ca rrudha të thella, që i zbritnin gjer poshtë te cepat e syve. Mollëzat e faqeve, pak të dala, sikur harmonizoheshin me hundën pak të madhe...

Si shpjegoi mësimin e ri, na tha të hapnim librat. Kur Abini lexoi librin, mësuesi nxori nga xhepi orën dhe e pa. Pastaj i hodhi sytë përjash-ta. Binte shi, si të djeshmen...

Pas dy-tri ditësh mësuam shumë gjëra për të. Kishte qenë partizan. Krahun e kishte lënë në përpykje me gjermanët, larg atdheut, në tokat e Jugosllavisë... Kjo na bënte që ta nderonim e ta respektonim më shumë. Tani ajo mëngë boshe e xhaketës nuk më dukej disi e kobshme dhe e shurdhër si tri ditë më parë. Pa tundjen e lehtë të saj, ne zor se do ta donim dhe do ta respektonim aq shumë...

Një ditë, para mbarimit të orës së dytë të mësimin, na tha:

— Sot do t'ju jap një lajm, që do t'ju gëzojë shumë: edhe banda e Alush Vilinjakut na e mori të keqen. Kështu do ta pësojnë të gjitha bandat dhe banditët nga populli. Kështu do ta pësojë një ditë edhe banda e kriminelit Azem Bregasi, që ka shtypur e ka shfrytëzuar nënat dhe baballarët tuaj e që tani, i trembur nga forca e popullit, fshihet maleve. Por dijeni, se kokën në torbë e ka edhe ai...

Rrudhat në fytyrë sikur iu thelluan dhe i zbritën tatëpjetë faqeve deri në mjekër. Mënga boshe e xhaketës i tundej me një ritëm tjetër: më dukej sikur bënte ca lëvizje vertikale, sikur të ishte një

tokmak i rëndë, që donte të shtypte diçka. Kur do-
lëm në pushim, u dëgjuan të qara në klasë.

— Kush qan? — pyeti mësuesi.

Ne kthyem kokat dhe pamë që qante Tefik Bregasi. Formuam një si gjysmërreth në korridor. Mësuesin e kishim në ballë. Tefiku qante i mbështetur pas derës së jashtme.

— Përse qan? — e pyeti mësuesi.

Tefiku, pa lëvizur nga vendi, me kokën midis pëllëmbëve, u kthye nga mësuesi, e pa atë në sy, por nuk foli. Lotët i rridhnin tatëpjetë faqeve dhe i bashkoheshin në mjekër. Askush nuk pipëtinte.

Unë ndieja një farë ankthi që po më shtypte. Besoj se pak a shumë një gjë të tillë kanë ndier edhe të tjerët. Kisha frikë se mos mësuesi zbutej nga lotët e Tefikut dhe e merrte me të mirë...

— Përse qan? — e pyeti ai përsëri.

Tefiku as kësaj radhe nuk u përgjigj. Mësuesi na hodhi sytë ne. Vështrimi i tij ishte pyetës. Tani mënga e xhaketës i qëndronte drejt poshtë, pa lëvizur fare, sikur të ishte prej hekuri e jo prej stofi.

— Është i biri i Azem Bregasit, — i thashë unë.

Mësuesi më shikoi në sy. Unë isha i vrenjtur. Edhe të tjerët qenë zymtuar në fytyrë. Ai qëndroi disa çaste pa folur. Mua m'u turbullua shikimi...

— Ti je i biri i Azem Bregasit? — pyeti pastaj Tefikun.

— Po, — foli ai kësaj here.

Të gjitha vështrimet tona ishin mbërthyer te buzët e mësuesit. Po ai nuk po fliste, dhe kjo gjë po na mundonte shumë. Ato pak sekonda na u dukën shumë të gjata...

«Ç'do t'i thotë vallë? Po sikur ta ledhatojë, si-

kur ta marrë me të mirë që të mos qajë..? — Atëherë mësuesi do të qetësojë Tefikun, po do të shqetësojë gjithë të tjerët...» sikur thoshin shikimet e të gjithë nxënësve, që përgjonin buzët e tij.

— Mos qaj, — u dëgjua papritmas zëri i tij. — Yt atë është kriminel dhe atë e pret dënimi i rëndë i popullit, Këtë ne do ta themi gjithmonë me zë të lartë, pa u trembur se mos lëndojmë dikë... Po ti je fëmijë... Ja, Partia të solli në shkollë... Ti duhet të mësosh mirë dhe të sillesh mirë. Babanë duhet ta urresh, se ai është kriminel. Po nuk e urreve, atëherë edhe për ty do të jetë shumë keq...

Mësuesi fliste duke tundur dorën e djathtë. Edhe e majta... mënga, bënte ca lëvizje të shqetësuara, nervoze... Dhe neve na u duk se ai krahi mbetur luftërave erdhi dhe zuri prapë vend në mëngën e xhakëtës...

— Erdha për atë lëndë, shoku Adil. Më di...

KTHIMI

Qazimi mbaroi punën dhe mori rrugën për në shtëpi. Pasi bëri disa hapa, iu kujtua se drejtori i shtëpisë së kulturës i pati thënë të kalonte një herë andej. Ecte i kënaqur me një buzagaz të lehtë në fytyrë. Ndezi një cigare dhe e thithi thellë.. Iu kujtua se drejtorit, Aqifit, nuk i pëlqente që ai të pinte duhan. Edhe vetë e kuptonte se ishte një ves shumë i keq, por i kishte mbetur që «nga ajo kohë». Atij i pëlqente të thoshte kështu, sikur të kishin kaluar disa vjet, kurse në të vërtetë nuk kishin kaluar as dy vjet që atëherë.

Pas pak ai trokiti në zyrën e drejtorit.

— Urdhëro, Qazim, — i tha ai.

— Erdha për atë fjalën, shoku Aqif. Nuk di, a ju kujtohet?

— Më kujtohet shumë mirë, — i tha drejtori, dhe sytë i vajtën te cigarja e ndezur në dorën e tij. — Po ti fike këtë të shkretë duham, në qoftë se do me të vërtetë të bëhesh muzikant i mirë. Sportistët dhe ata që merren me vegla frymore, nuk duhet ta pinë duhanin. Pastaj ti ende je fëmijë...

— Më ka mbetur që atëherë, shoku Aqif...

— Ti e le pas atë «atëherë», lëri edhe të këqijat që t'i mësoi ajo kohë.

— Do ta lë, — tha Qazimi i vendosur dhe shuahti cigaren.

— Të hënën duhet të fillosh provat për trombën. Ta mësosh, siç duhet, me nota. Mësimet do t'i bësh me Zenelin.

Qazimit i shkëlqyen sytë nga gëzimi.

— Falemnderit!

— Nuk po të bëj ndonjë nder. Kur ta mësosh mirë, do të të futim në orkestër. Vërju punës si duhet, se kemi shumë nevojë.

Pastaj Qazimi i dha dorën drejtorit dhe u nis për në shtëpi. Në zemër kishte një gëzim të madh. Ecte dhe veten e përfytyronte në orkestrën e madhe të shtëpisë së kulturës. Ja, do të ulej atje, pranë Qemalit dhe do t'i binte veglës së tij... Do të shkonin nëpër turné, do të shikonte vende të reja, qytete të reja... Dhe një çast iu kujtuan dasmat dhe ahengjet dhe ndjeu neveri për veten. Si kishte rrëshqitur në atë rrugë, qoftë edhe për pak kohë? Kjo e shqetësonte, por shqetësimi tretej kur mendonte se ishte ndarë një herë e përgjithmonë prej tyre...

Mendoi të hynte në ndonjë lokal për të pirë një gotë birrë. Ishte vapë dhe kishte etje të madhe. Para se të hynte në berrari, u takua me Qemalin. I shtrënguan duart njëri-tjetrit.

— Pimë nga një birrë? — tha Qazimi.

— Pimë.

U ulën në një tryezë pranë dritares. Kamerierja u solli birrat.

— Bisedove me drejtorin?

- Bisedova.
- Ç'të tha?
- Që nesër do të filloj të mësoj me Zenelin.
- Fort mirë, — tha i gëzuar Qemali.
- M'u plotësua dëshira.
- Gëzuar dhe suksese, — e uroi Qemali.
- Gëzim paç, — e uroi dhe Qazimi, duke trokitur gotën me të.
- Se si më vinte kur të shikoja duke i rënë curles nëpër dasma, — i tha Qemali.
- Edhe vetë kur e mendoj, më vjen turp...
- Nejse, rëndësi ka që u shkëpute. Tani do të bëhesh muzikant i vërtetë...

Qazimit i shkëlqyen sytë nga lumturia. Pagoi paret dhe doli së bashku me Qemalin. U ndanë. Qazimi ndiente një freski dhe ripërtëritje. Po mendonte se si do t'ia thoshte nënës. Edhe ajo me siguri do të gëzohej.

Shkallët i ngjiti gati me vrap dhe trokiti. Sa i hapi derën e ëma, ai iu hodh në qafë. E mbuloi atë me të puthura. Nëna nuk e kuptonte gëzimin e madh të të birit.

— Do të marr edhe unë pjesë në orkestrën e shtëpisë së kulturës, — tha ai, gati duke iu marrë fryma nga gëzimi.

— Shumë mirë, — i tha ajo dhe e përqafoi. Pastaj e pa me dashuri e dhembshuri. Atij iu duk ca i çuditshëm shikimi i nënës. Ajo nuk po gëzohej sa kishte menduar ai.

— Nënë, ti diçka ke, — i tha ai.

Ajo qeshi si e zënë në faj.

— Fol.

— Ka ardhur Myftari, — filloi të fliste nga-

dalë ajo. — Sillu mirë, ka dhjetë muaj që nuk ka ardhur në shtëpi.

— Përse ka ardhur?

— Pyetet daja përse shkon te nipi?!

— Po ai nuk ka ardhur ndonjëherë për të na parë, ti e di...

— Mirë, mirë. Dajë e ke.

Qazimit iu prish tërë gëzimi.

— Kur ka ardhur? — e pyeti nënën.

— Ka një orë...

— Pyeti për mua?

— E si të mos pyeste?! Po tani futu brenda, se nuk ka lezet të bisedojmë pas derës...

Ajo u fut vetë e para dhe kujtoi se do të kishte pas edhe të birin. Po ai më parë shkoi dhe u la, u ndërrua, pastaj u fut në dhomë.

Ai e përshëndeti ftohtë dajën, por Myftari u ngrit dhe e përqafoi me aq zjarr, sa thoshe se midis tyre nuk kishte ngjarë asgjë. Por pas këtij përqarimi midis tyre ra heshtja dhe asnjëri nuk kishte fuqi ta përzinte. Nënë Fatimja hynte e dilte e shqetësuar dhe vinte re se biseda midis të vëllait dhe të birit nuk po shkonte fare. Ajo i trembej ndonjë zënke të re... E ndiente peshën e kësaj heshtjeje dhe turbullohej kur mendonte se pas asaj mund të vinin fjalë të rënda.

— Nuk më pyete për se kam ardhur? — e hapi bisedën i pari Myftari.

— Miku nuk pyetet për se ka ardhur, — tha i getë Qazimi.

— Po, po. Mirë e ke. Po unë e kam një hall që kam ardhur në mes të vapës, katër orë larg. Dhe, kur ka hall daja, te nipi shkon e përplasat. Njeri më të afërt se nipi nuk kam.

Ai pushoi një çast dhe i hidhte shikime vjedhurazi nipit, për të parë se ç'përshtypje do t'i bënin ato fjalë. Qazimi hodhi sytë nëpër dhomë dhe vuri re se daja kishte me vete edhe lodrën. Zemra i rrahu fort dhe mendja i shkoi për keq. Iu kujtua dasma e fundit, kur u nda nga ai, për të mos shkuar më kurrë pas tij...

Në atë dasmë ishin vetëm ata të dy, Qazimi dhe Myftari. Që në minutat e para, kur filloi ahengu, Qazimi u la në djersë dhe donte të pushonte, por Myftari nuk e la, dhe ata vazhduan t'u binin veglave. U ranë tri orë pa pushuar as edhe një minutë. Bënë një pushim fare të shkurtër, pastaj Myftari kapi i pari veglën. Qazimi i tha se ishte lodhur shumë dhe se donte të pushonte edhe ca.

— Mbahu, mbahu, se tani shtrohet shamia, — tha Myftari.

— Ç'shami?!

— Ke për të parë...

— Nuk mundem. U këputa.

— Hë, mo, se kështu të duket, — e nxiti ai dhe filloi t'i binte lodrës me tërbim.

U detyrua edhe Qazimi të kapte curlen. Valltarët u derdhën përsëri në mes të dhomës, të larë në djersë. Qazimi ndiente kaq zagushi, sa i dukej se ishte midis flakëve që e përcëllonin ngadalë... Në valle hyri një burrë rreth të dyzetave me një hundë të madhe, me sy të vegjël, të skuqur nga rakia dhe pagjumësia; në njërin dorë mbante një pagure me raki, kurse në tjetrën një shkop. Kërcente duke imituar një çalaman dhe nuk ndiente kurrë lodhje. Të tjerët e nxitnin dhe ai nuk pushonte edhe kur ngrinte paguren e rakisë. Myftari, ndonëse i larë në djersë, vazhdonte t'i binte dau-

lles me gjallëri. Ai i hidhte ndonjë shikim të nipit, si për t'i thënë se nuk duhej ta turpëronte në sy të dasmorëve. Edhe Qazimi vazhdonte t'i binte curles, po gishtërinjtë e lodhur mezi lëviznin. Këtë gjë nuk e vinte re askush, veç dajës, që i lutej me shikime: veç mos u shemb përdhé, pa, për gabime, s'ka gjë.. s'vë re njeri. Qazimit i dukej se mushkëritë po i ngjiteshin gjithnjë e më lart e sikur kërkonin të dilnin prej gjoksit të tij. Në këto çaste nuk kishte dëshirë tjetër, veç të ulej, të çlodhej. Myftari e kuptoi se i nipi po e linte në baltë dhe, pa e ndalur rënien e daulles, iu afrua te veshi e i tha: «Mbahu, se tani do të shtrohet shamia». Qazimi mezi po mbahej në këmbë. Vështrimi iu mjegullua. Nuk shihte asgjë, veç hundës së madhe të atij njeriu, që nuk dinte se ç'ishte lodhja. Si gjëmime të mbytura i vinin në vesh përplasje duarsh, thirrje, gulçima... Dhoma i vinte rrotull, i dukej sikur oxhaku shkëmbente vendin me dritaret. Si në ëndërr pa, më në fund, njeriun me hundë të madhe, që u ul në mes të dhomës dhe hapi një shami të palarë prej kohësh. Njerëzit kruanin xhepat dhe hidhnin lekë në të. Shamia filloi të mbushkej. Njeriu me hundë të madhe, që kërceu aq gjatë, bëri përpara me vrull dhe ngjiti në lëkurën e daulles një pesëdhjetëshe. Më tej Qazimi nuk mbante mend më... Të nesërmen u zgjua në ethe.

Ja, kjo ngjarje po u kujtohej tani, ndaj nuk i vinte ta shikonte dajën në sy, ndiente për të një farë neverie, që e kishte të vështirë ta fshihte.

— Më kanë ftuar në atë fshatin ku u shtrua shamia... Ti e di sa pará mblodhëm atëherë vetëm në një natë. Atë natë ti nuk ishe mirë, megjithatë u mbajte për bukuri dhe fitove sa për dy muaj rro-

gë... Unë mund të marr edhe një tjetër me vete, por nuk dua të fut në xhepat e botës aq pará, duke pasur zanatçi të mirë tim nip. Nuk po të them ta lësh punën. Një rast është ky... Çap e merr paratë, pa puna nuk të ikën, aty e ke...

Qazimi po e shikonte në fillim me butësi, sikur në çast do të hapte gojën e do të pranonte: «ja, po bëhem gati të vij». Më në fund e ndjeu se duhej të fliste.

— Ke më për të më thënë? — e pyeti Myftarin.

— Ç'pata, e thashë.

— Kujtova se nuk do të më shkelje më në derë për një gjë të tillë, por ja, qenkam gabuar. Po pate ardhur për këtë, derën e ke hapur, — tha me ton të ashpër Qazimi.

— Unë po të them na kulaç, ti po më thua plaç.

— Atë lloj kulaçi që më jep mua, nuk e dua, mbaje për vete...

— Po nxjerr dajën jashtë, ë?

— Ti do të shkosh në dasmë. Nisu, se po të bëhet vonë...

— Qazim, — i foli me qortim e ëma.

— Nuk mund ta duroj më, nënë. Një herë më gremisi, tani do të më gremisë përsëri... Fol, ti, nënë, të mungon gjë, që unë të shkoj dhe të dërrmohem, nëpër ahengje?

— Asgjë nuk na mungon, bir. Po me dajën merru vesh me të butë. Edhe unë nuk dua të shkosh, por thuaja më ndryshe...

— Unë ia kam thënë me të butë, po ky nuk do ashtu.. Vetë është ndarë nga shoqëria, nuk punon, por sorollatet poshtë e lart dhe tani vjen të më tërheqë edhe mua në këtë rrugë...

— Nuk kam nevojë të më mësosh ti, — i tha Myftari rreptë.

— Mirë po të thotë djali. Hiq dorë edhe ti nga këto dasmat, — i tha nënë Fatimja të vëllait.

— Edhe ti...

— Po, edhe unë, gjersa ka të drejtë...

— Nuk do t'ju shkel më në derë, ta dini...

— Ne nuk po të themi të mos na vish, — i tha e motra.

— Më shumë të më thuash?! — tha Myftari dhe rrëmbeu lodrën.

Doli përjashta pa u përshëndetur as me të motrën, as me nipin. Qazimi ndjeu ngashërimin e nënës. Ai i shkoi asaj pranë, i vuri kokën në gjoks, i ledhatori flokët e thinjur e i tha:

— Mos qaj, nënë. Më mirë që ndodhi kështu. Ai një ditë do ta kuptojë se ne kemi të drejtë...

Pastaj ai shkoi te dritarja dhe mënjanoi pak perden. Myftari qëndronte atje, në kryqëzimin e rrugëve, dhe dukej sikur po mendohej, të shkonte apo jo...

HEKURAT E QENIT

Rruga për në spitalin partizan na lodhi shumë, sepse ishte pika e zhegut. Të përpjetën për në Malin e Tuneshit duhej ta bënim për dy orë, në vend të katër orëve që mbante zakonisht. Ecnim rrugë pa rrugë përmes një dushkaje.

— Më mirë zëmë rrugë, komandant, — më thotë Zeneli, që e kisha marrë me vete. Ai kishte të drejtë. Bëmë rreth treqind metra dhe hymë në rrugë.

Në spitalin partizan arritëm në të ngrysur. Mjeku na doli përpara dhe, si shkëmbyem përshëndetjet e zakonshme, midis nesh ra heshtja.

— Kemi ardhur të shohim Shaqirin, — i thamë.

— E di...

— Si është? — e pyeti Zeneli.

— Keq...

Ne u çelëm në fytyrë dhe mjeku e vuri re këtë.

— Ju kujtuat se mos...

— Po. Meqë rron deri tani, do të shpëtojë se s'bën, — tha i sigurtë Zeneli.

— Plumbi e ka marrë në shpatullën e djathtë

dhe i ka dalë në gjoks, pranë zemrës. Ka humbur shumë gjak, — tha mjeku.

Rrinim aty te shkallët e gurta dhe nuk dinim ç'të bënim. M'u kujtua beteja që u zhvillua një ditë më parë. «Përse e rrezikoi veten Shaqiri?»

*
* *
*

Na njoftuan se në këmbët e Sherbetkës do të kalonte me çetën e tij ballisti me damkë Halit Aliu. Aty dhe i zunë pritë. Shaqirin e kisha afër dhe më dukej se ai ziente nga padurimi më shumë nga të gjithë. Ballistët pas pak na erdhën në shteg dhe ne hapëm zjarr. Filluan të kundërpërgjigjen, por shpejt e kuptuan se çdo qëndresë për ta ishte e kotë. Bënë përpjekje për të çarë rrethimin. Sulmuan nga njëra anë, aty ku mendonin se do ta kishin më lehtë për të hapur një shteg. Kjo na dha mundësi t'u ngrinin një kurth të ri. U tërhoqëm shpejt afër ca shkëmbinjve, duke u krijuar përshtypjen se këtë e bëmë nga halli. Tani shtegu, që ishte një hendek i thellë midis dy mureve të shkëmbinjve, mbeti i hapur. Natyrisht ai vetëm dukej i tillë. Ballistët u vërsulën andej. Ne i lamë sa u futën të gjithë, pastaj i goditëm me zjarr të pandërprerë që nga shkëmbinjtë e lartë. Më në fund ata e kuptuan kurthin dhe, pasi zunë pozicion, filluan të qëllonin kundër nesh si të tërbuar.

Në këto çaste Halit Aliu nisi të zvarritej drejt, në të çarën e një shkëmbi.

— Po na ikën Halit Aliu, — tha Shaqoja dhe

u ngrit nga pozicioni e vrapoi atje ku po zvarrit-
tej kryebanditi.

Po Halit Aliu nuk kishte nga të shkonte. Sa
të dilte nga ajo e çarë shkëmbi, do të binte në
pritën e Xhelos. Ndaj m'u duk fare pa vend që të
rrezikohej kot Shaqoja.

— Kthehu, Shaqo, — i thirra.

Po ai vrapoi më tej dhe i doli Halit Aliut mbi
kokë. Që andej ai mund ta vriste atë edhe me gu-
rë... Po unë u çudita ca më shumë, kur e pashë
të binte nga shkëmbi mbi Halit Alinë. Për
disa çaste nuk pashë ç'ndodhi. Së bashku me Zene-
lin u hodhëm në të çarën midis shkëmbinjve dhe
vrapuam aty ku ata të dy po përlesheshin. Shaqoja e
kishte vënë ballistin nën vete dhe e mbante të
mbërthyer për tokë. Po ai mezi mbahej edhe vetë.
Nga supi i majtë i kullonte gjak. I vura automa-
tikun Halitit në ballë dhe i nxorëm revolen.

— Nuk kishte nga të ikte, bre Shaqo, — i tha-
shë me një farë qortimi.

— Na duhet i gjallë, komandant, — tha Sha-
qoja. Pastaj u lëkund, po ne i hymë nën krahë dhe
nuk e lamë të binte.

* * *

— Hyjmë, — thashë unë dhe bëra për nga
dera.

— Hyjmë, — tha edhe mjeku.

Shkuam te shtrati i Shaqos. Ai ishte dobësuar,
sikur të kishte vuajtur vite të tëra. Më parë nuk
mund ta mendoja se si njeriu mund të arrijë gjer në

atë gjendje e të mbetet prapë gjallë. Ai, siç dukej, flinte, dhe ne rrinim pa lëvizur e pa folur, që të mos e shqetësonim. Por ai u zgjua papritur, i pri-shur në fytyrë.

— Plaga, — tha mjeku, — I dhemb...

— Si je, Shaqo? — e pyeta unë.

— Mirë, — tha ai dhe më buzëqeshi. — Përse erdhët gjer këtu?

— Të të shohim, — i thashë.

Ai përsëri buzëqeshi. Doja ta pyesja për shumë gjëra, por e kuptoja se ai nuk duhej munduar. Ia kapa dorën dhe ia mbajta në duart e mia. Dorën tjetër ia kapi Zeneli.

— Komandant, ti nuk e di pse desha ta kapja të gjallë Halit Alinë, ë? — më pyeti ai.

— Nuk e di, — i thashë. — Po shërohu një herë, pastaj bisedojmë.

— Nuk bën të flasësh, — i tha edhe mjeku.

— Tregoja vetë komandantit, — i tha Shaqoja atij.

— Mirë, — tha mjeku dhe filloi të tregonte.

Shaqoja i mbylli sytë, dhe ne nuk e kuptuam, e zuri gjumi apo kishte qejf të dëgjonte symbyllur.

* * *

...Halit Aliut i duhej gëlqere për të lyer sarajet e veta.

— S'kemi gëlqere, aga, — i tha sejmeni plak.

— Mirrni kuajt dhe shkoni te Shaqir Derveni,

— i urdhëroi ai.

Sejmeni bëri siç i tha agai. Mori katër kuaj, u vuri koshat dhe u nis. Së bashku me të shkuan edhe tre sejmenë të tjerë.

Shaqirin e gjetën mu te gropa e gëlqeres, nën hijen e manit plak. Atë ditë kishte shitur tre barrë gëlqere dhe ja, agai po i vinte me katër kuaj. Po i ecte mbarë atë ditë... Ishte munduar një verë të tërë, duke mbajtur gurë e dru, për të djegur atë furrë me gëlqere. Donte të bënte ca pará, të bënte një shtëpi sa për të futur kokën, se kasollja po i rrëzohej.

— Kemi ardhur të marrim gëlqere për aganë,
— i tha sejmeni plak.

— Për të shitur e kam, — tha Shaqiri.

— Agai e do pa pará, — tha sejmeni.

Shaqiri u ngrys në fytyrë. Buzëqeshja që pak më parë i dukej në fytyrën e tij, u zhduk fare.

— Jam hallexhi unë dhe nuk jap gëlqere pa pará. Veç unë e di ç'kam hequr për ta bërë këtë gëlqere...

— Në shtatëmbëdhjetë katunde agai nuk blen gjë me pará, — tha njëri nga sejmenët.

— Mos na kthe kuajt bosh, se zemërimi i agait është si tërmeti, — tha sejmeni tjetër.

— Lumi mund të kthehet dhe të ecë përpjetë, po mendja ime jo, — ua preu Shaqiri.

— Paç veten më qafë, — i tha sejmeni plak dhe u nisën.

Halit agai u tërbua, kur pa koshat e kuajve bosh.

— Nuk na dha. Na tha se e jep gëlqeren vetëm me pará në dorë, — i shpjegoi njëri sejmen.

— Kështu?!

— Kështu.

Haliti hyri në konakun e burrave. Dhjetë vetëve të armatosur u dha urdhër që t'ia sillnin të lidhur Shaqir Dervenin brenda orës. Kur mercenarët ia sollën, Halit Aliu ishte ulur në një shilte dhe po pinte duhan. Ai i hodhi një shikim mospërfillës Shaqirit, të cilin e kishin detyruar të rrinte më këmbë para tij.

— Erdhe?

— Më sollën...

— T'u dhimbs gëlqerja, ë?

— Djersa gjithmonë i dhimbset njeriut...

— Të tjerët më japin kaun e vetëm të parmendës, ti s'më jep gëlqeren. Unë vë në sofër çdo ditë njëqind lugë. Ja, gjithë këta burra i duhen ushqyer, por jo me shëllirë. Duan mish këta... Për nderin e krahinës po i mbaj, që të mos na futen komunistët nëpër jataqe e të na flenë me gratë..

— Ty nuk të jep kush gjë, por ua rrëmben për të mbajtur «trimat» e tu. Këta njerëz nuk po rrinë për të mirën time dhe të fukarenjve, këta rrinë për ty... Edhe këtu ka shumë fukarenj... Fukarallëku nuk shahet, po këta janë bërë lypës... Rrinë e lëpijnë kockat që u jep ti...

Halit agai brofi në këmbë, sikur ta kishte pëkuar gjarpri. Në dorë mbante një kamxhik. Filloi ta qëllojë si i tërbuar.

— Bjer, bjer, — i tha Shaqoja dhe shtrëngonte dhëmbët.

— Deshe të tregosh burrëri. Ja burrëria...

— Një burrë i lidhur është më pak i fuqishëm se një fëmijë.

— Kur e di se je pusht, mos e fut veten ngushtë.

— Duhet t'i numërosh këta kamxhikë, Halit Aliu. Shtëpia ime nuk e ka zakon të mos e paguajë borxhin...

— Do të t'i numëroj. Do të të jap njëqind dhe do të ta zë një. Qen bir qeni, — turfullonte Haliti dhe e qëllonte sa mundtte.

Tanimë kamxhiku nuk dukej sikur po binte mbi kurrizin e një njeriu, po mbi një masë të squllët dhe të gjakosur, që kishte humbur formën, ngjyrën...

— Do më? — pyeti Halit Aliu.

Tjetri i hodhi një shikim tërë urrejtje, por nuk i foli. Nga goja po i dilte gjak. Ai bëri një hap përpara me shumë mundim dhe e pështyu mu në fytyrë.

— Qen, — ulëriti përsëri Haliti dhe e goditi Shaqon në fytyrë e ku mundi. Po ai tashmë i kishte humbur ndjenjat.

— Më sillni një palë hekurë qeni, — thirri Haliti.

Dikush ia plotësoi kërkesën.

Njerëzit po vështronin me habi. Ata në fillim nuk e kuptuan urdhrin e çuditshëm të agait. Atij që ishte pothuaj i vdekur, ai po i vinte hekurat e qenit në qafë... Mbërtheu hallkën mirë dhe e tërhoqi zvarrë disa hapa.

— Lidheni te qentë, le të rrijë me ta, se qen është edhe ky, — tha ai. Dhe ashtu u bë...

Kur mjeku mbaroi së treguari, unë dhe Zeneli ofshamë. Shaqoja çeli sytë dhe na pa. Çfarë nuk shprehnin sytë e tij. Po, mbi të gjitha, ata shpreh-

nin urrejtje për ata që kishin lyer duart gjer në
bërryla me gjakun e popullit.

— Kështu ka ndodhur, — tha ai, dhe ne e kup-
tuam që e kishte ndjekur tregimin e mjekut.

— Shërohu, Shaqo, — i thashë, — dhe na i gjej
ato hekurat e qenit, se do t'ia vëmë në qafë para
se t'i japim plumbin kokës...

— Do t'i gjej, komandant. I kam fshehur. Pran-
daj desha ta kapja të gjallë.

E përqaftuam dhe i uruam shërim të shpejtë.

NXENËSI IM, HAJDARI...

Ishte fundi i majit. Gjatë atyre ditëve kisha pasur shumë punë në shkollë dhe nuk më ishte dhënë rasti të dilja qoftë edhe për disa orë buzë lumit. Një mbrëmje vendosa të shkoja te një fshatar në Bardhaj, i cili më kishte ftuar disa herë në shtëpi. M'u dha mundësia që edhe të shijoja bukuritë e natyrës, dhe të mbërrija në kohë atje ku doja...

Rreth një kilometër larg lumit, paralel me të, ishte xhadeja, por mua më pëlqeu të udhëtoja buzë lumit, ndaj mora një rrugë të ngushtë këmbësore, traga e së cilës herë humbiste dhe herë shfaqej përmes barit të dendur, shelgjeve dhe verrinjve.

Si bëra rreth dy kilometra rrugë, u gjenda para një përroi të vogël me ujë të kulluar, që zbriste tatëpjetë malit me një zhaurimë të lehtë dhe futej në lumë. Rreth njëqind metra larg lumit përroi degëzohej në një mënyrë të tillë që ngjante me pëllëmbën e dorës së njeriut, pastaj degëzimet bashkoheshin duke krijuar një rrymë të fuqishme në vete, me ujë krejt të gjelbër. Atje ku ujërat e lumit priteshin nga ato të përroit, krijohej një gjeratore, va-

lët e së cilës, në formën e rrathëve koncentrikë, shfaqeshin dhe shkriheshin pa ndërprerje.

Si kisha udhëtuar rreth dyzet minuta, traga e rrugës së ngushtë këmbësore më humbi përfare dhe u gjenda para një parcele me jonxhë, e cila, siç dukej, ishte ruajtur për farë. Më erdhi keq që do të ndahesha nga ai gjelbërim joshës dhe zhaurima e ëmbël e lumit, ndaj me përtim u nisa përpjetë, për të hipur në xhade.

Bëra disa hapa dhe në një kthesë të vogël, nën hijen e një verrini, pashë një njeri. Ishte nxënësi im i klasës së tetë, Hajdari. Ai, sa më pa, u ngrit në këmbë disi i turpëruar. I thashë të ulej dhe i shkova pranë. Në tokë, mbi një copë gazetë, kishte shtruar drekën.

— Ha, Hajdar, — i thashë.

— A hamë bashkë, mësues?

— Falemnderit. Po ti përse po ha kaq vonë?

— Nuk pata kohë, mësues. Pastaj sikur më iku oreksi...

Unë ndeza një cigare, kurse Hajdari vazhdoi të hante.

M'u kujtua fillimi i vitit shkollor. Hajdari nuk erdhi për t'u regjistruar deri ditët e fundit. Isha mësues kujdestar i klasës së tetë dhe i vajta në shtëpi. Hajdarin e gjeta poshtë, në zall, duke grumbulluar gurë.

— Përse nuk ke ardhur të regjistrohesh? — e pyeta.

— Kisha punë...

— Punë kanë të gjithë, por për t'u regjistruar vijnë...

Ai heshtte dhe dukej sikur nuk i kuptonte ato që i thosha unë.

— Të tjerët kanë marrë librat. Pasesër fillon mësimi... — thashë.

— Kam librat e motrës, ajo vjet mbaroi të tetën, — tha Hajdari.

«Siç duket, me këtë kam për të pasur telashe», mendova.

Po Hajdarin nuk e pata problem për asgjë, me përjashtim të disa rasteve, kur vinte vonë në orën e parë të mësimit. Në shkollë erdhi më një shtator dhe u ul i heshtur në bangën që i caktova. Rrinte gjithmonë tepër i përqëndruar në orë të mësimit. Të dukej sikur ose kuptonte gjithçka, ose nuk kuptonte asgjë nga ato që thoshte mësuesi në klasë... Nuk e kisha parë ndonjëherë të ngrinte dorën. Por, kur e pyesja, fliste bukur dhe qartë. Në mënyrë të veçantë ai dallohej në hartime. Këtë e vura re që në hartimin e parë. Qe një temë e lirë. Kur korrigjova fletoren e tij, u befasova nga mendimet, figurat e bukura plot njomësi dhe nativitetet femënor...

Në hartimin e tij vend të veçantë zinte përshkrimi i natyrës: arat e mbjella me misër dhe grurë, vreshtat, lumi dhe veçanërisht pylli. Ia lexova hartimin para klasës. Ai u skuq nga turpi dhe në gjithë qenien e tij nuk pashë asnjë grimë krenarie...

— Nga t'ia mbajmë, mësues? — më pyeti ai, pasi kishte mbaruar së ngrëni.

— Ka rrugë tjetër veç xhadesë?

— Ka. Në fund të jonxhës, mu buzë lumit...

— Andej shkojmë, — i thashë.

Hajdari mori tatëpjetë dhe u fut në një udhësihte që mezi dukej nga bari i dendur dhe i rritur shumë. Pasi morëm kthesën nga e majta, rruga fi-

lloi të shquhej gjithnjë e më mirë. Ecnim pranë lumit, paralel me të...

— I bukur lumi, ë? — më pyeti.

— I bukur, shumë i bukur.

— Unë kësaj rruge vij gjithnjë.

— Sa bukur duhet të jetë këndeje në mbrëmje...

— Kështu thonë të gjithë, — më tha Hajdari.

— Çfarë?

— Të gjithë thonë se mbrëmjet janë më të bukura. Po mëngjeset në të vërtetë janë shumë më të bukura se mbrëmjet. Po kalove në mëngjes kësaj rruge, sidomos pak më tej, atje ku fillon pylli, të këndon zemra nga gëzimi...

— Ashtu?!

— Nuk ka si mëngjeset, mësues. Natyra zgjohet dhe merr jetë. Tërë gjallëria të futet në krahëror.

— Po më flet si poet. Qenke adhures i flaktë i natyrës.

— Të gjithë e duan natyrën. Çdo njeri, po të kalojë këndeje në mëngjes, do të mahnitet. Pylli natën të fut frikën dhe nuk dallon asgjë në të... Në mëngjes ai ka plot zëra, tinguj, ngjyra... Në mëngjes ai t'i rëndon këmbët...

— Ç'është ky rëndim i këmbëve?

— Kështu thoshte gjyshi im, kur rruga nuk të lë të ecësh, por të ndal në vend, të bën të humbasësh mendjen, të hutohesh, të harrohesh... Nga njëherë kam ardhur vonë në shkollë vetëm për shkak të kësaj rruge.

— Eh, Hajdar, — dhe nuk dita çfarë t'i thosha. Ai më buzëqeshi.

Kishim kaluar urën e drunjtë dhe po hynim në pyll. Rruga e pyllit ishte vërtet shumë e bukur, veç ca e shkurtër...

— Po ti e bën gjithnjë këtë rrugë, ë?— e pyeta.
— Po.
— Dhe të njëjtat mbresa të lë çdo ditë?
— Po, mësues.
— Po edhe një libër, sado i bukur qoftë, Hajdar, po e lexove disa herë, s'ke dëshirë ta lexosh më, — desha të bëja unë një farë krahasimi midis pyllit dhe librit.

— Nuk është kështu, mësues. Një libër, sado i bukur qoftë, ka një fund, ku vihet pikë. Po me pyllin ndryshon puna. Ja, ai zogu që po këndon atje, siç duket, vjen për herë të parë në këtë pyll. Është gardalinë dhe këta zogj rrallëherë futen në thellësi të pyjeve. Ato kulprat midis atyre drurëve, që duken shumë të bukura, tani, pas dy-tri javësh do të duken si të thara. Po zgjohen bukuri të tjera të reja. Ky druri i bushit, që tani duket i murrëtyer, pas pak ditësh, do të bëhet shumë i bukur... Këtu gjithçka ndryshon brenda pak ditësh dhe jo nga stina në stinë. Nuk po flas për pyllin në vjeshtë. Atëherë ai është shumë i bukur. Po edhe në dimër dhe në çdo stinë tjetër pylli ka bukurinë e vet...

— Ke të drejtë, Hajdar, — i thashë dhe e vështrova me dashuri.

— Mësues, te Muharremi do të shkoni, apo jo?

— Po.

— Po a nuk bën që sonte të vini te shtëpia ime?

— Muharremi më pret. I kam dhënë fjalën.

— Ajo shtëpia e parë në rrëzë të kodrës është shtëpia ime. Të vini, të paktën, për pak kohë. Keni kohë për të shkuar te Muharremi, — më tha ai dhe unë e kuptova se në zemrën e tij vlonte dëshira për të më pasur një natë mik.

— Mirë, Hajdar, do të vij, — i premtova.

Shtëpia e Hajdarit ishte e zhytur në gjelbërim. Ishte e rrethuar me shumë pemë dhe mezi i dukej çatia. Hapëm portën e gardhit prej listelash dhe u ndodhëm në një rrugicë të kalldrëmtë, në të dyja anët e së cilës ishin mbjellë mollë. Mollët ishin paksa afër njëra-tjetrës, dhe u mplikseshin degët sipër rrugicës së kalldrëmtë, duke formuar kështu një tunel të gjelbër. Arritëm në kopsht. Ishte shumë i bukur. Unë i thashë Hajdarit të rrinim përjashta.

— Si të doni, — më tha ai dhe më tregoi një karrige e një tryezë të rrumbullakët hekuri nën hijen e mollëve.

— Nuk qenka njeri në shtëpi, — më tha ai me keqardhje dhe vuri në tryezë një mbulesë të pastër, borë të bardhë.

— Nuk ka gjë. Rrimë bashkë, — i thashë.

— Mësues, dridhe një cigare nga duhani i babait, — më tha Hajdari, duke më vënë përpara një kuti fakfani të mbushur plot me duan të grirë në kimë, që ishte krejt i verdhë. Fillova të dridhja një cigare. Hajdari hyri përsëri me nxitim brenda dhe u kthye me një brokë të mbushur me dhallë.

— Nuk di a ju pëlqen dhalla, mësues? — më pyeti dhe priste përgjigjen time.

— Më pëlqen shumë, — i thashë.

— Është e freskët, — tha i kënaqur.

Më mbushi një gotë dhe pastaj edhe një tjetër. Dhalla vërtet ishte e freskët dhe unë nuk doja gjë tjetër më të mirë në ato çaste.

— Mësues, pa shiko këndeje, — më tërhoqi vëmendjen Hajdari, duke më treguar diçka lart me dorë.

Ngrita kokën dhe pashë se sipër meje ishte një qershi, që sapo ishte pjekur.

— Është një qershi që piqet herët. Nuk besoj t'i keni provuar për këtë vit.

— Jo, — i thashë, por kujdes mos rrëzohesh.

— Për këtë mos u bëni merak, — tha ai dhe hyri brenda.

Kishte marrë një shportë të bardhë të vogël, të punuar me thupra shelgu të holla dhe iu ngjiti qershisë.

Pas disa minutash ai u kthye me shportën plot.

Haja qershitë që m'i solli Hajdari dhe mendoja se gjer atëherë pak e kisha njohur nxënësin tim...

BUCELA

Atëherë punoja në muzeun e rrethit. Shkova me shërbim në zonën e Nerbinit për të mbledhur objekte me vlera muzeale. Ishte e treta ditë që po rrija në fshatin e vogël të Benishtit dhe nuk isha i penduar, se puna po më ecte mbarë. Fshatarët vinin një nga një në shkollë e më sillnin objekte të ndryshme.

Ishte fundi i janarit dhe dëborë që kishte rënë dy javë më parë, kishte vënë një korë të fortë, sa dukej se nuk do të shkrinte as edhe në maj... Era e fortë, që vinte nga gryka e lumit, e bënte kallkan dëborën. Vetëm në mesditë, kur kishte pak diell, dukej sikur dëborë lotonte...

Po rrija në një dhomë të shkollës së bashku me drejtorin. Soba bubullonte, e ne vështronim në heshtje dëborën e re, që po binte mbi të vjetrën...

— Ka për ta mbushur, se është ngricë, — i tha shë drejtorit.

— Ka kohën, — tha ai.

U hodha një sy objekteve që më kishin ardhur. Drejtori e ndoqi shikimin tim.

— Grumbullove mjaft, — tha ai.

— Po.

Hodha sytë përsëri matanë dritares dhe vura re një plak me një bucelë në krahë, që po vinte tatëpjetë. M'u duk se ishte drejtuar për në shkollë.

— Po ky? — pyeta drejtorin dhe tregova me kokë plakun.

Drejtori pa përjashta.

— Po vjen këtu. Është Fasli Sereri, — më tha ai.

— Mos do të na sjellë bucelën? — e pyeta dhe qesha.

— Po, — tha drejtori.

— Ç'na duhet?! A mos është ndonjë punim i hershëm dhe ka vlera etnografike?

— Edhe mund të jetë, por ajo ka vlera të tjera... — tha ai.

Vështrimi im ishte pyetës.

— Ta thotë vetë Fasliu...

— Mirë se rrini burra, — na përshëndeti sa hyri brenda.

— Mirë se erdhe, — i thamë ne njëzëri.

Kishte ngrirë nga të ftohtit. Dëbora ia kishte mbuluar krejt fytyrën me një shtresë të hollë akulli. Mustaqet i rrinin horizontalisht sipër gojës e i zgjateshin gjer te veshët, vetullat i ishin bërë si dy ballkone të vogla akulli sipër syve të vegjël që lëvrinin me gjallëri.

Ia morëm bucelën nga duart dhe e vumë në qoshe të dhomës. Plaku u ul në karrigen që i treguam, u afrua te soba, dhe, me duart që nuk i bindeshin, hoqi me zor shaminë me të cilën kishte mbështjellë veshët.

— Ftohtë, — tha plakun.

— Ka kohën, — tha përsëri drejtori.

Plakut, si iu çmpinë duart e iu shkri cipa e akullit, shikoi sendet që kisha mbledhur.

— Ta solla edhe unë bucelën, — tha ai.

Nuk i fola, veç buzëqesha. Ajo, me sa shikoja, ishte një bucelë si gjithë ato që mbajnë fshatarët dhe nuk e kuptoja se çfarë vlere muzeale mund të kishte. Plaku sikur m'i lexoi mendimet dhe më shikoi në sy.

— Nuk është si tërë bucelat, — tha ai.

— Po, po, — thashë kot.

— Është e shpuar, o shoku i muzeut. Nuk bën më për ujë kjo. Ka tridhjetë vjet që po e mbaj të shpuar. Ua tregoj shpesh fëmijëve, nipërve e mbaseve. Mbase duhet ta shohin më shumë njerëz...

Tashmë tek unë kureshtja dhe interesi ishin zgjuar. U ngrita dhe e vështrova nga afër. Vërtet ajo ishte e shpuar: kishte tetë vrima.

— Janë vrima plumbi, o byrazer, — tha plaku.

Mbeta pak i habitur. Nuk mund ta gjeja se në ç'rrethana ishte shpuar nga plumbat ajo bucelë. «Mos vallë është vënë në ndonjë barrikadë», mendova.

— Mbase nuk bën për muze, por ti gjykoje vetë, — tha plaku.

— Tregoje historinë e bucelës, — i tha drejtori plakut.

E lashë bucelën dhe u ula në stol. Plaku kapi me duart e ashpra një thëngjill të ndezur dhe e vuri në llullë. E thithi llullën dy-tri herë dhe nxori tymin me një duf të brendshëm...

«Dikur Benishti ishte fshat i vogël, o byrazer. Tani, në vitet e Partisë, është rritur shumë. Na pati rralluar pushkë. Pushka e gjakmarrjes ishte

futur midis nesh si sëpata në zabel dhe na shkurtonte njërin pas tjetrit. Agallarët na shikonin si vriteshim dhe u bëhej qejfi. Ata na nxitnin në këtë rrugë... Krisma sillte krismën dhe kështu vrasjet s'kishin të pushuar.

Babai im vrau për gjak njërin nga fisi i Gjonajve. Atëherë ai ishte tridhjetë vjeç dhe unë akoma nuk kisha lindur. Që nga dita kur mori gjakun, babai u mbyll në kullë. Dyzet vjet pa i shkelur këmba në tokë, dyzet vjet pa dalë përjashta... Dalëngadalë u dobësua dhe u tha fare. Natë e ditë ecte nëpër dhomë: çmpinte këmbët që i ishin drunue... Filloi t'i ndryshohej edhe zëri, dhe drita e syve dita-ditës po i fikej.

Një ditë, në drekë, kur u kthëva me lopën në shtëpi, i habitur pa masë pashë babanë në oborr. Mbante kokën lart dhe nuk e kuptoja se ku shkonte.

— Baba, përse paske dalë jashtë? — e pyeta.

— Dola, bir, — tha ai dhe lotët i rrodhën faqeve.

— Po do të të vrasin hasmët, baba, — i thashë tërë frikë.

— Tani, si jam katandisur unë, as hasmit nuk po iu dashkam, — tha ai dhe nuk ishte në gjendje t'i mbante lotët.

Më vonë e kuptova se babai kishte dalë që ta vrisnin hasmët dhe të mos ngujohesha edhe unë në kullë si ai... Po, sa kishte dalë në dritë të diellit, pamja iu errësua. Gjonajt kishin rrëmbyer dogratë dhe kishin vrapuar ta vrisnin... Babai ecte kuturu duke u mbajtur pas pëmëve, pas gardheve, pas murëve... Ata e kishin kuptuar se babai nuk shkonte më dhe kishin ngritur armët. Nuk kishin dashur të

vrisnin një të verbër. Prisinin të rritesha unë dhe ta merrnin hakun siç duhej...

Nuk kaluan as edhe tri ditë dhe babai vdiq.

Unë i kisha mbushur të katërmbëdhjetat dhe Gjonajt tani kishin të drejtë të më vrisnin për gjak. U mbylla në kullë edhe unë si babai. A e dini se ç'do të thotë të mbyllesh në kullë në atë moshë? Për tridhjetë vjet kam grisur vetëm një palë opinga lope.

Isha i vetmi mashkull në shtëpi, dhe nëna më lutej çdo natë të mos dilja as edhe një çast përjashta. U mbylla brenda çunak i vogël dhe u bëra për t'u martuar. U morëm leje hasmëve për shtatë ditë dhe shtatë net dhe bëmë dasmën. Pas dasmës u mbylla prapë. Nëna dhe nusja punonin në ara, kurse unë rrija brenda.

Nganjëherë më vinte të dilja përjashta, pa le të vdisja. Më kishte marrë malli të shkelja në tokë, të ulesha në barin e blertë, të preka një dru të njomë, të dëgjoja zogjtë duke kënduar, të kapja parmendën dhe të ecja pas qeve në ugar... E për çfarë nuk po më grinte malli...

— Do të të vrasin, bir, — më tha nëna e merakosur një natë.

— Po unë nuk kam dalë jashtë... Plumbi nuk i shpion muret, e Gjonajt nuk kanë top të më gëllojnë; — e qetësova unë.

— Po nënat si nënat. E ku nuk u shkon mendja atyre...

— Hasmi të vret edhe brenda...

— Si?!

— Ja, nga dollapi!! Xhakallarët nga dollapi i kanë vrarë, të keqen nëna; — tha ajo sikur po vajtonte.

Mbeta pak i habitur, se nuk e kuptoja si mund të më vrisnin nga dollapi në katin e dytë të kullës, kur dollapëve u vinim çdo natë rrasa pas.

— Dollapët kanë rrasa, nënë.

— Rrasa thyhet, bir, dhe, në mos plumbi i parë, i dyti të vret...

Atë natë, kur ramë të flinim, nëna i tha nuses sime:

— Sill bucelat...

Nusja bëri siç i thanë. Solli dy bucelat me ujë që i mbanim në hajat. Nëna mori njëren bucelë dhe e vuri pas dollapit, kështu bëri edhe me tjetrën për dollapin tjetër.

— Tani nuk të gjem gjë, — u qetësua ajo.

Desha ta pyesja nënën, por ajo nuk më la rast t'i flisja.

— Bucela e ftoh plumbin dhe ai nuk mbërrin as gjer te vatra...

Që nga ajo natë nuk i hoqëm bucelat nga dollapët. Kaloi shumë kohë dhe asgjë nuk po ndodhte. Megjithatë ne çdo mbrëmje i ngrinim bucelat dhe i vinim te dollapët. Ia zura në gojë nënës njëherë me të qeshur atë punën e bucelave, por ajo ma ktheu gjithë seriozitet:

— E keqja një herë ndodh, bir.

Një natë, aty nga mëngjesi, u dëgjuan krisma pushkësh. Thoshe se po më shtinin mu pranë veshit. U ngrita përnjëherë dhe kapa pushkën. Nusja ndezi menjëherë kandilin. Ishte e qartë se kishin qëlluar nga dollapët. Njëra bucelë ishte shpuar dhe currilat e ujit filluan të rridhnin si shatërvanë të vegjël... Shtiva në sharapol andej nga m'u duk se po vraponin për të ikur disa njerëz. Po plumbat e mi, siç duket, nuk zunë asnjëri. U ktheva në dhomë i

habitur. Nëna dhe nusja ishin zbehur në fytyrë dhe ishin bërë si ajo flaka e kandilit, që luhatej në të fikur. Currilat e ujit të bucelës rridhnin e rridhnin dhe askush nuk kujtohej për këtë gjë. Dhoma po mbushej me ujë...

— Na mbuloi uji, moj nënë, — dhashë alarmin unë, sikur po e shihja ujin vetëm atë çast.

— Uji po, por jo gjaku, o bir, — tha nëna e kënaqur.

— S'e shikon?! — Hiqe bucelën, — e urdhërova unë nusen dhe ajo e hoqi menjëherë.

— Ti shiko këto dhe lëre bucelën, se ajo të shpëtoi, — tha nëna, duke më treguar diçka. Ishin katër plumba dograje, që kishin rënë në mes të dhomës, pa shkuar as gjer te muri...

— Kush i dëgjon nënës, nuk e gjen asgjë e keqe, — sikur u mburr ajo.

— Kështu ka ndodhur, — përfundoi plaku.

— Besoj se duhet, — tha drejtori.

— Ka vlera muzeale, bile shumë, — thashë unë. Plakut iu bë qejfi.

TELEFONI

Tringëlliu zilja e telefonit. Unë dhe Desi u ngritëm përnjëherësh në këmbë, por, sikur po bënim diçka që nuk duhej, mbetëm për disa çaste të ngrira... Desi ishte pesë vjet më e madhe se unë, dhe ajo duhej të fliste në telefon. Ky zakon ishte vendosur prej kohësh në shtëpinë tonë: kur ishte babai në shtëpi, ai e ngrinte dorezën e telefonit, në mungesë të tij këtë punë e bënte nëna dhe kështu me radhë. Mua më mbetej të përgjigjesha në telefon vetëm kur nuk kishte njeri tjetër në shtëpi.

Po Desi e dinte se më kërkonin mua...

Dy javë më parë tringëlliu zilja e telefonit dhe nëna ngriti dorezën, por sa tha dy-tri herë «alo», ai që kishte kërkuar e mbylli. Në veshët e nënës mbeti sinjali shurdhues «piuuu-piuu...» Ajo u befasua dhe më shikoi mua dhe Desin.

— Vera, ti i bën këto gjëra? — m'u drejtua mua.

— Ç'thua, mama? — i thashë e habitur.

Ajo nuk foli më, veç më tundi kokën. U skuqta dhe ula sytë sikur të isha fajtorë. Në të vërtetë nuk e ndieja veten të tillë, por nuk doja ta shqetësoja nënën.

— Ty, besoj, të kërkojnë, — më tha Desi mua. Atëherë ajo u ul, si pak çaste më parë, dhe unë ngrita dorezën e telefonit. Ishte Genci. Biseduam vetëm pak çaste. Qe një dialog i dobët dhe gati i shqetësuar, për shkak se aty ishte edhe Desi e na dëgjonte.

— Kam dy minuta që i bie numrit, — tha ai.

— Si je? — e pyeta unë, që të mos ia shpje-goja se përse u vonova në përgjigje.

— Ne sapo u ndamë, — u dëgjua zëri matanë.

— Mirë, mirë — thashë unë kot.

— Dëgjo, Vera, Kam siguruar dy bileta për në teatër. Të pres në gjashtë e gjysmë, mirë?

— Mirë, — thashë unë dhe lëshova dorezën e telefonit ngadalë sikur ajo të kishte qenë tepër e rëndë. Desi vazhdonte të hekuroste, por mua më dukej sikur duart i dridheshin prej zemërimit.

Shkova në dhomë dhe hapa një libër... Sytë më rrëshqitnin nëpër shkronja, nuk po merrja vesh asgjë. Akoma nuk më kishte kaluar tronditja. Nëse dy javë më parë vetëm se qe dyshuar mos më kërkonte në telefon ndonjë djalë, tani kjo, si të thuash, u vërtetua...

Desi nuk më pyeti fare se me kë bisedova. Me këtë heshtje ajo më dukje sikur po më thoshte: «e di unë që ke filluar, e di...». Dhe më erdhi inat që ajo nuk më pyeti. Do t'ia kisha hapur zemrën dhe do t'ia kisha treguar të vërtetën. Mbase do të më kuptonte...

Në shtëpinë tonë kishim dhe një zakon tjetër: fejesat dhe martesat do të bëheshin me radhë, sipas moshës. Unë pikërisht këtë zakon po prishja...

Desi, në moshën që kam unë tani, ishte e bukur dhe e freskët. Tani ajo nuk e ka më atë bu-

kuri dhe freski, sepse i ka kapërcyer pak mosha. Atëherë asaj i patën propozuar shumë djem, por ajo të gjithëve ua priste, duke u thënë se kishte familje dhe për të vendoste nëna dhe babai. Ajo mendonte se po vepronte drejt dhe nuk i lejoi vetes që t'i hynte në zemër ndonjë djalë.. Babai dhe nëna mburrëshin me Desin dhe këtë ia thoshin hapur, duke më shikuar mua. Ato shikime, po t'i zbërtheje, do të thoshin pak a shumë kështu: «Edhe ti të na bëhesh si Desi dhe jo të na hargalisesh me djemtë».

Disa djem e kërkuan Desin edhe në familje, por babait dhe nënës asnjëri nga ata nuk ua mbushi mendjen, për të bërë dhëndër. Ndodhte që djali edhe u pëlqente, por nuk u hahej muhabeti me vjehrrën apo vjehrrin, hallën apo tezen...

Prindërit e mi sikur u mësuan, me këto pritje e përcjellje të vogla, që përfundonin në hiçgjë. Për veten time ato i quaja pjesën më të humbur të kohës. Ndihesha disi e nervozuar dhe e vetmuar. Sa herë vinte dikush për të kërkuar Desin, doja të dilja përjashta, por, babai nuk më linte. Ai e kishte qejf që aty të ishin tërë pjesëtarët e familjes...

Në këto bisedime thuheshin të njëjtat fjalë dhe po në të njëjtën mënyrë... Babai në fillim dëgjonte i krekosur palën e djalit, pastaj u buzëqeshte atyre pa të keq dhe merrte pamjen të du-llë e thoshte «e kemi akoma të re vajzën», më falni, por...

Nëna shikonte babanë me admirim dhe tundte kokën në shenjë aprovimi të plotë për çdo fjalë që thoshte ai... Pastaj, ata, që kishin ardhur për Desin, ngriheshin dhe iknin.

Po kishte më se një vit që nuk po vinte më njeri për Desin, zilja nuk tringëllinte dhe ne për shumë kohë i mbajtëm veshët ngritur... Në fillim nuk na besohej që Desin nuk do ta kërkonin më, por më vonë kjo gjë u bë e qartë.

Tani gjithnjë e më shpesh tringëllinte zilja e telefonit. Por kjo binte për mua... Ajo që pati ndodhur një herë me nënën dhe me Desin, ndodhi edhe me babanë. Sapo kishim mbaruar së ngrëni. Babai ngriti dorezën dhe tha «alo». Telefoni matanë, siç duket, u mbyll dhe në veshët e babait mbeti ai sinjali «piuuu-piuuu». «Alo», «alo», bërtiti babai edhe disa herë të tjera, e, kur e shikoi se nuk do t'i përgjigjeshin më, përplasi dorezën mbi telefon. Dukej i qetë në pamjen e jashtme, por përbrenda i vlonte zemërimi. Na hodhi një shikim të trijave.

— Ç'është kjo? — pyeti egër ai.

— ...

— Kur ka filluar të luhet komedi në shtëpinë time. — Ai këtë radhë më shikonte mua sikur do të më hante. E kuptova se mbrojtja më e sigurtë ishte jo të gënjeja, por të matesha sy për sy me të.

— Përse më drejtohesh mua? — e pyeta, duke e vështruar ngultazi.

— Ti i bën këto proçka, prandaj...

— Baba...

— Mjaft. Nuk dua asnjë fjalë. — Ai përplasi derën dhe shkoi në dhomën e tij.

Ne të trija mbetëm si të ngrira. Nëna donte të më fliste, por këtë gjë nuk donte ta bënte në sy të Desit. Desi e kuptoi dhe gjeti një shkak e doli përjashta.

— Ç'është ky turp? — më pyeti nëna.

— Ç'turp, mama?!
— Të marrin bandillët në telefon, dhe, sa dëgjojnë zërat tanë, «trak» mbyllin telefonin...

— Nuk e di se kush ka marrë në telefon, mama.
Nuk po gënjeja, Vërtet nuk e dija.

— Prit, moj e uruar, prit. Nuk them të mos duash një djalë, por ti ke motrën njëherë, pastaj. Mbete si e hutuar, pa ditur ç'të thosha... Një herë mendova t'i hapësja dhe t'i tregoja se doja Gencin, një shok të kursit. Po zemra ma thoshte se nuk kishte për të më kuptuar dhe nuk do të pranonte kurrsesi që unë të filloja nga «dashurikat», para se të merrte fund puna e Desit. Tek ajo ishte shumë i rrënjosur, zakoni i «radhës».

Nganjëherë më thoshte mendja t'ia thosha në sy nënës së ajo dhe babai ishin bërë shkaktarë që Desi nuk ishte fejuar akoma... Natyrisht faj kishte edhe ajo që ishte nënshtruar deri në atë shkallë. Po e pashë të udhës që të mos e dëshpëroja nënën. «Le të mbetet e fshehtë, sa mund të mbetet...» thashë me vete dhe e qetësova, duke i thënë se unë nuk do të mendoja për fejesë dhe për martesë para Desit. Më vinte turp që po gënjeja dhe u skuqa.

Nëna u qetësua disi dhe shkoi në kuzhinë. U ula në divan e lodhur, e dëshpëruar dhe e fyer. Pranë më erdhi Desi. Ajo hapi një bisedë për librat. Rrinim kokë më kokë pranë njëra-tjetrës, gati të përqafuara dhe bisedonim... Kishte kohë që nuk kishim ndenjur kështu. Pas pak dolëm nga dhoma dhe shkuan në kuzhinë. Më vajtën sytë menjëherë të telefoni që qëndronte i zi dhe memec mbi raftin e vogël. I hodha një shikim Desit dhe vura re se edhe ajo ia kishte ngulur sytë atij. Ajo shpikje

e mrekullueshme për t'i lidhur njerëzit, për të të sjellë zërin e dashur edhe në distancat më të largëta, sikur u bë për ne një gjë e padëshiruar.

Këto ndjenja, ose diçka të përafërt, më dukej se kishte edhe Desi. Në shtëpinë tonë shqetësimi ishte futur nëpërmjet tij, ndaj na dukej disi i ftohtë dhe i kobshëm...

I thashë Gencit që të mos më telefononte më dhe në shtëpinë tonë prapë ra qetësia.

Po e fshehta nuk mund të mbetet përgjithmonë e pazbuluar...

Një pasdite, kur po dilja nga fakulteti, binte shi. Genci më shoqëroi deri në MAPO. Shiu, që në fillim ishte i lehtë dhe i qetë, filloi të binte me rrëmbim. Njerëzit vrapuan srehëve, kafeneve....

— Filluan shirat e mërzitshme, — thashë unë.

— Unë e dua shiun, — tha Genci.

— Shiu është i mërzitshëm. Futemi gjëkund se po lagemi.

Ku të pëlqen?

— Ku të pëlqen?

— Futemi në kafe «Riviera», — më tha Genci.

U futëm në një kafe, ku menduam se ishte zhvilluar subjekti i një tregimi të botuar ato ditë. I hodhëm një sy lokalit. Ai ishte plot. Pritëm sa u ngrit një çift dhe zumë vendet e tyre. Tani përjashta kishte filluar të binte një shi i imët, por i dendur. Duke vështruar shiun përmes zhamit dhe perdeve të holla, mendja më shkoi në fshatin e Gencit, diku në Veri, ku kisha ndër mend të shkoja si mësuese, kur të mbaronim studimet. Fshatin nuk e kisha parë, por unë e kisha ngritur në përfytyrimin tim sipas tregimeve të Gencit.

— Në fshatin tënd tani duhet të bjerë, borë, ë?

— Jo, është herët akoma për borën. Mbase nuk bie as shi, — tha Genci.

— Nuk paska fejesa sot, — i thashë unë, duke e ndërruar temën e bisedës.

— Nga e kupton?

— Nuk ka tryeza të bashkuara. Mos vallë i ka trembur tregimi?

— Ohu dhe ti, Vera! Ata që bëjnë fejesa të tilla, nuk lexojnë..

— Edhe lexojnë, — thashë unë si me dyshim.

— Ç'dëshironi?

Kamerierja po na shikonte me një buzagas të lehtë:

— Ç'do ti, Vera?

— Një zupë.

— Dy zupa, — i tha Genci kamerieres.

— Sikur të isha shkrimtar, do të shkruaja edhe unë një tregim kundër kësaj «radhës» që na mundenon ne të dy, — tha Genci.

— Provoje, — i thashë duke qeshur.

Kamerierja na solli zupat. Tashmë shiu kishte pushuar. Pashë Desin që po ecte nëpër trotuar. Ajo do të kalonte mu përpara nesh dhe do të na shikonte, me siguri. Nga ajo do të na ndante vetëm xhami dhe perdja e tejdukshme. Dora sikur m'u mpi dhe nuk mund të ngrija dot as lugën e vogël. Genci e vuri re.

— Ç'ke? — më pyeti.

— Motraj, — i thashë unë, duke treguar Desin që po vinte drejt nesh. — Do të na shohë, — shtova pastaj.

— Le të na shohë..

— Ti e di që ua kam fshehur të vërtetën, — thashë disi e nëvrikosur edhe me Gencin.

Sa më shumë afrohej Desi, aq më shumë më rrihte zemra. Çfarë nuk do të bëja, që të mos dilja gënjeshtare! Veç të mos më shikonte kësaj radhe, por, me të shkuar në shtëpi, do t'ia thosha të gjitha. Ajo, aq e mirë sa ç'ishte, do të më kuptonte dhe nuk do t'i vinte keq që nuk po e respektoja «radhën»... Por, edhe sikur të mos më kuptonte, prapë kjo gjë do të ishte më e mirë se gënjeshtria. «Ah, sikur t'i isha hapur, të paktën Desit», thashë me vete. Fundja, ajo nuk më kishte kërkuar asgjë, s'më kishte thënë që unë të mos prishja «radhën». Këtë e thoshin nëna dhe babai...

Po Desi kaloi dhe nuk na pa. Ajo nuk e ktheu kokën fare nga dritarja e kafes. Provova një kënaqësi të madhe. Po kjo kënaqësi nuk zgjati shumë dhe më erdhi shumë keq për Desin, për motrën time të mirë; m'u duk vetja fajtorë që nuk i kisha treguar të vërtetën. Befas më shkrepri në kokë një mendim dhe u ngrita. Genci në fillim më vështroi i habitur, pastaj sikur e kuptoi... Dola me vrap te dera dhe thirra:

— Desi! Desi!

Ajo ktheu kokën, më pa dhe më buzëqeshi. Ia bëra me dorë që të vinte. Desi, ndonëse pak e habitur, erdhi... U futëm bashkë në lokal dhe u ulëm pranë Gencit.

Ç'prisja unë dhe ç'ndodhi!

Në fytyrën e saj çeli lule gëzimi. Dhe e kuptova që ajo nuk e kishte humbur as freskinë, as bukurinë...

«HAJDE, MBATHJANI!...»

Nipi i bajraktarit Qenan Zolluri, Setki Selushi, së bashku me tre burra të tjerë, trokiti një mëngjes dimri në derën e fshatarit Murat Marsianati. Murati u ngrit dhe hapi derën. Në hajat katër burra me nga një dogra në krahë dhe me nga një kobure në brez.

Setki shkundi dëborën që i kishte mbetur në çorapet dhe tirqet e lështa, që i ishte bërë si rrodhe, dhe u fut në odën ku u priu i zoti i shtëpisë. Oda ishte me dysheme prej dheu; ajo mbulohej nga një mutaf i madh, që linte të dukej vetëm vatra. Dera e dhomës ishte prej dru pishe, në të cilën ishin skalitur ca kafshë të vogla, që s'kuptohej mirë ç'ishin. Oda kishte dy dritare të vogla, që vështronin të dyja nga lindja. Në mes të dy dritareve, në mur, ishte një dollap dykanatësh, edhe ky prej dru pishe, ku viheshin re ca zbukurime me motive të ndyrshme. Në të dyja anët e oxhakut ishin dy dollapë të vegjël, si dy zgavra të thella, pa kapakë. Njëri prej tyre ishte bosh, kurse në tjetrin ishin vënë një tabaka bakri, plot me filxhanë si dhe një ibrik i vogël Stambolli, krejt i verdhë. Dhoma tregonte varfëri por edhe pastërti...

Në njërën anë të oxhakut zuri vend i zoti i shtëpisë, kurse në anën tjetër u ul Setkiu. Tre të tjerët zunë vend poshtë Setkiut. Ai që vinte menjëherë pas tij, ishte një korrozi i gjatë, hundëmadh, me sy të mëdhenj, e të kuq, që i kishin kërcyer nga zgavrat, sikur nga çasti në çast do t'i binin përdhe.

Setkiu qëndronte hijerëndë në krye të vendit, i veshur me tirq dhe koparanë nga ajo qashna e mirë, ngjyer jo tamam në të zezë, po me bojë arre. Në mes kishte ngjeshur një brez të punuar me fije teli të verdhë, që shkëlqente midis fijeve të perit. Xhamadanin prej qashne e kishte po nga ajo ngjyrë, si tirqit dhe koparanën. Qostekun e sahatit e kishte lënë t'i tundej si ato torljuçkat e fëmijëve, që lëkundën në drunjte e ftonjve nëpër oborre. Mustaqet e gjata, që i shkonin gjer te veshi, i ishin veshur me një cipë të hollë akulli, që filloi të lotonte nga zjarri i fortë në vatër.

— Dimër i madh, — tha Murati, sikur nuk po gjente fjalë tjetër.

— Po, — tha Setkiu.

Biseda nuk shkoi më tej. Fjala midis këtyre burrave ngjante me një send të rëndë, të cilin e shtyn sa e shtyn dhe prapë ngec në vend... Murati e kuptonte qëllimin e kësaj vizite, por bënte sikur nuk dinte asgjë... Hodhi edhe ca dru në zjarr dhe i dha Setkiut kutinë e duhanit që ta ndizte. Pastaj mori ibrikun dhe, pasin e mbushi me ujë, e vuri në zjarr.

— Zjarrin po na e ndez, po muhabetin jo, — i tha Setkiu të zotit të shtëpisë.

— Është dimër dhe muhabeti nuk bëhet pa zjarr, — tha Murati.

— Gojën ma ke brisk, po mendjen të keqe...

— Atëherë përse e turbullon mendjen tënde me timen?! Të mbajë secili të vetën...

— Duhet turbulluar që të qartësohet, o Murat, — foli me nënkuptime tjetri...

Atë ditë Murati, së bashku me të bijën, Sadeten, po mbledhnin barin në livadh. Setkiu zbriti tatëpjetë kodrës, hipur mbi gjokun e bardhë. Sadetja sapo kishte mbushur të shtatëmbëdhjetat. Ajo po i zbulonte huret një nga një, si pranvera që nuk i çel të gjitha lulët përnjëherësh. Kishte veshur një fustan, basme me lule dhe një bluzë të bardhë, që i vinte pak e ngushtë. Flokët e gjatë i vareshin supeve si ujëvarë. Vetullat i kishte të dendura e të zeza, sytë të mëdhenj e të pastër, hundën pak majuce dhe faqet të kuqe e me pak push, si ai i pjeshkës së pjekur. Goja e vogël dhe buza e poshtme pak e fryrë, në ngjynë të vishnjës së pjekur, dhe mjekëra e rrumbullakët ia shtonin hijeshinë.

Ca nga puna dhe ca nga vapa, ajo ishte shkukur më tepër se zakonisht dhe fytyra i ishte mbulluar me ca bula të vogla djerse, që merrnin nga rrezet e diellit një shkëlqim të qelibartë.

Setkiu i zbriti kalit dhe e la të kulloste në një kënd të livadhit. U ul nën hijen e kajsisë dhe i tha edhe Muratit të pushonte pak, sa të ndiznin nga një duhan... Murati la sfurkun e u nis pa qejf. Po të mos shkonte, do të dukej sikur i trembej. U ul pranë tij dhe shkëmbyen kutitë e duhanit.

— Kam gjithë këtë punë sot, — tha Murati, që tjetri të kuptonte se nuk ia kishte ngenë.

— E mo, se e mbledh Sadetja barin, — ia ktheu Setkiu.

Sadetja, kur dëgjoi emrin e vet, ndjeu mornica në trup.

— T'u rrit vajza, — i tha Setkiu.

— U rrit...

— U bë për martesë...

— Është e re për martesë, — tha Murati dhe i hodhi një shikim të vëngërt.

Po pinin cigaret në heshtje. Setkiu seq bluante në mendje. Në ballin e tij qenë formuar dy rrudha të thella...

— Unë dua të martohem, — tha papritur Setkiu dhe Murati u drodh nga këto fjalë. Ato që do të vinin pas tyre ai tani pothuaj i merrte me mend...

— Martohu. Një burrë i ve në moshën tënde, edhe mund të martohet. Unë, për veten time, ja, në këtë moshë që je ti tani mbeta i ve, por nuk u martova, — i tha Murati dhe e hetoi se ç'përshlytje do t'i bënin ato fjalë. Po Setkiu dukej sikur nuk e kishte dëgjuar fare.

— Dua Sadeten për grua, — tha Setkiu.

— Nuk është për ty Sadetja, — ia priti Murati pa u menduar fare.

— Përse nuk qenka për mua?!

— As nga mosha, as nga sëra nuk është për ty...

— Për nga mosha, burri plak shtatë gra, për nga sëra, unë po zbres poshtë dhe ti po ngjitesh lart.

— Unë nuk dua të ngjitem lart, Setki. Jam mirë këtu ku jam.

— Përse?!

— ... Se më merren mendtë dhe rrëzohem, nuk jam mësuar nëpër lartësi, — i tha me ironi Murati.

— Mos më bëj dredha, o Murat. Ta kesh për nder të bësh mik nipin e Qenan Zollurit.

— Këtë nder nuk e kam dashur kurrë.

Tani Setkiut filluan t'i dridheshin mustaqet nga zemërimi. Pështyu cigaren që mbante në gojë dhe tha:

— Sadetja do të bëhet imja. Kështu... ti i do drutë për sobë, — turfulloj ai.

— Soba ime nuk i nxë ato dru, — iu përgjigj Murati.

— I do më të shkurtra ti, ë?

Po.

— Sadetja, o bëhet gruaja ime, o toka do të përmbysët. Ja jep tjetërkujt, por ka për të të fluturuar kaptina. Mendohu e mos luaj me këmbën tënde.

— Ja, kaqata bësh dhëmbin, s'ke për ta marrë, — i tha atij Murati, duke i treguar gishtin e madh të dorës.

Setkiu i hipi kalit e ngau revan tatëpjetë...

— Ta ndajmë llafin një herë, pastaj pimë kafën, — i tha Setkiu, duke ia bërë me dorë Muratit që ta hiqte ibrikun nga zjarri.

— Ç'llaf të ndajmë?! — pyeti Murati.

— Sikur nuk e di... Llafin për Sadeten. Ke pasur gjashtë muaj për t'u menduar...

— Këtë llaf ta ndava që atëherë, — i tha Murati.

— Po nuk e ke ndarë mirë, — u ankua Setkiu.

— Mirë a keq, unë e ndava. Sadeten e fejova...

— E fejrove?! Me kë? — pyeti i alarmuar Setkiu dhe u ngrit në gjunjë.

— Ia kam dhënë Kron Vasit për të birin, — tha Murati, pa e prishur fare terezinë.

Setkiu lëmoi pendët e mustaqeve dhe buzëqeshi paksa. Ai sikur u lehtësua nga një barrë e rëndë.

— Kujtova se e ke dhënë më ndonjë derë të madhe, o Murat. Një njeriu si Kron Vasi mund t'ia ndërrosh fjalën dhjetë herë në ditë. Atë hall ke ti? I thuaj që u bërë pishman dhe mbaroi puna. Kur ta marrë vesh se ma ke dhënë mua, s'do ta hapë gojën fare...

— Fjala e burrit, si pesha e gurit, o Setki. Fjala është si plumbi. Po doli nga goja, nuk kthehet më prapë...

— Setkiu ta peshon vajzën me flori, — ndërhyri korroziu, që nuk kishte folur gjer atëherë.

Murati i hodhi atij një shikim përbuzës.

— Meqë je shitur vetë me para, kujton se shiten të gjithë, — i tha Murati atij.

Korroziu zgurdulloi sytë dhe vuri dorën në kobure.

— E bën njërën ti. Ja të vret, ja ta h... e s'të nget, — u tall me të Murati.

— Ul duart, — i bërtiti korroziut Setkiu. —

— Gjej llafin, Murat, se do të pendohesh, — i tha ai pastaj Muratit.

— Të mos i bëjmë fjalët tërkuzë. Nga keni vënë thembrat, vini majat e këmbëve, — tha me zë të fortë Murati dhe u ngrit në këmbë i pari.

U ngrit dhe Setkiu me shokë. Ai ishte zverdhur; vuri dorën në kobure e u bë gati ta nxirrte.

— T'i derdh trutë mu në shtëpinë tënde, — tha i nxehur ai.

— Mos e nxirr, o Setki, se nuk je i zoti ta shkrepësh. Atëherë mos e fut më në brez, por në b.. — qeshi Murati, sikur nuk kishte ndodhur asgjë.

— Ke për të parë, ke për të parë se kush do ta marrë Sadeten, unë apo i biri i Kron Vasit, — tha Setkiu dhe doli me rrëmbim përjashta. Pas tij edhe të tjerët.

Murati u ul në krye të vendit dhe filloi të dridhte një cigare. Gishtërinjtë i dridheshin nga inati.

— E bija u fut brenda me lot në sy.

— Përse qan? — e pyeti i ati.

— I mora vesh të gjitha, — tha ajo përmes ngashërimeve.

— Mos qaj, mos qaj, i tha i pikëlluar Murati. — Nuk e kanë të gjatë këta qenër, jo, — shtoi ai pas pak.

Murati e dinte se Setkiu do të hakmerrej, por në ç'mënyrë, këtë nuk e gjente dot. Ishte dreharak i madh ai dhe mendja vetëm për keq i punonte. Kishte kohë që ishte futur në vathën e «Ballit» dhe flitej se së shpejti do të bëhej edhe komandant i një qete...

Muratit i ngazëllehej zemra kur mendonte se dhëndëri i tij, i biri i Kronit, ishte lidhur me partizanët. Vërtetë në mal akoma nuk kishte dalë, por ama për Partinë punonte.

Ai i hodhi një sy vajzës. Ajo e kuptoi se ç'do t'i thoshte i ati dhe u drodh e fërgëllloi si shelgu në ujë.

— Ruaj nderin, bijë, se mbase Setki qeni do që të të bëjë me turp... Mos dil vetëm nga pylli..

— Mos ki merak, baba. Unë vdes para se të turpërohem...

Murati e ledhatoi veç me shikim të bijën.

Edhe pse e paralajmëroi vajzën, ai nuk e hoqi kurrë kujdesin për të; nxori nga hatullat alltinë dhe e futi në brez. Le të dilte, po të donte Setkiu dhe t'ia prekte të bijën, ai do t'ia numëronte mu në lule të ballit...

Erdhi dhe dita e dasmës. Murati e vuri Sadeten në kalë dhe e nisi për te Kron Vasi. Nusen e shoqëronin krushqit. Ishin dymbëdhjetë burra: shtatë nga shtëpia e burrit dhe pesë nga e nuses. Zakoni nuk e thoshte që i ati ta çonte vetë të bijën te dhëndëri, po Murati e prishi këtë zakon. Futi alltinë në brez dhe, si hodhi xhaketën e vjetër kraheve, doli para të gjithëve... Njerëzit u habitën, por askush nuk e pyeti. «Mbase ngaqë e ka vajzë të vetme», menduan. Po Murati mendonte ndryshe...

Setkiu kishte kohë që nuk ndodhej në fshat. Shumë njerëz thoshin se ai ishte bërë vërtet komandant i një çete balliste dhe se luftonte diku larg, por kishte edhe nga ata që thoshin se e kishin parë dy net më parë në kodrat sipër fshatit. Dhe Muratit s'i mbushej mendja që ai ta kishte harruar Sadeten...

Kur krushqit kaluan te Leqet e Këqija, Setki Selushi u doli para me shtatë vetë, të gjithë të armatosur. Muratit menjëherë i shkoi dora te vendi ku kishte fshehur alltinë po shpejt e hoqi andej.

Setkiu, me atë qëndrim prej kapadaiu, vuri buzën në gaz, si për t'u thënë: «Vetëm mali me mal nuk takohen...»

— U takuam përsëri, — i tha ai Muratit.

— U takuam, — tha edhe Murati.

— Unë nuk të vrava atëherë në shtëpinë tënde,

se e dija që do të ndodhte kështu, — tha ai po me atë buzëqeshje plot ligësi.

Murati nuk foli. Ai sikur nuk e kishte mendjen fare në ato që thoshte Setkiu. Diçka po mendonte, apo po kujtonte...

— Ku ma çon nusen?! Unë nuk e kam shtëpinë këndeje, — i tha përsëri ai Muratit. — Po mirë, mirë, do ta mbaj nja dy net malit, pastaj shohim e bëjmë. Mbase ia çoj prapë të birit të Kron Vazit.

Murati ishte zverdhur, sa thoshe që nuk i kishte mbetur pikë gjaku në fytyrë. Ballistët kishin drejtuar pushkët nga krushqit dhe prisnin urdhër nga komandanti.

— Ku ma çon nusen? — pyeti prapë Setkiu për ta poshtëruar Muratin.

— E kam nisur për te burri i vetë, iu përgjigj me kërcënim Murati.

— Unë jam burri i burrave, o Murat. Unë, po të dua, ua marr burrave nuset nga dysheku dhe jo më nga kali...

— Epo, forca merr kalanë, o Setki, — tha Murati.

Krushqit u habitën me fjalët e tij.

— Pa na vrarë ne të gjithëve, nusen nuk ke për ta marrë, — iu drejtua i pari i krushqve Setkiut.

— Nuk kam punë me ty. Do të merrem vesh me Muratin. Po ti, po e pate të tepërt, edhe ta heq atë kaptinë, që ma paske me qoshe, — u tall Setkiu.

Setkiu shikonte herë «trimat» e tij, që rrinin gati për zjarr dhe herë-herë krushqit...

— Sot po më dukësh burrë i mençur, o Murat, — tha ai.

— Fundja, një burrë kisha për t'ia dhënë vajzës. Po të jenë të zotët krushqit, le të mos e japin... Unë as deri këtu nuk duhet të vija...

I pari i krushqve bëri përpara. Edhe Setkiu bëri një hap para e ia nguli vështrimin e tij zhbirues. Në këtë çast Murati nxori nga brezi alltinë dhe ia vuri mu në gjoks Setkiut.

— Mos luaj, se të bëra shoshë, — i tha.

Setkiut i iku gjaku nga fytyra.

— Jepu urdhër këtyre horrave të hedhin armët, ndryshe vajte në atë botë, — e urdhëroi Murati me gishtin në këmbëz.

Setkiu hetoi tiparet e tij dhe u bind se Murati do të shtinte mbi të.

— Hidhni pushkët, — i urdhëroi ai njerëzit e vet.

— Turp e faqe e zezë, Setki. Unë s'e dorëzoj pushkën i gjallë, — tha ai korroziu, që e kishte shoqëruar dikur te Murati.

— Hidh pushkën, gomar, — e shau atë me zë të ulët, por të egër Setkiu. Pas kësaj korroziu nuk kundërshtoi më. Pas tij pushkët i hodhën edhe të tjerët. Krushqit i rrëmbyen sakaq dhe shulet kërcitën.

Të çarmatosurit i vunë pas një shkëmbi të lartë.

— I vras unë me dorën time, Murat, — i tha njëri prej krushqve. — Donin të na turpëronin për së gjalli, — shtoi me urrejtje ai.

— Murat, mos na vrisni, u zhburrëruam tani. Si rrojmë, si vdesim, njëlloj është, — tha njëri nga lart e Setkiut.

— Ju burra s'keni qenë kurrë, — i tha me zë të egër Murati. Pastaj e urdhëroi Setkiun të dilte

nga radha e të shkonte në buzë të rrugës. Edhe ai zuri të lutej, po Murati i shkoi pranë dhe i shtyu me grykën e kobures, derisa e çoi buzë greminës.

— Deshe vajzën time, ë? — e pyeti Murati.

Setkiu nuk u përgjigj.

— Ja, merre, — i tha Murati dhe e qëlloi pesë herë.

Trupi pa jetë i Setkiut u lëkund e ra në greminë.

Pastaj ai u kthye nga robërit e tjerë e u thirri:

— Hajde, mbathjami!

FËSHFËRINTE PYLLI I MËSHTEKNAVE

Fjetorja jonë ishte ngritur në një rrafshinë, rrethuar me pisha. Pak nga e majta binte pylli laraman i mëshsteknave. Përpara fjetores kishim Liqenin e Zi, kurse nga e djathta kishim Liqenin e Luleve. Fjetorja nuk kishte dritare që të vështronte nga Liqeni i Zi, prandaj ne më të shumtën e mbanim derën hapur.

— Ore, sikur nuk keni derë në shtëpi ju, — na thoshte shpesh Elmazi.

— Derë kemi, po liqenin nuk e kemi në prapgun e derës, — ia ktheja unë.

— Liqeni është në punë të vet, ne në tonën, — thoshte Elmazi.

Po ne donim që nëpërmjet derës të shikonim edhe bukurinë e liqenit. Hahesha me fjalë një copë herë me Elmazin. Lamja, një djalosh i ri rreth njëzet e dy vjeç, nuk përzihej në këto «zënka». Ai kishte respekt të madh për Elmazin dhe nuk kishte qejf t'ia prishte, qoftë edhe për punë të derës, ndonëse ishte në një mendje me mua. Edhe Demiri nuk përzihej fare. Zakonisht, për derën që e linim hapur, ne fjaloseshim në pushimin e drekës.

Në këtë kohë ai shtrihej në krevat dhe ia këpuste gjumit.

— Derr ka qenë ai që s'ka lënë një dritare këndeje nga liqeni, — më tha mua një ditë Lamja.

— Kaq ia ka prerë, o Lame, — i thashë.

— Ka lënë tri dritare këndeje nga pylli dhe asnjë nga liqeni, — tha përsëri me mërzi ai.

Ai ishte vërtet i mërzitur dhe unë çuditesha se si kjo i shkaktohej ngaqë fjetorja nuk kishte një dritare nga liqeni.

— Fundja, kot i biem në qafë Elmazit, — thashë unë. — Ja, liqenin e kemi të këmbët. Dalim përjashta dhe rrimë e soditim tërë ditën e tërë natën...

— Kështu është, — tha Lamja. — Po kisha qejf që një dritare të vështronte nga liqeni. Atëherë unë do ta vija shtratin pranë dritares dhe, ashtu i shtrirë, nuk do t'ia ndaja sytë liqenit për orë të tëra! E ke vënë re, Sako? Liqeni i Zi duket shumë i bukur natën. Hëna ngjan sikur rri mbi kurorat e pishave, kurse yjet duken si prush dushku, derdhur mbi liqen. Fryn ërë e lehtë e faqja e liqenit dridhet...

— Po ti qenke poet, o Lame, — i thashë.

— Poet jo, por... — se ç'deshi të thoshte ai!

Në fjetore kishim tre shtretër. Ne ishim katër sharrëxhinj, por aty flinim tre: unë, Demiri dhe Lamja. Elmazi jetonte me gjithë familje në çadër, nja dy kilometra poshtë nesh. Ai kishte gruan dhe një vajzë rreth tetëmbëdhjetë vjeçe. Gruaja kishte qenë e sëmurë dhe mjekët i kishin rekomanduar klimë malore. Dhe Elmazi e solli për nja dy muaj...

Drekën ai e hante zakonisht me ne, të fjetorja; përtonte të shkonte deri në çadër, tek e

shoqja dhe e bija. Në mbrëmje na uronte natën e mirë dhe nisej.

Unë dhe Demiri kishim vite që punonim sharrëxhinj, kurse Elmazi këtë punë e kishte filluar që pas Çlirimit. Ne bënim trupa ahu për sharrën dhe furnizonim minierën me shtylla galerie. Në atë sektor duhej të ishin të paktën katër sharrëxhinj. Unë, Elmazi dhe Demiri e përballuam këtë punë me lodhje të madhe për një kohë të gjatë. Atëherë Lamja nuk kishte ardhur ende...

— Brenda javës do të na sjellin një punëtor të ri, — tha Elmazi, që kishte biseduar një ditë më parë me ata të drejtorisë.

— U rregullua më në fund dhe kjo punë, — thashë unë i kënaqur.

— Kushedi ç'njeri është. Sharrëxhi nuk bëhet dot çdo njeri, — nguli këmbë Demiri.

— Pse nuk u bëka? — pyeti Elmazi.

Ai e kishte shumë inat kur dikush shante njërin apo tjetrin. Tani po përpiqej të merrte në mbrojtje sharrëxhiun e ri, që akoma nuk kishte ardhur dhe ne nuk e njihnim fare.

— Nuk bën çdo njeri për sharrëxhi, — nisi prapë Demiri. — Druri i do shpatullat sa dera e krahët si shtylla galerie. Një krahëkrande nuk mund të bëhet kurrë sharrëxhi. Pse, sharrëxhi e quan ti Vasil Palon? Ma ka krahun më të hollë se bishti i sëpatës dhe do të presë trungun e ahut...

Demiri fliste për një sharrëxhi të sektorit të parë.

— Njeriu, po e deshi punën, bëhet i zoti i saj, — tha Elmazi.

Pas një jave, kur mua më kishte zënë gjumi mbi shtrat, më zgjoi Demiri e më tha: «Zgjohu,

Sako, dhe shiko sharrëxhinë e ri që na ka ardhur». Unë hapa sytë dhe i fërkova me duar. Në fillim pashë vetëm fytyrën e kuqe dhe qafën e trashë të Demirit, pastaj punëtorin e ri.

— Më quajnë Lame Seferi, — na tha ai.

U ngrita, i dhashë dorën dhe e pyeta për shëndetin e për familjen. Demiri ishte në qejf të madh, sepse Lamja ishte djalë i ri e shpatullgjerrë. Nën këmbëshën e hollë, i shquheshin krahët e tij muskulozë. Kur Lamja doli jashtë nga fjetorja, midis nesh u zhvillua kjo bisedë:

— Ja, ky e bën normën, — tha për Lamen Demiri.

— Atje ku të tregojnë vreshtin e madh, merr shportën e vogël, — tha Elmazi.

— Pse? — pyeti Demiri.

Demirit i pëlqeu Lamja dhe nuk i erdhi mirë kur Elmazi nuk pati besim. Ai kësaj here po dilte kundër natyrës së vet. Për këtë u çudita edhe unë.

— Mbase nuk ka kapur kurrë sëpatë me dorë. Nuk them se nuk bëhet, por do kohë. Ti kujton se do të ta bëjë normën që ditën e parë. Mos e shiko nga trupi ti, — iu drejtua Elmazi Demirit.

Demiri nuk foli, po dukej që nuk ishte i një mendjeje me Elmazin. Po, kur shkua në punë, doli ashtu siç tha Elmazi: Lamja jo vetëm që nuk bënte dot punë, por duhej ta ruaje që të mos pritej me sëpatë, kaq prapë i vente... Ai nuk ishte në gjendje të krasiste një ah të rrëzuar e jo më të bënte punë tjetër. Por, si kaloi një muaj, ai ia mori dorën dhe atëherë kishe qejf ta shikoje duke punuar.

Ja, tani ai rri te pragu i derës, ulur në

shkallët e drunjta dhe nuk ia ndan sytë liqenit. Demiri fle, kurse Elmazi po bën drekën.

— U thuaj të na sjellin domate, o Elmaz, të bëjmë ndonjë sallatë, — tha Demiri.

— Do të sjellin edhe domate, po është rrugë e gjatë, — iu përgjigj tjetri.

Lamja hëngri drekë i pari dhe doli përjashta. Sytë ia kishte ngulur, si zakonisht, Liqenit të Zi. Këtë liqen ai e donte shumë, kurse për Liqenin e Luleve thoshte se ishte një kënetë e vogël dhe asgjë më shumë. Në fillim ky mendim m'u duk hiçgjë, por, kur një ditë te Liqeni i Luleve pashë bretkosa, i dhashë të drejtë. Ia thashë edhe atij. «Të kam thënë unë», tha. Në ato çaste rrinim në bregun e Liqenit të Zi. Valët e tij u trazuan lehtë. Pamë një gjarpër të hollë e të gjatë që notonte duke e mbajtur lart kokën trekëndëshe. U drodha. I thashë Lames se edhe Liqeni i Zi nuk ishte gjë, përdërisa në të kishte gjarpërinj... «Atëherë, sipas teje, nuk është gjë as deti, që ka një botë të tërë nënujore», tha ai.

Hëngra drekë edhe unë e shkova u ula pranë Lames.

— Po mërzitësh? — e pyeta.

— Kam mbetur pa libra. Unë nuk rri dot pa ta...

— Pse nuk more kur erdhe?

— Nuk dija se si do të më shkonte puna. Kujtoja se nuk do të kisha kohë për të lexuar, — tha ai.

Pak gjëra dija për të dhe mua m'u duk se ishte një rast i mirë për të mësuar më tepër.

— Sa shkollë ke, o Lame?

— Kam dy të mesme, Sako. Vazhdoj të tretën ekonomike.

— Po ti genke shkollar, o derëbardhë, — i thashë.

Lamja qeshi. Kur qeshte, dukej edhe më i pashëm se ç'ishte. Mua më kanë pëlqyer gjithmonë njerëzit që zbukurohen kur qeshin. Ata e kanë bukurinë te sytë.

Elmazi, si duket, kishte dëgjuar diçka nga biseda jonë.

— Libra të sjell unë, o Lame. Për këtë mos u bëj merak, — tha ai.

Unë ngrita supet i habitur dhe qesha. S'e mbaja mend që Elmazi të kishte biseduar ndonjëherë për libra dhe jo më të lexonte. Ai veç gazetën e lexonte nga kreu gjer në fund. E kuptoi se pse po çuditesha unë dhe më tha:

— Ka vajza, libra, o Sako, jo unë. Ka mbarruar gjimnazin ajo dhe lexon kiamet.

Ja qepa sytë dhe nuk di pse e pyeta veten se si do të ishte vajza e tij për nga bukuria... Elmazi vetë kishte një kokë tullace, vetulla dhe qerpikë si të përcëlluar....

Atë ditë punuam edhe pasdite deri vonë. Në fjetore u kthyem kur hëna kishte dalë e tërë pylli ishte veshur me një dritë të verdhë që të ngjallte një trishtim të lehtë. Po ktheheshim që të katërt të lodhur, por të gëzuar. Kur shkuam te shtegu i pyllit të vogël me mështekna, Elmazi na uroi natën e mirë dhe u nis për te çadra. Ai largohej me hapat e rëndë e të ngadaltë. Gjethet e verdha dhe krundet e thata kërcitnin nën hapat e tij.

— More, si nuk i bëmë një vizitë Elmazit në shtëpi, — tha Demiri.

— Të lumtë goja, Demir. Mirë po mendon, — thashë unë.

— Ta kesh familjen e shokut dy hapa larg dhe të mos shkosh, kjo sikur nuk shkon, apo jo? — na pyeti Demiri.

— Të shkojmë një ditë. Do t'i bëhet qejfi dhe atij, — thashë unë.

Lamja nuk foli, por edhe ai ishte në një mendje me ne. Demiri nxitoi të na pregatiste darkën, kurse ne të dy po ecnim ngadalë.

Mështeknat laramane reflektonin dritën e verdhë të hënës. Në pyll kishte një përzierje dritash dhe hijesh që të çlodhnin. Kundërmimi i luleve sikur na e zgjeronte kraharorin. U ndodhëm para një sheshi të gjerë, midis pyllit me mështekna dhe pyllit të pishave. Hëna copëtohej midis degëve të pishave dhe drita e saj sikur kullonte nga lart. Lëndina ishte e mbuluar me lule të bardha.

— Këto lule, — i thashë Lames, — kanë erë shumë të mirë.

Ai këputi disa prej tyre dhe u mori erë.

— Edhe kështu, të këputura, këto rrojnë gjatë. Mjafton t'i futësh në një kavanoz me ujë.

— Kështu do të bëj, — tha ai.

Pylli i pishave binte erë rrëshirë. S'ka sharrëxhi që të mos i pëlqejë era e rrëshirës. Ne dredhuam rrugën dhe u futëm në mes të pyllit me pisha. Ndjenim lagështinë e vesës, po kjo sikur na filladiste. Tani hëna dukej sikur kërcente nëpër kurorët e pishave.

— Po këto? — pyeti Lamja për disa pisha të thara.

— Janë goditur nga rrufetë, — i thashë.

Lamja sikur u drodh. I shkoi një e rrëqethur në trup.

— Ç'pate? — e pyeta.

— Vdekja e pishave... këto, edhe të vdekura, rrinë më këmbë, — tha ai.

Ajo që tha Lamja, mua nuk më kishte shkuar kurrë në mend. Tani vërtet m'u duk e çuditshme se si qëndronin «më këmbë» pishat e thara.

— Pishat gjithmonë janë në luftë me rrufetë, — i thashë.

— Pishat nuk kanë si të luftojnë... këto janë të ngujuara, — tha ai.

— Jo, Lame, jo, — kundërshtova unë. — Shikojë atë pishë.

Para nesh ishte një pishë e lartë, mbase më e larta e të gjithave. Kishte një kurorë të dendur e të gjerë. Nga kurora gjër në tokë pisha kishte një të çarë të thellë, të zezë, si një e prerë shpate.

— Ja, — fillova t'i shpjegoja, — rrufeja e ka goditur, por nuk e ka mposhtur dot. Ajo e ka shëruar plagën e rëndë me gjakun e vet.

— Gjakun e vet?! — më pa i habitur ai.

— Gjaku i pishës është rrëshira. Pisha i shëron plagët me rrëshirë.

Në fjetore shkuam shumë vonë. Demiri na vuri para gotat me çaj, djathë dhe makarona. Sa mbaruam së ngrëni, ramë të flinim. Fikëm dritën, po gjumë nuk kishim. Flas për veten dhe për Lamenë se Demiri menjëherë filloi të gërhinte.

— Si nuk kanë bërë një dritare nga liqeni, — tha si përherë Lamja.

— Do ta hap unë nesër, po fli tani, — i thashë duke qeshur.

— Nuk kanë gjumë.

— As unë...

— Ja, po të ishte dritarja, kundroje liqenin dhe

të zinte gjumi ëmbël... Lëre këtë, po as pyllin e mështeknave nuk e shohim... Eh, ç'bukuri të rrallë që ka edhe ai...

Më në fund gjumi na zuri. Bëmë një gjumë të ëmbël duke thithur erë rrëshire dhe erëra lulësh.

Të nesërmen u ngritëm herët. Qielli ishte i kthjellët dhe yjet dukeshin të bardhë e si të përgjumur. Ecnim nëpër një udhë këmbësore njëri pas tjetrit. Demiri ia kishte marrë një kënge të lashtë, me një zë të zvargur, të trashë dhe disi të ngjirur. Nuk mund të thoshe se këndonte bukur, por kishte diçka të ngrohtë dhe jetësore në këngën e tij.

Poshtë, në luginë, u dëgjua një e goditur sëpate. Vumë veshin të tre.

— Elmazi, Ç'njeri është! — tha Demiri. — E ka filluar punën me natë.

Shkuam pas goditjes së sëpatës dhe e gjetëm Elmazin duke krasitur trungun e një ahu. Punonte vetëm në kanotierë, ndonëse ishte shumë freskët. Filluam edhe ne punën, te trungjet e tjera që i kishim lënë që nga dita e djeshme. Kur punonim, nuk bënim fjalë fare, me përjashtim të ndonjë rasti të rrallë. Kjo ishte dëshira e Elmazit dhe më vonë u bë edhe jona. Lamja vërshëllente një melodi, që herë pas here ndërpritej nga një «ah» që dilte nga gjoksi i tij, sa herë godiste trungun. Shikoja shpatullat e gjera, krahët e gjatë, e të fuqishëm, trupin e derdhur të tij dhe ndieja një dashuri të madhe për të. Punonte dhe nuk dinte ç'ishte lodhja, po ama atë melodinë nuk rrinte kurrë pa e vërshëllyer, sado që Elmazi i thoshte se e lodhte njëlloj sikur të fliste a të këndonte. «Ajo

më ndihmon në punë dhe nuk më lodh», thoshte Lamja. Po njerëz si Elmazi këtë nuk mund ta kuptonin.

Si vajti ora nëntë, u ulëm për të ngrënë mëngjesin. Si gjithmonë, hapëm një gazetë në shesh dhe nxorëm ato që kishim marrë. Elmazi përherë e mbështillte bukën me një shami të verdhë.

— Qenka si e fryrë shamia sot, — i tha Demiri.

Lamja qeshi si me turp dhe nuk ia ndante sytë shamisë së Elmazit.

— Petulla. I ka bërë gruaja. Hani, po mos më shani, se prishemi bashkë, — bëri shaka Elmazi.

— Qenkan të mrekullueshme, — tha Demiri, që e mori i pari një.

Morëm edhe unë e Lamja.

— Hë, të pëlqejnë, o çun? — e pyeti Demiri Lamën.

Lamja qeshi. Sa herë qeshte, në të dyja faqet i formoheshin dy gropëza të vogla, që e tregonin fare të ri. Flokët i ndante me vijë nga e majta dhe në të dyja anët e asaj vije dallgëzoreshin kaçurrelat ngjyrë-gruri. Një kaçurrel i rrinte përherë mbi ballë, si një pikëpyetje kokëposhtë.

— Lum ajo nuse që do të të marrë ty, o Lamë. Gjithë ky katalla, rri pa za, — u tall me të Demiri.

Lamja prapë qeshi dhe u skuq. Sa herë që binte fjala për martesë, për vajza, Lamja skuqej. Kur mbaruam mëngjesin, pamë se disa re ishin mbledhur e sikur rrinin mbi kurorat e pishave, kaq poshtë kishin zbritur. Po erë nuk frynte fare. Në pyll pothuaj kishin pushuar të gjitha zhurmat e zërat dhe ne që kishim vite që punonim në pyll, e dinim se kjo ishte qetësia para shtrëngatës.

— Do të ketë shi, jo shtrëngatë, — tha Demiri.

Pas gjysmë ore vërtet filloi shiu, një shi i imët, i ngadaltë. Kur bie shi, në pyll jo vetëm që nuk punohet, por edhe rrezikohesh nga rrufetë.

— Shkojmë në fjetore, — tha Demiri. — U pa puna për sot...

U nisëm lart bregores nga kishim zbritur.

— Kemi më afër çadrën time, — tha Elmazi.

— Rrimë aty ca, pastaj ngrihemi e fillojmë punën. Ja, këtu pranë e kemi, tha ai për çadrën dhe bëri pesë-gjashtë hapa nga e majta e hipi në një stom. Hipëm edhe unë e Demiri. Që andej çadra dukej sikur ishte vërtet fare pranë.

— Ne duhej të vinim më parë, o Elmaz, dhe jo tani që po na zë shiu, — tha Demiri.

Po Elmazi nuk i vinte re këto gjëra.

— Epo, punë e madhe. Ja, rasti e solli, — tha ai dhe u nis i pari.

Shiu ishte i ngadaltë, por këmbëngulës. Ashtu siç e kishte nisur, shtruar-shtruar, zor se do të pushonte, gjer në mbrëmje. Filluan gjënimet dhe rrufetë.

— Ja, këtë armik kanë pishat, o Lame, — thashë unë.

Ai nuk foli, por shikoi me dhembshuri një pishë që mori flakë jo shumë hapa larg nesh. Në fillim flaka ishte si e kuqe, pastaj u bë e verdhë.

— Nuk e kisha parë një gjë të tillë. Qenka e tmerrshme, — tha Lamja.

— Vish xhaketën. Po qullesh vetë dhe të vjen keq për pishat, — i tha Demiri atij.

Lamja akoma e mbante xhaketën në dorë dhe kishte harruar ta hidhte krahëve, si kishim bërë ne. Ai e shikoi Demirin në sy, por nuk ia mori

për ters fjalët që i tha Ai e dinte se edhe Demirit, edhe mua, edhe Elmazit, na vinte keq për pyllin që digjej. Nuk ka sharrëzhi që të mos e dojë pyllin dhe të mos i vijë keq për të!

Në çadrën e Elmazit mbërritëm pas një ore. Ishim bërë qull. E shoqja e Elmazit i ruante akoma gjurmët e bukurisë. Edhe e bija asaj i kishte ngjarrë.

— Na falni që erdhëm kështu papritur dhe të lagur, — tha Demiri!

— U, ç'është kjo? Jeni si në shtëpinë tuaj, — tha gruaja.

Në çadër ishte ngrohtë dhe ne i hoqëm xhaketat.

— Xhemile, na e ndiz furnelën, — i tha së shoqes Elmazi.

Xhemilja e vuri furnelën në një dërrasë pranë nesh.

— Nuk bën tym, e kemi me alkool, — tha ajo.

Na pyeti duke na u drejtuar të gjithëve me emër. Na erdhi mirë dhe na u duk se në atë familje kishim qenë prej kohësh. Vajza quhej Drita dhe dritë e hënë ishte. Kishte një lëkurë të pastër, të bardhë, sy të kaltër si ujët e Liqenit të Zi, qerpike të gjatë si halat e pishave. Ishte truplartë dhe e drejtë si një pishë. Nuk di përse më vjen të krahasoj me një pishë. Se si më shkuan sytë të Lamja dhe pashë që ai e vështronte në sy vajzën. Një vështrim të tillë kurrë nuk ia kisha parë! Drita nuk kishte si mos të të bënte përshtypje, ajo kishte një bukuri, që nuk mund të mos e vije re. Po, ama, as Lamja ynë nuk kishte të sharë. Vura re se edhe vajza ia hodhi sytë shkarazi atij. Po natyrisht kjo nuk do të thoshte asgjë...

— Po ju bëj nga një kafe, — tha Xhemilja.
— Na bëj nga një çaj njohëre. Për çaj kemi
nevojë më shumë, pastaj shohim e bëjmë, — tha
Elmazi.

Çaji ka ngrohu e na bëri mirë vërtet. Shkëmbja
Lamen. Kaçurreli i verdhë si pikëpyetje i ashpër
si gjithmonë mbli ballë.

— Ndize edhe ti, Lame, — i tha Elmazi, duke
i vënë përpara kutinë e duhanit.

— Nuk e pi, — tha ai, si i turpëruar. — Ti e
di.

— Nuk di të dredhësh cigaren, këtë thuaj,
i tha Demiri, të cilët sepse i kishte hapur një
dëshirë për ta ngacmuar.

Lamja qeshi me turp dhe e ktheu kutinë e
duhanit pa e hapur.

— E kemi të urtë, si dële, — tha Elmazi për
Lamen duke parë Xhemilen dhe të bijën.

Lamja u turbullua dhe Xhemilja që e vuuri re,
me marifet e ndërroi bisedën:

— Tani po ju bëj kafën.

— Lëre kafën, Bjer rakinë. O është ditë për
raki kjo e sotmja, a s'ka ditë tjetër.

— Mos na turbullo me raki, o Elmaz, se na lë
pa punë. Ja, shiu sikur po pushon, — tha Demiri,
ndonëse qeji ia donte atë të shkretë raki.

— Po, po, kështu është, — thashë edhe unë.

Shiu nuk kishte pushuar, blinte i dendur, por
tashmë jo me atë rrëmetin e fillimit.

— Ky shi nuk ka të pushuar. Kurrë s'hton
kështu, mos prit të pushojë, — tha Elmazi.

— Mirë e ka Elmazi. Tani po vjen edhe dre-
ka, — shtoi Xhemilja dhe solli shishën e rakisë.
U vunë pastaj gotat, pjatat me meze.

— Epo, mirë se na erdhët. Gëzuar! — tha Elmazi, duke ngritur gotën e vet. Ngritëm edhe ne gotat.

— Tani, o pimë të gjithë, ose asnjë. Merrni edhe ju nga një gotë, — u tha Demiri Xhemiles e Dritës.

— Unë nuk e pi, por s'dua t'jua prish, — tha Xhemilja dhe u ngrit të merrte gotat.

Vajza qeshi e turpëruar dhe pa nga i ati.

— Edhe unë?

— Edhe ti, posi. Nuk duhet t'ua prishim miqve, — qeshi Elmazi.

U mbushën të gjashtë gotat.

— Gëzim paç, o Elmaz Shkoza, dhe për të mirë të ardhshim përherë, — tha Demiri, duke kthyer gotën e vet me fund.

— Gëzim paçi! Ju lumshin këmbët! — uroi dhe Elmazi.

Demiri, duke ndier atë ngrohtësi familjare, erdhi në qejf shumë shpejt dhe filloi t'i ngrinte gotat njëra pas tjetrës.

— Gëzuar! Në dasmë të Dritës! — uroi ai sërisht dhe e ngriti gotën prapë me fund.

Vajza u skuq, fytyra e saj u mbulua me një purpur të lehtë, që të kujtonte lulet e pjeshkës, kur çelin në pranverë. I uli sytë e turpëruar dhe, kur i ngriti, vështrimi i saj u ndesh me atë të Lames.

— Edhe në dasmë të djemve të tu, — brofi Elmazi i gëzuar, duke e tharë edhe ai gotën.

— More, je burrë apo ç'je ti? — iu drejtua Demiri Lames. — Ke një orë që më rri me një gotë përpara. Edhe helm të kishte qenë, ta kishe pirë...

— Lëre djaln të pijë sipas qejfit, — thashë unë.

Po merrte vesh Demiri?...

— Jô, mor, ta lë?! Edhe ulet me burra dhe nuk do të pijë... Hajde, ngrije me Dritën, se më të je baras. Veç Drita dhe ti, — i tha Lamës, — nuk keni pirë akoma gotën e parë.

— Ngrijini, ngrijini, — i nxitëm edhe në.

— Gëzuar! — tha Lamja dhe toku gotën me të vajzës.

— Gëzuar, Lamë! — tha ajo.

Dhe vështrimet e të dyve u takuan. Një dritë e ëmbël buronte nga sytë e tyre, një dehje e ëmbël, që nuk vinte nga rakia...

Padreke, vonë, u nisëm për në fjetore. Një copë rrugë na përcolli dhe Elmazi me të shoqen dhe vajzën. Shiu kishte pushuar dhe kishte dalë dielli. Në qiell vraponin ca re të bardha. Nga gjethet e drurëve binin pika të mëdha uji, duke krijuar përshtypjen sikur shiu vazhdon të binte. Ecnim të ndarë në dy grupe. Në të tjerët pak para, kurse Lamja dhe Drita pas nesh. Ata bisëdonin për librat, bisëdë e lënë përgjysmë qysh nga dreka. Tani ecnin pranë njëri-tjetrit dhe çuçuritnin aq ëmbël... Kaçurreli si pikëpyetje hidhte vallonë i gëzuar mbi ballin e bukur të Lamës dhe dy gropëzat e vogla nuk i hiqeshin fare nga faqet... Drita qeshte disi më e përmbajtur duke zbuluar ca dhëmbë të bardhë e të rregullt. Në pyllin e vogël me mështekna kishte rënë ylberi.

— Kurrë nuk kam parë ylber në pyll. Sa i bukur u dukërka! — u entuziazmua Drita.

— I bukur! Shiko si duket edhe lëkura e mështeknave, — tha i mahnitur Lamja.

— Sa po më pëlqen ky pylli i mështeknave, — tha ajo. — Do të më vinte keq, sikur të kisha ikur pa e parë...

— Kaloje ylberin të bëhesh djalë, — e ngacmoi Lamja.

— Mirë jam vajzë. Pse, të pëlqen ty Lame të bëhem djalë?

Pyetja e saj ishte hetuese dhe kishte brenda një farë dinakërie. Po Lamja nuk foli.

— Pse nuk flet?

— Do të të kisha shok të ngushtë, — u përgjigj ai.

Vajza u drodh.

— Ne edhe kështu mund të jemi shokë, — i tha ajo.

— Sot e solli rasti të njihemi. Pas dy a tri javësh ti do të ikësh... nuk do të kujtohesh fare për mua, — tha Lamja.

Vura re se në faqet e tij qenë zhdukur ato gropëzat e vogla. Fytyrën ia kishte mbuluar një hije e lehtë trishtimi. Vajza u merakos, si Lamja... Ajo hapi kot librin që mbante në dorë.

— Tani ju mbetet juve të na bëni një vizitë, — i tha Demiri gruas së Elmazit kur u ndanë.

— Do të vijmë, — tha ajo.

Kur shkuam në fjetore, Lamen e pashë me libër në dorë. Ishte libri që i kishte dhënë Drita. Atë natë lexoi deri vonë, ndonëse ne i thoshim ta fikte dritën dhe të binte të flinte.

Që nga ajo ditë, aty afër drekës, ose në mbrëmje, Lamja sikur na vidhej dhe shkonte andej nga pylli i mështeknave. Tani rrinte ca më i mbyllur. Veç në punë ishte si gjithmonë, punonte sa për katër, pa ndier lodhje.

— Lame, ku ishe? — e pyeta një ditë.

Kishte mbaruar pushimi i drekës dhe pas pak do të fillonim përsëri punën.

— Ja, po lexoja matanë, — tha ai, duke bërë me dorë andej nga pylli i mështeknave.

— Pse, këtu afër nuk ke vend? Pastaj duhet të pushosh pak, të shtrihesh një çikë në drekë...

Ai nuk më foli, veç më shikoi në sy, më shikoi gjatë. Më atë shikim sikur më lutej të mos e ngisja më atë llaf.

Dy ditë më vonë, sapo hëngri drekë, mori librin dhe doli... Mua më ishin mbaruar cigaret dhe u nisa për në klubin e sektorit. Rruga për në klub kalonte ndanë pyllit me mështekna. Erja e s'ngopesha së pari bukuritë e tij. I dhashë të drejtë Lames që e donte aq shumë pyllin. Kur po futesha në pyllin me pisha, mbështetur pas një tringu, në këmbë, më zunë sytë Lamen. U bëra gati t'i thërrisja, por pak më tutje vura re Dritën, që vraponte drejt tij...

Qofshi të lumtur, pëshpërita me vete dhe mora rrugën tatëpjetë malit, pa e kthyer kokën. Pylli i mështeknave fëshfërinte...

«ALEATËT» DHE POPULLI

Batalioni kishte tri ditë dhe tri net që po marshonte për në Veri. Rruga ishte një e përpjetë midis shkëmbinjve të thepisur. Rriskat e gurëve përgjakeshin nga këmbët e zbathura të partizanëve; pjesa më e madhe e tyre i kishin këpucët pothuaj fare të grisura, kishte edhe nga ata që s'kishin fare këpucë.

Batalioni kishte dalë fitimtar në luftë me forcat e shumta gjermano-balliste në zonën e Korçës, çau me sulm të papërmbajtur në Pogradec dhe Elbasan, në Mat, në pyjet e Martaneshit dhe ja, tani ishte prapë në rrugë... Me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm ai duhej të kalonte për në Veri, ku pozitat e armikut ishin akoma të forta. Gjatë marshimit batalioni qe ndeshur pothuaj çdo ditë e çdo natë me armikun. Dhe ja tani marshonte në këta shkëmbinj. Rreth pesëqind metra poshtë rrugës ku ecnin, rridhte një lumë i vogël malor me ujë të pastër e të shkumëzuar. Lart, në të katër anët, nuk shihej gjë tjetër veçse male të zhveshura dhe një rrishtë e hollë qielli. Në atë vend nuk gjeje dot një copë gur të rrumbullakët e të lëmuar, ve-

çse copëra rriskash, që përgjakeshin nga këmbët e partizanëve.

Partizani më i vjetër i batalionit, Thoma Seri, u ndal paksa dhe zbathi këpucët, një palë këpucë të reja, që ia kishte marrë një gjermani të vrarë. Ishte i vetmi që kishte këpucë të reja.

— Pse i zbathe këpucët, Thoma? — e pyeti një partizan tjetër. — Apo ke qejf të provosh këta gurë si të «përkëdhelin».

— Po, Dino, dua t'i provoj edhe unë, — tha Thomai.

Pastaj ai i tregoi me kokë Rexhepi Selimin, një nga partizanët më të rinj të batalionit. Thomai nxitoi, doli pak përpara rreshtit dhe ia yuri dorën në sup shokut. Rexhepi ktheu kokën dhe u ndal.

— Ç'ke? — e pyeti ai.

Thomai i tregoi këpucët.

— Jo, — kundërshtoi tjetri, — Jam mësuar unë të eci zbathur. Po qe ashtu, jepja Servetit, ai nuk është mësuar...

Serveti ecte pak më përpara. Thoma Seri mbeti me këpucë në dorë dhe nuk dinte si të bënte. «Dreq o punë, edhe Serveti kështu si ky do të më thotë...», mendoi. Po Servetit ia la këpucët në dorë.

Kishin katër orë që ecnin pa pushuar as edhe disa minuta.

— Ja, tek ajo fusha atje do të ndalemi, — tha Dino Shqeri.

Thomai shprehu habinë.

— Kështu na tha komisari, — i shpjegoi Dinoja. — Më duket se aleatët do të na hedhin veshmbathje.

Thoma Seri nuk foli fare. Dukej që diçka bluante në kokë.

— Q'Bluan në atë mendjen tënde, o Thoma?

— Demek do të na hedhkan veshmbathje aleatët, ë? — pyeti Thomai.

— Po, të thashë një herë, — tha Dinoja.

— Edhe pula të pjekura do të na dërgojnë, ë? — u tall Thomai.

— Unë nuk thashë për pula, por për rroba dhe këpucë, — tha si i mërziur Dinoja. Pastaj ai e shikoi shokun në sy dhe nuk po e kuptonte se ku donte të dilte Thomai me ato pyetje pa kuptim.

Në Pashën e Vordit arritën aty afër drekës dhe batalioni u ul të pushonte. Tani fjala se aleatët do të dërgonin veshmbathje u përhap në tërë batalionin.

— Ty sikur nuk po të besohet, — i tha Dino Shqeri Thomait.

— Mbase, mbase... — tha tjetri në vend të përgjigjes.

— E thanë edhe komisarri, edhe komandanti. Prandaj edhe jemi ndalur këtu. Do të presim mbremjen, do të ndezim zjarre dhe do të vijnë aeroplanët...

— Demek me tajare, ë? Hajde, Dino, hajde, do të vijnë këpucët me tajare ty... — u tall Thomai.

— Ëndrra me sy hapur. Ja, ta thotë Thomai ty...

Kësaj radhe vërtetë Dinoja u habit nga mosbesimi i tij.

Në këto çaste pranë tyre po kalonin komandanti dhe komisarri. Ata seç po bisedonin me zë të ulët njëri me tjetrin.

— E pe komisarin? — e pyeti Thomai shokun.

— Po, e pashë, — tha Dinoja i habitur.

— E pra, ja ku po të thotë Thomai ty, se

edhe komisari nuk ka besim te ndihma e aleatëve. Ja, më prefshin në qafë mua, po besoi komisari. Ia pashë sytë unë... Edhe komandanti nuk beson. Ta thotë Thomai ty...

— Po batalioni për këtë është ndalur këtu. Ndryshe do të marshonim.

— Mirë, mirë. Kaq di dhe kaq flas unë. Plak njeri jam dhe pa shkollë, Moç ma vër veshin gjer në fund... Po zemrën e kam si lulja e mollës, ama... E di ti, Dino, një erë e lehtë që nuk lëviz as fijen më të hollë të barit, lulet e mollës i lëviz. Ma thotë zemra mua, o bir, se e kam si lulet e mollës...

Dino Shqeri psherëtiu. Edhe ai ra në mendime. Kishin kaluar rreth katër orë që po prisnin dhe partizanët filluan të mërzhiteshin. Ata nuk ishin mësuar të pushonin kaq gjatë, të rrinin kaq shumë në një vend, me sytë në qiell, në pritje të mbremjes dhe të aeroplanëve të huaj.

Dielli perëndoi dhe disa nga partizanët u derdhën në ca shkurre përreth për të mbledhur shkarpa të thata. Pas një ore u ndez një zjarr i madh, më vonë edhe një tjetër...

— E, e shikon? — i tha Dinoja Thomait.

Tjetri nuk foli, veç shikoi gjuhët e flakëve, që përdridheshin nga era e lehtë. Nuk kaloi veçse gjysmë ore nga ndezja e zjarreve, veç kur u ndie një uturimë.

— Aeroplanët... — thirrri dikush.

— Erdhën. — tha një tjetër.

Po aeroplanët nuk u panë. Në vend të tyre partizanët panë ca panashuta që binin në tokë, mi-dis shkurreve dhe ferrave.

Thomai nuk e prishi terezinë. Pinte duhan dhe heshte.

Malli që zbriti me parashutë u grumbullua në një vend. Ndonjë partizan, që shkante deri te vendi ku punonin intendentët, kthehej dhe u thoshte të tjerëve:

— Boll paskan sjellë, sa për t'u veshur e për t'u mbathur tërë batalioni.

I nxitur nga kureshtja, shkoi edhe Dino Shqeri për të parë. Nën dritën e hënës ai pa xhaketat dhe pantallonat, pa këpucët me qafa që të verbojnë me shkëlqimin e tyre. U kthye pranë Thoma Serit që pinte duhan në heshtje. Dinos i dukej se plakut i vinte keq që nuk i doli fjala...

— Ishin fringo të reja. Më plaçin sytë, në të gënjej, — i tha ai Thomait.

Thomai mbushi prapë llullën me duhan dhe nuk foli.

Mëngjesi erdhi... U dha urdhri për t'u rreshtuar batalioni. Më në fund kishin mbaruar orët e gjata të pritjes dhe të mërzisë. Partizanët do të merrnin ato që do t'u takonin dhe do të niseshin përsëri... Intendentët po afroheshin me thasët plot. Një mërmërimë gëzimi u ndie në radhët e partizanëve, po shpejt u fashit, kur vunë re se ata ishin të shqetësuar. Partizanët kishin parë në sytë e intendentëve një gëzim të patreguar, sa herë që u jepnin shokëve pak bukë, apo ndonjë plaçkë të ardhur nga populli. Ato ishin çastet më të lumtura për intendentët... Po tani ç'kishin që ishin ngrysur ashtu? U afruan edhe komisari e komandanti. Edhe ata ishin të shqetësuar.

Thasët u zbrazën para tërë batalionit.

Komisari kishte qëndruar pranë togut me rroba e këpucë. Të gjithë i ngulën sytë.

— Na gënjyen «aleatët», shokë... — filloi të fliste ai. — Do t'i shikoni vetë, se ç'mallra na kanë hedhur. Po ne nuk e kemi pasur ndonjëherë shpresën tek ata dhe as nuk do, ta kemi kurrë. Të zbathur e të zhveshur, pa bukë, në zheg dhe në të ftohtë, luftën do ta çojmë deri në fund, do të fitojmë dhe do ta ndërtojmë Shqipërinë e re. Atëherë do t'i kemi të gjitha dhe do t'u tregojmë nipërve dhe mbesave për poshtërsitë e këtyre palo «aleatëve»...

Komisari pushoi për disa çaste. Ai hetonte fytyrat e partizanëve.

— Le të dalin këtu Sherif Tertini dhe Palok Treni, — tha komisar.

Dy partizanët dolën para batalionit dhe në fillim askush nuk po kuptonte gjë. Sherifi ishte më i vogli, ai ishte pionier, kurse Paloka ishte partizani më truplartë në tërë batalionin. Tani diçka filluan të kuptojnë...

— Ja, shokë, — filloi të fliste përsëri komisar. — Veç për këta të dy mund të gjesh ndonjë palë rroba, kurse këpucë as për këta nuk gjen, se janë të gjitha të një këmbe...

— Nënë e nënës... — i shau «aleatët» Dino Shqeri.

— Të thashë unë, Dino, — i foli Thomai. — E di unë se ç'mall janë këta palo «aleatë». Si janë vetë, sjellin edhe mallin... Të gjitha këpuçët të një këmbe i sjellin, se të gjithë derrat një turri kanë...

Batalioni pas pak u nis përsëri për marshim. Ashtu si një ditë më parë, Thoma Seri ecte pranë Dino Shqerit.

— Ti sikur e dije, — nisi të fliste Dinoja, —
Mua, të them të drejtën, nuk më kishte shkuar kurrë
në mendje një poshtërsi e tillë. Ata mund të
mos i binin fare, po kështu...

— As unë nuk dija gjë, askush nuk dinte gjë...
Ma ndiente zemra, o Dino. Të thashë se e kam
zemrën si lulët e mollës... — tha Thomai.

Si kaluan Qafën e Prushit, erdhi urdhri për
t'u ndalur. Tani batalioni ndodhej në një mal më
të lartë me aie e pisha.

— Diçka ka që u ndalëm. Ne tani sapo pushu-
am, — tha Dinoja.

— Pararoja diçka ka vënë re, — tha një parti-
zan.

— Po kjo është zonë e çliruar, — tha Dinoja.

— Armiku të del atje ku nuk e pret, — tha
Thomai.

Po shpejt u mor vesh se ata që kishte diktuar
pararoja, ishin ca fshatarë me mushka ngarkuar që
ngjiteshin malit përpjetë. Batalioni u ul në një co-
pë lëndinë, pranë një gurre ujëplotë. Karvanit të
mushkave e të njerëzve që po afrohej, i printe një
malësor gjigant sa Palok Treni. Ai kishte hedhur
sup më sup një pushkë të gjatë. Të tjerët që vinin
pas tij, ishin të paarmatosur.

— Dua komandantin dhe komisarin, — tha ai
me zë të lartë, që ta dëgjonin gjithë partizanët.

Komisari, siç qe ulur në shesh, si të gjithë të
tjerët, u ngrit më këmbë.

— Unë jam komisari, — i tha ai burrit me
trup të madh.

— Mua më quajnë Belik Bashnjari, — tha bu-
rri. — Kemi mbledhur ca ndihma për partizanët.
Jemi djegur dy herë nga ballistët dhe një herë

nga gjermanët dhe nuk na ka mbetur gjë, por, kur morëm vesh si ju doli malli i atyre të përtejdetit, maskarallëkun e tyre, dolëm shtëpi më shtëpi e mblodhëm diçka... I kemi mbledhur në tetë fshatra, se, thashë, nuk kemi... na kanë djegur tri herë, qentë.

— Ju faleminderit shumë, — tha buzëgaz komisari. — Te ju, te populli i kemi rrënjët ne dhe jo tek ata të «përtejdetit».

— Ç'na u ndodh, ju kemi sjellë o komisar! Bukë, gjizë, djathë, çorape, fanella leshi e ç'të të them tjetër... — vijoi burri.

— Ju faleminderit, — tha prapë komisari.

— Ç'nder o komisar, — tha burri shtatmadh.

— Ju për popullin luftoni dhe populli nuk kursen asgjë për ju, tjetër gjë se varfëria na e ka hedhur lakun në fyt...

— Edhe varfërinë do ta shporrim, — tha komisari.

Pastaj u shkarkuan të trembëdhjetë mushkat.

— Malli i popullit, djersa e fukarasë, — tha komisari dhe sytë i shkëlqenin nga gëzimi. Ai ishte një gëzim i thellë, që e kishte përzënë brengën dhe hidhërimin që i shkaktuan aeroplanët e huaj.

NJE RRUGË E VËSHITËRE

Atë natë kisha udhëtuar gjashtë orë pa ndërprerje. U ktheva në spital me makinën e urgjencës dhe hyra në dhomën e mjekut të rojës.

— U lodhe, Ali? — më pyeti ai.

— Pak, — thashë.

— Je lodhur shumë. Të thërrasim Fetahun?

Fetahu ishte shoferi tjetër i autoambulancës. Ai do ta fillonte punën pas disa orësh. Kishte ndodhur që, dhjetë minuta para se të shkoja unë për ta ndërruar, ai ishte nisur për rrugë të gjatë. Vinte i lodhur, por jo qejfprishur. Ai kishte njëzet vjet që punonte në spital, kurse unë vetëm gjashtë muaj. Kështu që nuk mund t'ia lejoja vetes që ta thërritnim, por as detyra nuk ma lejonte.

— Mos e thirr, — i thashë mjekut me vendosmëri.

Ai uli dorezën e telefonit dhe ndenji pak i menduar. I sëmuri ishte një malësor rreth të dyzetave; ishte rrëzuar nga një lis kur po bënte gjeth për bagëtinë. Thirrën kirurgun. Ai erdhi i përgjumur. Tingëlloi zilha e telefonit dhe mjeku i ro-

jës ngriti dorezën. Biseda mbaroi dhe ai, për disa sekonda, më shikoi në sy. Buzëqeshi.

— Të thashë që të thërritnim Fetahun. Sikur ma ndiente zemra, — tha ai.

— Fol, ç'është? — nuk m'u durua mua.

— Rast urgjent... Nga Selvishta... një grua për lindje...

— Ç'ka këtu për t'u shqetësuar, — tha Simoni, kirurgu, ndërsa merrej me malësorin.

— Ka udhëtuar gjashtë orë, — tha mjeku i rojës.

Simoni më shikoi në sy. Unë brofa në këmbë dhe ai nuk e pa të udhës të fliste më.

— Merr edhe Perihanin, — tha ai pas pak.

Perihani ishte mami. Morëm në telefon raportin e gjinekologjisë dhe Perihani zbriti gati me vrap. Unë kisha ndezur motorin dhe prisja me këmbë në freksion. Sa u fut brenda, në dritën e dobët të kabinës pashë orën e saj; ishte tre pas mesnate. Duheshin më shumë se dy orë që të gdhihej. Vetëm kur dolëm në rrugën automobilistike, vumë re se koha ishte e vrenjtur.

— Do të ketë shi, — tha Perihani.

— Edhe shiu na duhet, — thashë unë i mërzi-tur.

— Duhet për bujqësinë. U bë toka shkruamb, — tha vajza, e merakosur.

— Ke qenë në Selvishtë ndonjëherë? — e pyeta, ndërsa rrotulloja me forcë timonin për të marrë një kthesë të fortë.

— Jo, — tha ajo.

— Me shi zor se kalohet andej. Kemi hallin e gruas, — thashë unë.

Ndjeva se shqetësimi im e kapi edhe Perihanin.

— Shkelja, — tha ajo. — Të mbërrijmë sa më shpejt.

Nuk kishim bërë më shumë se dhjetë kilometra rrugë, kur u ndien gjësimet dhe shkrepëtimat e para. Po, ato u ndërprejnë shpejt dhe neve na u duk se qe vetëm një trill i qiellit. Edhe era që fryu pak më parë, tani pushoi. Po kjo ishte një qetësi e rraste. Fas dhjetë minutash filloi një shi i rrëmbyer e kokërrmadh.

Kur mbërritëm te Përroi i Setushit, ura e vogël mezi dukej. Dallgët e turbullta të përroit herë pas here kalonin mbi të.

— Kur të kthehem, kam frikë se nuk do ta gjejmë urën, — tha Perihani e shqetësuar.

Nuk foli, veç e shtova shpejtësinë. Ecnim në një rrugë të ngushtë. Rrotat e makinës rrëshqitnin në një baltë që ngjitej. Po të binte dhe ca shi, kalimi andej ishte shumë i vështirë.

— Në qoftë se nuk e kanë nxjerrë gruan në qendrën e lokalitetit, do ta kemi shumë keq punën, — i thashë Perihanit.

— E kanë sjellë në lokalitet, te spitali, — tha ajo për të më hequr merakun.

Shiu një herë u duk sikur do të pushonte, por ia nisi më me rrëmbim se më parë.

Në qendër të lokalitetit mbërritëm shpejt dhe pa ndonjë shqetësim të veçantë. Në spital kishte heshtje të plotë. Një burrë plak, rreth pesëdhjetë vjeç, mustaqethinjur, rrinte duke pirë duhan para hyrjes së spitalit.

— E, erdhët? — na pyeti ai.

Perihani sapo zbriti, kurse unë akoma nuk kisha dalë nga kabina.

— Mos di gjë ku është e sëmura? — e pyeti Perihani.

— Në spital është; — tha ai.

— Hë, tundu, nuk e shikon ç'kohë është, — e nxita plakun. Ai m'u duk si ata rojet që s'para e vrasin mendjen shumë dhe nuk merakosen edhe për një rast të tillë.

— Njitash e nxjerrim. E kam nusen e djalit, — tha plaku, duke u futur brenda.

U futëm edhe unë e Perihani. U gjendëm në korridorin e ngushtë dhe gjysmë të errët të spitalit.

— Është këtu, — tha plaku dhe na tregoi derën ku të hynim.

Hymë në dhomën ku ndodhej e sëmura. Ajo ishte një nuse e re. Kishte kafshuar buzët nga dhembjet, sa vende-vende dukeshin edhe shenjat. Në tërë qënien e saj kishte një si tkurrje. Megjithatë, dukej që ishte e bukur. Kur i kapa vështrimin e syve, ndjeva një tronditje dhe habi të lehtë. Ata sy sikur i kisha parë. Fillova të rrëmoja në kujtesë...

Atëherë unë isha në gjimnaz. Mbjaj mend që një ditë mësuesi kujdestar na sollti në klasë një vajzë... Ishte e veshur si gjysmë qytetare. Ishte shumë e bukur dhe vajzat e klasës sikur e patën zili. E quanin Arze. Kishte vetulla të zeza, flokë të gjatë, të zinj, qerpikë të gjatë... Në pushim vajzat e rrethuan dhe filluan bisedën me të.

— Kam ardhun te xhaja. Në tetëvjeçare kam kenë mirë, po s'idi a do mundem me mësues këtu, — tha me druajtje ajo.

— Po, ti paske sy të bukur, — e ngacmoi Shpresa.

— Ça më ba. Sy janë, për me pa, — foli e turpëruar ajo.

Dalngadalë Arzja e ndryshoi veshjen e, pas një muaji, nuk dallohej nga vajzat e tjera. Dy javët e para ajo nuk e ngriti fare dorën në mësim dhe mësuesi i matematikës e mori për mbetëse. Ai e pyeti në ishte përsëritëse apo jo.

— Jo, mësues, s'kam mbet asnjëherë në klasë, — tha ajo.

— Pa dil në dërrasë të shohim, — i tha mësuesi.

Arzja doli e druajtur. Po problemën e zgjidhi shumë mirë. Mësuesi i dha edhe një problem tjetër. Edhe atë e zgjidhi me lehtësi, duke arsyetuar saktë. Mësuesi u kënaq shumë. Unë isha i dobët në matematikë dhe fillova të mësoja me të. Më ishte mbushur zemra plot dashuri për Arzen dhe një ditë i thashë:

— Arzë, të dua!

Ajo më pa e befasuër. Kujtova se e humba miqësinë e saj. Vetullat e holla sikur iu harkuan, por sytë i morën një shkëlqim të veçantë.

— Të dua, Arze, të dua shumë, — i thashë.

— Po unë druj me të dashtë, Ali, — ma ktheu gati me ngashërim.

— Po pse druhesh? Unë të dua shumë, — i thashë prapë, se kujtova që nuk besonte në dashurinë time.

— Me ba me marrë vesh axha se merrem me dashni, më vret, — na vret të dyve, — tha e tronditur ajo.

— Nuk guxon askush me na vra, — i thashë për t'ia hequr frikën.

— Axha jem, po. Nuk e njef ti, Ali....

Axha i saj punonte në bonifikim, por unë nuk e njihja. U interesova dhe e njoha. Ishte një tip bajraktari që nuk mund të vriste njeri, siç thoshte Arzja, por, ama dashurinë nuk e pranonte kurrë. Megjithatë unë dhe Arzja vazhdonim të duhehim.

— Kuku, me ba me e marrë vesh axha, — thoshte shpesh ajo.

Po axha e mori vesh dhe Arzja nuk erdhi më në shkollë. Pas disa ditësh mësova se ai e kishte dërguar në fshatin e saj të largët, tek i ati. U pikëllova të gjithë për Arzen, si vajzat, si djemtë, por më shumë u pikëllova unë.

Dhe ja tani...

— Na lini vetëm ju burrat, — na tha Perihani. Unë plaku, dhe djali i ri që duhej të ishte burri i Arzes, dolëm përjashta.

— Është një rast i vështirë. Duhet çuar sa më parë në spital, — më tha Perihani pas pak.

Arzja hapi sytë e zinj dhe më pa. Më njohu. Buzëqeshi aq, sa asnjëri nuk e vuri re, përveç meje.

Ndeza motorin. Të gjithë hipën lart së bashku me Arzen: Perihani, djali i ri, mamia e lokalitetit dhe një grua rreth pesëdhjetë vjeç, që duhej të ishte vjehrra e Arzes. Veç plaku hipi tek unë, në kabinë. Ai rrinte i zymtë.

— E dashke shumë nusen, — i thashë.

— Si mos me e dashtë, asht shpirt njeriu, — tha ai.

Atje ku rruga ishte më me pak gropa, e shtova shpejtësinë në maksimum. Shiu vazhdonte të binte,

Përmes xhamave të kabinës shikoja rrëketë e turbullta të ujit, që zbritnin tatëpjetë vijave e brigjeve. Mendja më vajti tek ura dhe m'u drodh zemra. Edhe plaku kishte pasur të njëjtin shqetësim.

— Kam frikë se mos asht mbulue ura, — tha ai.

— Do bëjmë si do bëjmë dhe Arzen do ta shpëtojmë, — thashë unë.

Plakut iu kreshpuan vetullat, kur dëgjo*u* emrin e së resë, por në sy nuk pashë t'i vetëtinte ndonjë dritë e keqe.

— Po ku e njeh Arzen ti? — më pyeti i habitur.

— E kam pasur shoqe klase në gjimnaz. Ka tetë vjet ajo kohë, — i thashë.

— Aha, — ia bëri plaku si i lehtësuar. — Vërtet ka kenë në shkollë qyteti, po Adem Mustafa nuk e mbajti, derisa ta mbaronte. Iu dhims një copë bukë, hej e marroftë zoti, — turfulloi plaku.

Ai po fliste për axhën e Arzes. Mua më erdhi mirë që ai fliste keq për të dhe e ndieja se këtë urrejtje ia kishte futur në shpirt Arzja.

— Po ku punon Arzja tani? — e pyeta.

— Asht brigadiere. Ia thotë kalemit mirë... Po ti e njifke ma mirë se unë...

Kishim mbërritur para urës, por ajo nuk dukej fare. Ujërat e verdha e kishin mbuluar krejt. Përrroi gjëmimtar sillte gurë të mëdhenj e kërcunj me një rrapëllimë të madhe.

Ndalá makinën dhe dola nga kabina. Doli edhe plaku. Të tjerët nxorën kokat te xhami i autoambulancës. Vështrimet e tyre ishin të shqetësura.

— Po tani si me ia bën? — pyeti plaku.

— Diçka duhet të bëjmë, — i thashë.

Hoqa këpuçet e çorapët dhe përvësia pantallonat. Ndohëse ishte maj, uji ishte brisk.

— Ça je ka ban, hej burrë? — më pyeti plaku.

— Kërkoj urën, — thashë.

Shkulmat e verdha të valëve më sulmonin nga të gjitha anët. Kur kisha ardhur, dy orë më parë, pata vënë re se në drejtim të urës ishte një rrëp i madh, i djegur nga rrufeja. I hodha sytë rripit dhe mbeta i zhgënjyer. Më duhej që urën ta kërkoja, të paktën, pesëdhjetë metra më tej... Këmbët më shkelën në çimenton e ftohtë. Kjo është ura, thashë me vete. Kërkoja me dorë dhe gjeta gurët kilometrikë në të dyja anët. Nxora me mundim të madh një kërcu dhe e vura nga e maita e urës. Mbi të nuk kishte më shumë se njëzet centimetra ujë dhe, po ta pasqyroja nga gurët dhe kërcunitë, mund të kaloja. Po të hasja në gurë a drurë, makina do të ngecte në vend dhe do të shuhej motori.

Iu vura punës dhe kontrollova me këmbë e duar gjithë vendin, pëllëmbë për pëllëmbë. Si u binda që nuk kisha më pengesa, shikova drejt makinës. Isha llangosur dhe bërë tërë ballë, se më shumë se ujë, ajo ishte një llavë e trashë e verdhë...

— Kuku, si u bane, — thë me keqardhje plaku.

— Futu shpejt në kabinë, — i thashë.

Po, sa u futa në kabinë, kërcuri që kishte vënë për orientim, u godit nga gurët dhe shkoi e zuri vend në mes të urës.

— Dreq, o punë, edhe kjo më duhej, — thashë i nevrikosur.

— Shkoj dhe e nxjerr unë... Paj duart dhe kamët nuk më kanë lanë, — u hodh plaku.

Ai, i bërë nevrík, përpiqej të hapte derën e kabinës, por, ngaqë nuk dinte, bënte ca lëvizje, që, po të mos isha në atë gjendje, do të shkulesha së qeshuri.

— Jo ti, jo. Ai djali të kishte zbritur një-herë, se burrë është edhe ai, — i thashë plakut për të birin. Nuk dija se ç'ndjenjë më shtyu t'i flisja me mllef për të birin.

Plaku u prek në sedër, por e kuptoi se unë kisha të drejtë.

— Po zbrit një herë, moj faqe e zezë. Nuk e shikon ç'po ndodh? — i bërtiti ai djalit.

Djali lëvizi me ngathtësi dhe, kur doli ai jashtë, unë kisha mbërritur tek ura. E vura përsëri kërcunë në vendin ku qe dhe iu futa përsëri pastrimit të urës. Dëgjoja që plaku hahej me fjalë me të birin. Ai fliste fare ngadalë, kurse plaku bërtiste gjithnjë e më shumë. Më në fund u ktheva te makina. Hipa në kabinë dhe ndeza motorin. Makina shtërzoj, u dridh dhe, më në fund, u sul përpara. Në tërë qenien time ato çaste kishte një tendosje të madhe nervore. Ndieja se rrotat ecnin mbi urë dhe, me zemër të ngrirë, prisja mos më dilte para ndonjë pengesë. Po makina çau përpara. Dolëm në një copë rrugë me gurë, jashtë çdo rrëziku.

— Shpëtuam, — thashë dhe ndeza një cigare. Ktheva kokën pas dhe pashë njerëzit në makinë.

Perihani më buzëqeshi sikur deshi të më thoshte: «Dreqi vetë je ti, Ali...» Vetëtimthi ndesha edhe vështrimin e Arzes. Ishte i ngrohtë dhe gjithë shpresë...

— Po ti qenke luan, — më mburri mua plaku. — Pasha bukën, me ba mos me ardhë në shtëpi kur të dalë Arzja, nga spitali, kam me ardhë e kena me u rrah në bulevard bashkë...

Qesha.

Kur mbërritëm në spital, Fetahun dhe Simonin i gjeta përjashta te shkallët.

— Po pse nuk më thirre, Ali? — më pyeti Fetahu me keqardhje.

— Kjo ishte detyra ime, Fetah. Edhe ti nuk më ke thirrur.

— Po ti ke dhjetë orë që udhëton, — tha ai.

Ndërkohë Simoni dhe Vera, gjinekologja, po vizitonin Arzen. Ne të tjerët pinim duhan në korridor.

— Shko dhe ndërrohu, — më tha Fetahu.

— Prit, ç'do të thotë Simoni...

Atëherë Fetahu ndezi reflektorin. Simoni doli me rrëmbim nga dera dhe, siç e kishte zakon ai, kur i sëmuri duhej operuar, thirri:

— Salla, gati salla...

Ne e pamë në sy, tërë frikë për jetën e Arzes.

— Edhe dhjetë minuta sikur të mos kishit ardhur... Tani të jeni të sigurtë se gjithçka do të shkojë shumë mirë, — tha Simoni.

Vjehrra e Arzes doli duke qarë nga dhoma ku ishte futur së bashku me Perihanin.

— Shuej lotët, — iu gërmush asaj plaku. — Me këta djem nuk e gjen gja e keqe nusen, jo.

Pak më vonë shkuam në klub dhe pimë nga një kafe dhe fërnet. Tani isha ndërruar dhe e ndieja vetën mirë. Nga të gjithë ne që ishim aty, djali i ri dukej më i shqetësuar.

— Më duket se ky djali yt nuk po u beson qarve të Simonit, — i thashë plakut, duke treguar burrin e Arzes, që rrinte si mbi gjemba.

Djali buzëqeshi hidhur.

— Nana jeme vdiq kur leva unë, — tha ai.

Mbeta i habitur së bashku me Fetahun, sepse gruan që qante e kisha pandehur gjithmonë të plakut...

— Po ajo? — thashë unë.

— Asht nana e Arzes, — tha plaku. — Po, po, asaj jetëshkurtës ka shumë vjet që i kullot mushka mbi vorr. Do të vdiste edhe Arzja, sikur të mos na i sillte tanë të mirat Enver Hoxha. Qe, besa, vet jam plak, por due me rrue dhe pak, t'i shoh të mirat...

— Po, po, tana të mirat i kemi, po sot qëlloi mot i keq e, sikur të mos kishte ba gajret, Aliu, Arzja do të kishte vdekë. Me ba me kenë noj tjetër, do kishte me thanë: «Nuk del makina, nuk kam ça me ba...» Po ky..., — tha burri i Arzes.

Më erdhi rëndë se aty ishte edhe Fetahu që kishte njëzet vjet që po i binte pëllëmbë për pëllëmbë tërë rrethit.

— Jo, jo, askush nuk thotë kështu, — thashë unë.

— Paj punën nuk e ban makina, po njeriu, — foli plaku, i cili u nxeh nga ato që tha djali. — Partia e bani njeriun me kenë trim e me kenë i fortë...

Dera e klubit u hap dhe ne pamë fytyrën e bukur të Perihanit:

— T'ju rroj djali. Arzja është shumë mirë, — tha ajo.

Plakut iu kreshpëruan mustaqet nga një gëzim i madh, i brendshëm...

...në këto momente të vështira të jetës së saj, Perihani
...në këto momente të vështira të jetës së saj, Perihani
...në këto momente të vështira të jetës së saj, Perihani
...në këto momente të vështira të jetës së saj, Perihani
...në këto momente të vështira të jetës së saj, Perihani
...në këto momente të vështira të jetës së saj, Perihani
...në këto momente të vështira të jetës së saj, Perihani
...në këto momente të vështira të jetës së saj, Perihani
...në këto momente të vështira të jetës së saj, Perihani
...në këto momente të vështira të jetës së saj, Perihani

...në këto momente të vështira të jetës së saj, Perihani
...në këto momente të vështira të jetës së saj, Perihani
...në këto momente të vështira të jetës së saj, Perihani
...në këto momente të vështira të jetës së saj, Perihani
...në këto momente të vështira të jetës së saj, Perihani
...në këto momente të vështira të jetës së saj, Perihani
...në këto momente të vështira të jetës së saj, Perihani
...në këto momente të vështira të jetës së saj, Perihani
...në këto momente të vështira të jetës së saj, Perihani
...në këto momente të vështira të jetës së saj, Perihani

SHQETËSIMI

Në klub-restorantin e lokalitetit kishte mbaruar ngrënia e drekës dhe Baba po bënte pastrimin. Atë e quanin Rexhë, por të gjithë e thërritnin Babë. Pakkush e dinte se si i kishte mbetur ky emër. Kjo kishte ndodhur pesëmbëdhjetë vjet më parë. Atëherë Rexha ishte dyzet vjeç burrë dhe nuk i kishte ardhur mirë kur dikush e thirri «babë». Po koha kaloi dhe ai u mësua aq shumë me atë emër, sa tani do t'i vinte çudi që dikush t'i drejtohej me emrin e vërtetë.

Mbaroi pastrimin dhe u ul në një tryezë pranë dritares. Njëpërmjet xhamave shikonte perden e shiut. Po bëhej java e parë e majit dhe shiu pothuaj nuk kishte pushuar hiç që nga fudi i prillit. Rexha pinte duhan dhe nuk ia ndante sytë shiut. Kur nuk kishte njeri në klub, ndiente njëfarë mërzie. Ai ishte një plak i urtë që i donte shumë njerëzit. Ishte përherë buzëgaz, nuk zemërohej me asnjeri dhe nuk përtonte kurrë. «Nuk më rrihet pa njerëz. Po ç'është kjo pranverë? Pranverë apo vjeshtë është?! Ç'shi!».

Në krye të rrugicës së shtruar me zhavorr,

ndanë plepave, pa kryetarin e kooperativës. Atij iu bë qejfi që po vinte kryetari. Ai ishte një burrë i gjatë dhe i mbushur nga trupi. Flokët nuk i kishin rënë, por i ishin zbardhur krejt. Nga larg dukej sikur kishte vënë në kokë një bashkë lesh të bardhë.

— E Babë, si je? — e pyeti ai dhe u ul në një tryezë me të.

— Mirë jam. Po ty si t'u bë djali? — e pyeti Baba.

Kryetari nuk u përgjigj menjëherë. Pastaj tha si nëpër dhëmbë:

— Më mirë është...

Një ditë më parë djalin e tij dhjetëvjeçar e kishte goditur mushka mu në ballë. Mjeku i lokalitetit tha që duhej dërguar në qytet, por, kur u bë gati makina e kooperativës, u mor vesh që përroi i Beshës kishte prishur urën... Në qytet nuk mund të shkohej, të paktën, gjersa të binin ujërat. Dhe djalin e shtruan në spitalin e lokalitetit.

«Mjeku tha se nuk ka ndonjë rrezik, po kokë i thonë», tha me vete Baba dhe me këtë e lidhi trishtimin e kryetarit. Sytë e kryetarit, përherë të kaltër, ishin murrëtyer, si ai qiell i ngarkuar me re...

— Ç'urdhëron? — e pyeti Baba kryetarin.

— Më sill një gotë raki, Babë, — tha ai.

Rexha i solli gotën e rakisë, një vezë, hudhra, të njoma, pak bukë dhe kripë. Ai kurrë nuk e kishte parë kryetarin të hante drekë në kohë, si gjithë të tjerët. Ai hante kur kishte kohë. Baba shikonte vijat e ujit që rridhnin nga pelicja e kryetarit e binin poshtë në dyshemë dhe sepse ndjeu një farë keqardheje për të.

— Shi, — tha Baba.

— Lërel, Na e hëngri shpirtin!

Baba kishte dëshirë të bënte pak muhabet me të, por kryetari dukej që nuk ishte në qejf...

«Ka hak, ka hallin e djalit... Pas njëzet vjet martese i lindi ky djalë dhe ja... Kushdo që të ishte në vendin e tij, do të mërzhitej... Bela me këto mushkat... Të mira janë, por edhe huqe kanë...»

Dhe i tha kryetarit mos donte edhe një gotë raki, por tjetri tundi kokën në shenjë mohimi.

«Qenka bërë fjala gur mulliri për të sot, nuk e rrokulliska dot...», — mendoi Baba.

Rrugës, nga erdhi pak më parë kryetari, u dukën dy njerëz që ecnin nëpër shi.

— Po këta? — pyeti.

— Njëri është mjeku i lokalitetit, Zeneli. Tjetrin nuk e njoh, — tha Baba.

Zeneli dhe ai burri tjetër që kishte mbathur një palë çizme të gjata gjer në gju, u ulën në tryezën ku rrinte kryetari me Babën.

— Ky shoku është mjek nga qyteti. Erdhi për Benin, — tha Zeneli.

Beni ishte djali i kryetarit.

— Djali nuk ka gjë, ose më mirë të themi ka shpëtuar për mrekulli, — tha buzëgaz mjeku nga qyteti.

Dy mjekët dhe Baba prisnin që kryetari të çelej në fytyrë, por ai vazhdonte të rrinte i ngrysur, si ajo ditë me shi...

— Falemnderit. Qenke munduar shumë, — i tha kryetari mjekut.

— E kemi për detyrë, — tha mjeku.

Kryetari porositi kafe dhe fërnjet për dy mjekët. Ato u pinë në heshtje të plotë...

Ai që duhej të gëzohej nuk u gëzua, kështu që edhe të tjerët e panë të udhës të heshtnin.

«Mbase nuk na besoi, ka njerëz që nuk besojnë kollaj», — tha me vete Zeneli.

— Jam i sigurtë që nuk ka asnjë rrezik, — foli mjeku nga qyteti. — Po të kisha sado pak dyshim, do të lajmëroja makinën tonë ta merrnim. Ajo kalon në lumë dhe jo më në përrua...

— Unë të besova, — tha shkurt kryetari.

Baba e pa kryetarin në sy. «Atëherë ç'dreqin ke që nuk gëzohesh», sikur thoshte shikimi i tij. Kryetari sikur ia kuptoi mendimet. Buzëqeshi paksa dhe pagoi për të gjitha. U ngritën të tre. Baba pa që kryetari u nda me dy mjekët dhe ia mbajti përmes arave, nëpër shi...

Të nesërmen dita që e bukuro. Qielli ishte qelq. Baba kishte bërë gati ekspresin. Bëri një kafe dhe filloi ta pinte me kënaqësi. Ai pinte disa kafe në ditë, por shije i ndiente vetëm asaj të mëngjesit. Derën e klubit nuk e kishte hapur ende. Ora ishte katër e gjysëm dhe duhej, të paktën, edhe një orë që të trokitnin punëtorët e ndërmarrjes së mermerit. Ata vinin me zhurmë e të gëzuar pinin nga një kafe më këmbë, te banaku, dhe iknin... Me ta e fillonte ditën e punës Baba.

Në derë u dëgjuan disa të trokitura të forta. «Po këta?! Sonte qenkan ngritur me natë», tha ai me vete për punëtorët.

Hapi derën dhe u habit kur pa kryetarin.

— Ç'e mirë të solli në këtë orë, o kryetar? — e pyeti duke qeshur dhe vuri re që sytë e tij ishin të kaltër, të kaltër...

— Ja, kjo më solli... A mund të flesh në një

mëngjes të tillë, — tha ai i frymëzuar, duke tre-
guar qiellin me dorë.

Baba përmes dritares i hodhi sytë jashtë.
Ai ishte gëzuar për motin e mirë, por gëzimi i tij
ishte si i çdo njeriu. Tjetër gëzim ishte ai i krye-
tarit.

— Tani do të fillojmë nga mbjelljet, Babë,
— filloi të fliste kryetari, duke shkuar drejt ba-
nakut. — Na mbylli shiu sivjet, Babë, po tani
që u hap koha, do të punojmë natë e ditë.

Dhe piu shpejt e shpejt kafën në këmbë, e doli.

— Demek moti të paska ngrysur ashtu dje...
Unë kujtova se djali... Po, kur pashë se edhe fjala
e mjekut nuk të gëzoi, thashë me vete: «e ka një
hall kryetari, shumë të madh e ka...», — nisi të
thoshte Baba, që kishte dalë për ta përcjellë.

— Djalin e dua shumë, Babë, po djali është
veç imi. Kjo është e të gjithëve... — tha ai, duke
shtrirë të dyja duart përpara, drejt fushës së
gjerë...

PASQYRA E LËNDËS

Lindje në mal	3
Shtegtimi i këngës	11
Në xhade, buzë lumit	20
Dora që zhduku varfërinë	31
Kopi	41
Dy rapsodët	49
«Nusja» e Nuri Petrinos	55
Në pranverë, buzë lumit	66
Alma	75
Pas vijës së ujit.. ..	81
Allaman Hodoja	89
Dridhjet e mëngës së xhaketës	99
Kthimi	104
Hekurat e qenit	112
Nxënësi im, Hajdari... ..	120
Bucela	127
Telefoni	134
«Hajde, mbathjani!..»	142
Fëshfërinte pylli i mështeknave	153
«Aleatët» dhe populli	170
Një rrugë e vështirë	178
Shqetësimi	190